AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

# RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në:**

**"Drejtim Agrobiznesi"**

**Universiteti Fan S. Noli Korçë**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Ass. Dr Anila Boshnjaku
2. Dr. Genti Çela

Qershor 2025

**Tabela përmbledhëse për programin e studimit Master Profesional në:**

**"Drejtim Agrobiznesi"**

| | | |
|---|---|---|
| 1 | IAL aplikues: | Universiteti "Fan S. Noli" Korce |
| 2 | Njësia bazë që e ofron: | Departamenti i Agrobiznesit/Fakulteti i Bujqësisë |
| 3 | Emërtimi i programit të studimit: | Master Profesional "Drejtim Agrobiznesi" |
| 4 | Urdhëri/VKM i licencimit: | VKM Nr. 9, datë 2.01.2009 |
| 5 | Urdhëri/VKM i riorganizimit: | UMAS Nr. 447, date 14.08.2023 |
| 6 | Forma e regjistrimit të diplomës: | Urdhër Nr. 196, datë 16.07.2024 |
| 7 | Urdhëri/VBA i akreditimit të parë: | Akreditohet për herë të parë |
| 8 | Cikli i studimit: | Cikli i dytë Master Profesional |
| 9 | Kohëzgjatja e programit të studimit: | 1 vit akademik (2 semestra) |
| 10 | Kreditet në total (ECTS): | 60 kredite |
| 11 | Forma e studimit: | Me kohë të plotë |
| 12 | Gjuha (shqip/tjetër): | Gjuha Shqip |
| 13 | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera: | Jo |
| 14 | Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin): | Jo |
| 15 | Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin): | Jo |
| 16 | Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve: | Nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve |
| 17 | Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit: | 2024-2025 9 PAE /1PAK<br>2023-2024 9 PAE /2PAK<br>2022-2023 9 PAE /2PAK |
| 18 | Numri i studentëve: | 2024-2025 12 studentë<br>2023-2024 11 studentë<br>2022-2023 12 studentë |
| 19 | Komente / të tjera: | |

**PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Përshkrim përmbledhës; (200 -400 fjalë)**

Programi i studimit Master Profesional në "Drejtim Agrobiznesi"në Universitetin "Fan S.Noli ",Korcë është një program i ciklit të dytë të studimeve. Ai është vazhdim i ciklit të parë të studimeve (Bachelor) në "Menaxhim Agrobiznesi". Ky program studimi u lançua në vitin 2009 në Universitetin "Fan S. Noli" Korçë (UNIKO), Fakulteti i Bujqësisë, Departamenti i Agrobiznesit (DA). Ky program ofrohet nga një Universitet me përvojë të gjatë në procesin akademik dhe kërkimor, e cila ka rezultuar të suksesshme. Hapja e këtij programi është miratuar me: VKM nr.97 datë. 27.01.2009; është riorganizuar me urdher nr.594 date 09.12.2011, nr prot.6032/3 i Ministrit te Arsimit; është rioroganizuar me vendim nr.575 datë 01.10. 2018, nr.1765 prot. të Senatit Akademik të UNIKO; si dhe është riorganizuar me urdhër nr. 447 datë 14.08.2023, nr prot.5114/1 i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Hapja e ketij programi vjen pas zhvillimeve të fundit në fushën e arsimit bazuar në kërkesat rajonale të tregut të punës. Ky program ofrohet nga Departamenti i Agrobiznesit, pjesë e Fakultetit të Bujqësisë i cili është i organizuar në tre Departamente sipas Ligjit për Arsimin e Lartë Nr. 80/2015, konkretisht: Departamenti i Agronomisë, Departamenti i Agroushqimit dhe Departamenti i Agrobiznesit.

Qëllimi i programit të studimit Master Profesional në "Drejtim Agrobiznesi" është të sjellë një risi në tregun e profesionistëve të fushës së bujqësisë dhe agrobiznesit që lidhen me zhvillimet bashkëkohore në këtë fushë me qëllim rritjen e konkurueshmërisë në këtë mjedis të ri të të bërit biznes dhe politikave zhvillimore, në kuadër t integrimit evropian të vendit në epokën e digjitalizimit. Gjithashtu, ky program studimi tenton të rrisë aftësitë e punës së pavarur të studentëve, të menduarit kritik si dhe pozicionimin e tyre aktiv në tregun e punës.

Programi refleton një strukturë mësimore të mirëstrukturuar mbështetur në eksperiencën akademike dhe profesionale të personelit të UNIKO. Programi është i strukturuar në përputhje me standardet kombëtare të arsimit të lartë dhe ofron mundësi për zhvillimin e aftësive të veçanta dhe të specializuara në fushën e bujqësisë dhe agrobiznesit. Programi fokusohet në përdorimin e metodave dhe teknologjive të fundit, duke përgatitur studentët për të kontribuar në zhvillimin e dijes në këto fusha. Personeli akademik është i kualifikuar dhe ndjek një qasje të personalizuar në mësimdhënie, duke ofruar orientim dhe mbështetje të vazhdueshme për studentët në zhvillimin e tyre akademik dhe profesional.

Përfundimi i programit të studimit realizohet me mbrojtjen e punimit të diplomës. Proçesi i vlerësimit është transparent dhe i drejtuar nga kriteret dhe standardet e përcaktuara në rregulloret dhe ligjet e arsimit të lartë në Shqipëri. Përgjegjësia për ruajtjen dhe administrimin e dokumentacionit të studentëve është e siguruar në përputhje me legjislacionin dhe parimet e konfidencialitetit. Programi i studimit u jep mundësi studentëve të kenë akses në tregun e punës në sektorët që lidhen me agrobizneset. Lëndët në këtë program janë një harmonizim i atyre që lidhen me menaxhimin, bujqësinë por me focus në agrobiznes

Për të fituar diplomën studentët duhet të kenë marrë 60 kredite ECTS
Programi është organizuar në mënyrë të tillë që studentët të pajisen me njohuri të avancuara që do t'u mundësojnë punësimin në funksione të tilla si: menaxherë në fusha të ndryshme, përfshirë financë-kontabilitetin,; specialistë ekstensionistë që ofrojnë asistencë dhe këshillim për sektorin e agrobiznesit dhe zhvillimin rural, si edhe menaxhimin e burimeve natyrore.

**PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;**

**Përshkrim përmbledhës; (200-400 fjalë)**

Universiteti "Fan S.Noli" Korcë ka aplikuar për nisjen e procedurës së akreditimit të programit të studimit të ciklit të dytë "Master Profesional" në "Drejtim Agrobiznesi". Programi ka ardhur nga riorganizimi i programit MP "Zhvillim i integruar rural". Ky program ofrohet nga Departamenti i Agrobiznesit (Fakulteti i Bujqësisë). Aplikimi për akreditim është dorëzuar në ASCAL më datë 22.05.2024 me shkresën e dërguar nga UNIKO Nr. 1186/1 Prot, datë 17.05.2024.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) i përbërë nga Prof.Asoc.Dr Anila Boshnjaku dhe Dr.Genti Cela është mbështetur nga Zj. Anilda Beqiraj, koordinatore teknike e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL). Puna për vlerësimin e jashtëm ka filluar me një takim të dy vlerësueseve me koordinatoren teknike të ASCAL, ku u diskutua mbi organizimin e punës.
Në përgatitjen e RVJ, GVJ ka analizuar gjetjet e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB) bashkë me anekset si dokumentacion mbështetës dhe evidencat e përgatitura nga strukturat përkatëse. Gjatë analizës së Raportit, të përgatitur nga GVB, janë evidentuar disa pyetje e komente të cilat përbënë bazën e diskutimeve në takimet e zhvilluara gjatë vizitës dy ditore në institucion. në datat 17 dhe 18 mars 2025. Gjatë këtyre 2 ditëve GVJ u takua me drejtues, përfshirë Dekanin e Fakultetit të Bujqësisë dhe përgjegjësin e Departamentit të Agrobiznesit pegadogë të angazhuar në këtë program studimi,GVB, përfaqësues të zyrave si Sektori i Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë; Sektori i Projekteve Kërkimit Shkencor dhe Botimeve;Qendra e Karrierës dhe Alumni;, Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Komunikimit dhe Promocionit, Koordinatorin e projekteve Erasmus +Sekrearia, etj, gjatë diskutimit me të cilët u sqaruan çështjet sipas pyetjeve të përgatitura në avancë. Agjenda e takimeve u përgatit në bashkëpunim me koordinatoren teknike të ASCAL.
Gjithashtu, përmes vizitës në institucion, GVJ është njohur më nga afër me infrastrukturën fizike dhe mësimore, aspektet praktike të punës së zyrave dhe Departamentit, opinionet e pedagogëve dhe studentëve lidhur me procesin mësimor, sistemin e sigurimit të cilësisë etj. GVJ vizitoi laboratorët, auditorët, bibliotekën, për të parë nga afër përshtatshëmrinë e tyre me standardet cilësore të mësimdhënies dhe jetës akademike.
Vlerësimi i jashtëm u realizua për të 6 fushat e vlerësimit, sipas standardit përkatës.
Dëshirojmë të vlerësojmë angazhimin maksimal të institucionit për organizimin e takimeve, përgjegjshmërinë e stafeve gjatë diskutimeve dhe mikpritjen e ofruar nga institucioni.

**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në "Drejtim Agrobiznesi"**

## I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

| **Standardi I.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. | Institucioni i Arsimit të Lartë ofron programe studimi të ciklit të dytë "Master Profesional" në përputhje me interesat kombëtare, për krijimin dhe ofrimin e specialistëve në fushat e ndryshme, por edhe nevojën kombëtare për kërkues shkencorë, për mësimdhënie cilësore.<br>UNIKO si IAL e zhvillon aktivitetin e tij bazuar në Ligji Nr. 80/201 për "Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" (Shtojca 1.1) Statuti i UNIKO percakton format, ciklet dhe programet e ciklit te dytë të studimit. Në status neni 2 dhe 3 përcakton misionion dhe vizionin e UNIKO s. Po ashtu ka te miratuar Rregulloren e UNIKO miratuar dt 30.3.2023 në përputhje me të cilën organizohet njesia bazë Departamenti i Agrobiznesit (nesi 5.A dhe Neni 6) dhe programi i ciklit të dytë MP. (Shtojca 1.2), shtojca 2.2 dhe shtojca 2.3<br>Universiteti në realizimin e synimit të tij për ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombetarë bazohet edhe në Plani Strategjik i Zhvillimit të UNIKO 2022-2027 (shtojca 1.3) dhe Stategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026.<br>*Evidenca:*<br>*Shtojca 1.1 Statuti i UNIKO, 2022, Neni 52, 56;*<br>*Shtojca 1.1 Statuti i UNIKO, 2022, Neni 2, 3;*<br>*Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore Shkencore e FB, 2023;*<br>*Shtojca 2.3 Rregullore e Njësisë Bazë "Departamenti i Agrobiznesit" 2023;*<br>*Shtojca 1.3 Plani Strategjik i Zhvillimit të UNIKO 2022-2027, pika 12* |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë. | Fakulteti i Bujqësisë, Departamenti i Agrobiznesit ofron ciklin e dytë të studimit MP në "Drejtim Agrobiznesi" bazuar në statutin e UNIKO, miratuar në 24.01 2022, Kreu I – "Dispozita të Përgjithëshme, Neni 2 - Vizioni dhe Neni 3 Misioni". Objektivi kryesor i programit të ciklit të dytë të studimit, (MP) në "DREJTIM |

| | |
|---|---|
| | AGROBIZNESI", synon që t'iu ofrojë studentëve njohuri të thelluara, aftësi dhe kompetenca profesionale për formimin e tyre si specialistë me aftësi menaxheriale në veprimtari ekonomike që i përkasin sistemit të agrobiznesit.<br>Po ashtu, rregullorja mësimore e programit të studimit "Master Profesional"(2024-2025) në "Drejtim Agrobiznesi" hartuar dhe miratuar nga Departamenti i "Agrobiznesit" paraqet kriteret dhe procedurat e ndarjes së ngarkesës mësimore brenda dhe jashtë auditorit, disiplinat e formimit në këtë program, personelin akademik, infrastrukturën, mënyrat e vlerësimit të studentit, ormat e mësimdhënies, etj. (Shtojca 2.5).<br>*Evidenca:*<br>*Shtojca 1.1 Statuti i UNIKO, 2022, Neni 2* |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit. | Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.<br>Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Europian 2030, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.<br>Hartimi i programit te ciklit të dytë të studimit Master Profesional ne "Drejtim Agrobiznesi" është bazuar në objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve, të cilat përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale dhe analitike që duhet të fitojnë studentët në përfundim të tij.<br><br>*Shtojca 1.1 Statuti i UNIKO, 2022 neni 2, neni 52, neni 56;*<br>*Shtojca 1.2 Rregullore e Universitetit "Fan S. Noli" Korçë, Kreu VI*<br>*Shtojca 1.3 Plani Strategjik i Zhvillimit të UNIKO 2022-2027, pika 12*<br>*Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore Shkencore e FB, Kreu IV, Neni 30*<br>*Shtojca 2.5 Rregullore e Programit të Ciklit të Dytë të Studimit (MP) në "Drejtim Agrobiznesi" 2024-2025* |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar. | Institucioni është në përpjekje të vazhdueshme që përmes këtij programi studimi të përafrojë nevojat lokale dhe kombëtare për profesionistë në fushën e bujqësisë dhe turizmit, sidomos për sektorin e agroturizmit si një sektor prioritar, me potencialet njerëzore të ofruara përmes këtij masteri. Në ofrimin e këtij programi synimi themelor i shprehur në dosjen e aplikimit të programit dhe dosjen për riorganizimin e programit është paraqitur dhe në objektivat formuese të programit të studimit. Bazuar në intervistimin e Dekanit të Fakultetit të Bujqësistë, Drejtuesit të njësisë bazë, ekipit të GVB, pedagogëve dhe dokumentacionit të paraqitur programi i studimit MP në "Drejtim Agrobiznesi" bazohet në:<br>- Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Europian 2030, |

| | |
|---|---|
| | - Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026<br>- Planin Strategjik të Zhvillimit të UNIKO (2022-2027)<br>Programi i ciklit të dytë të studimit (MP) në "Drejtim Agrobiznesi" është hartuar dhe zhvillohet në përputhje të plotë me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Europian 2030, Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026. Programi fokusohet në dinamikat e ndryshimeve ekonomiko-shoqërore, tendencat globale të zhvillimit si dhe në objektivat që parashtrohen në Planin Strategjik të Zhvillimit të UNIKO.<br>*Evidenca:*<br>*Shtojca 1.3 Plani Strategjik i Zhvillimit të UNIKO 2022-2027, pika 12* |
| **Konkluzione** | *Institucioni përmbush kërkesat lidhur me ofrimin e programeve te studimit të cilat nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.*<br>*Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.*<br>*Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit*<br>*Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi I.2**<br>**Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një | UNIKO është një institucion me një përvojë shumëvjeçare në hapësirën akademike të arsimit të lartë në Shqipëri. I krijuar fillimisht si Instituti i Lartë Bujqësor (ILB) ai në vitin 1992 u njoh dhe zyrtarisht si Universiteti i Korçës, pikërisht për t'i shërbyer edukimit dhe zhvillimit ekonomik në zonën verilindore të Shqipërisë. |

| | |
|---|---|
| programi studimi në atë fushë. | Prioritetet strategjike të UNIKO përcaktohen në planin e zhvillimit strategjik, 2022-2027, ku janë pasqyruar dhe të sektorët strategjikë për të orientuar në hapjen dhe zbatimin e programeve të veta të studimit. Bazuar në shtojcën nr. 4 "Të dhëna statistikore për stafin, studentët, programin e studimit" faqa 2, tabela 2.3 dhe tabela 12.3.8 faqa 11, prezantojnë Departamentin e Agrobiznesit përgjegjës për programin MP në "Drejtim Agrobiznesi"<br>2024-2025 ku 7 PAE dhe 1 PAK.<br>Stafi përbëhet nga:<br>1 (një) pedagog me titullin akademik Prof. Dr (PAK)<br>2 (dy) pedagogë me titullin akademik Prof.Ass,Dr<br>(PAE)<br>5 (pesë) pedagogë me titullin akademik Dr.<br>(PAE)<br>2023-2024 7 PAE/2 PAK<br>2022-2023 7 PAE/2PAK<br>Departamenti Agrobiznesit ka bashkëpunim me UBT nga ku ka PAK dhe anasjelltas.<br>Ne te tre vitet akademike ka një Personel ndihmës akademik.<br>Ka evidenca të bashkepunimit dhe pjesmarrjes në programe (ERASMUS +, MIDAS, dhe bashkëpunim më Universitete të huaja për shkembime përvoje dhe mësimdhënie. (Shtojca 3.22 dhe 3.25)<br>Kjo demonstron se institucioni ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike për ofrimin e këtij programi.<br>*Evidenca:*<br>*2.18 Shkresë që vërteton hapjen e "Institutit të Lartë Bujqësor" datë 08.09.1971;*<br>*https://www.ascal.al/sq/lista-e-ial/ial/universiteti-fan-s-noli-korce*<br>*Shtojca 3.25 Kontratë Pune (Staf Akademik i Angazhuar me Kohë të Pjesshme pranë UBT);*<br><br>*Shtojca 2.5 Rregullore e Programit të Studimit (MP) në "Drejtim Agrobiznesi" 2024-2025, Pika 5;*<br>*Shtojca 3.22 Kontratë Individuale e Punës, për Personel Akademik me Kohë të Pjesshme* |
| **Kriteri 2.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë | Duke qenë se Fakulteti i Bujqësisë ka fushën e saj specifike bujqësinë, bazuar në rregulloren e Programit te Studimit (MP) ne Drejtim Agrobiznesi (shtojca 2.5) masteri ne fjalë korespondon me fushën akademike te njësisë bazë. Fusha specifike akademike e programit të studimit është në një linjë me fushat prioritare të zhvillimit të departamentit dhe Fakultetit, duke përkuar me fushën |

| | |
|---|---|
| kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. | akademike të tij si dhe duke u bazuar në burime njerëzore të cilët janë të specializuar në fushat e bujqësisë, turizmit, dhe ekonomisë. Kodi i studimit të programit (71 MP 0413 S) (shtojca 2.5.1) i referohet përcaktimeve te VKM vendimi nr 310 date 11.5.2022,referuar fushes "Biznes dhe Administrim" dhe "Menaxhim dhe Administrim"<br>Shtojca 2.5.1 Praktika e Plotë e Dokumentacionit "Për Kodifikimin e Programeve të Studimit"<br>*Evidenca:*<br>*Shtojca 2.5 Rregullore e Programit të Studimit (MP) në "Drejtim Agrobiznesi" 2024-2025*<br>*Shtojca 2.5.1 Praktika e Plotë e Dokumentacionit "Për Kodifikimin e Programeve të Studimit";*<br>*https://arsimi.gov.al/vendim-nr-310-date-11-5-2022-per-specifikimet-dhe-permbajtjen-e-kodifikimit-te-programeve-te-studimit-te-ofruara-nga-institucionet-e-arsimit-te-larte-ne-republiken-e-shqiperise/*<br>*Shtojca 2.5.1 Praktika e Plotë e Dokumentacionit "Për Kodifikimin e Programeve të Studimit"* |
| **Kriteri 3.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje. | Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të ciklit të dytë të studimit (MP) në "Drejtim Agrobiznesi", është në përputhje me fushën akademike të njësisë bazë/departamentit (DA).<br>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të ciklit të dytë të studimit (MP) në "Drejtim Agrobiznesi", korrespondon plotësisht me fushën akademike të njësisë bazë/departamentit (DA) që është përgjegjës për ofrimin dhe konsolidimin e këtij programi studimi.<br>Kodit të programit të studimit: (71 MP 0413 S) përkon me klasifikimin e përcaktuar sipas VKM përkatëse[1], dhe i referohet fushës: "Biznes dhe Administrim" dhe fushës së detajuar "Menaxhim dhe Administrim".<br>*Evidenca:*<br>*Shtojca 2.5 Rregullore e Programit të Studimit (MP) në "Drejtim Agrobiznesi" 2024-2025*<br><br>***https://arsimi.gov.al/vendim-nr-310-date-11-5-2022-per-specifikimet-dhe-permbajtjen-e-kodifikimit-te-programeve-te-studimit-te-ofruara-nga-institucionet-e-arsimit-te-larte-ne-republiken-e-shqiperise/*** |
| | *Shtojca 2.5.1 Praktika e Plotë e Dokumentacionit "Për Kodifikimin e Programeve të Studimit"* |

[1] https://arsimi.gov.al/vendim-nr-310-date-11-5-2022-per-specifikimet-dhe-permbajtjen-e-kodifikimit-te-programeve-te-studimit-te-ofruara-nga-institucionet-e-arsimit-te-larte-ne-republiken-e-shqiperise/

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4.** Në rastet kur institucioni ofron program "Master profesional" në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere. | Fakulteti i Bujqesisë së UNIKO që në krijimin e tij 1971 fillimisht si ILB ka qenë i orientuar ne studimet në fushën e bujqësisë. Stafi akademik është i kualifikuar në fushën e bujqesisë, agrobiznesit, ekonomisë, zhvillimit rural etj. Në përbërje të stafit ka akademikë dhe ekspertë të fushave në fjalë.<br>*Evidenca:*<br><br>*Shtojca 2.18 Shkresë që vërteton hapjen e "Institutit të Lartë Bujqësor" datë 08.09.1971;*<br><br>**https://ëëë.ascal.al/sq/lista-e-ial/ial/universiteti-fan-s-noli-korce** |
| **Kriteri 5.** Institucioni i arsimi të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit. | Bazuar në intervistën e GVB dhe te pedagogeve te FB, Stafi i i FB dhe DA janë të angazhuar në mënyrë periodike në analiza mbi studimin e tregut të punës, evidentimin e nevojave të tregut në sistemin e agrobiznesit.<br>Në materialet e upload në e-Ascal nuk ka ndonje shtojce apo evidence qe e tregon ketë.<br>Ne GVB thuhet "se një nga objektivat kryesore të FB për vitin akademik 2024-2025 është edhe ngritja e qëndrës të formimit (kualifikimit) të vazhduar, ku stafi akademik i FB dhe DA do të angazhohen në mësimdhënie me lëndë/module mësimore për kualifikimin e vazhduar të specialistëve që aktualisht janë në marëdhënie pune në institucione të ndryshme publike dhe private."<br>Shtojca 2.4.1 Plani i veprimit i perket periudhes 2022-2023. Nuk ka përditësim për periudhën ne vijim.<br>*Evidenca:*<br>*Shtojca 3.12 Studim Tregu për Programin e Studimit "Drejtim Agrobiznesi", Maj 2023*<br>*Shtojca 2.10 Marrëveshje Bashkëpunimi në Mbështetje të Praktikave Profesionale;*<br>*Shtojca 2.10.1 Marrëveshje Bashkëpunimi të FB;*<br>*Shtojca 3.6 Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet në funksion të programit të studimit*<br>*Shtojca 3.10 Praktika e Organizimit të Tryezave të Përbashkëta me Operatorët e Sektorit Privat;*<br>*Shtojca 3.4.1 Plan Veprimi për Formimin e Vazhduar i Hartuar nga DKVI* |
| **Konkluzione** | *Lidhur me ofrimin e programeve te studimit në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion, Institucioni ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.*<br>*Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit.*<br>*Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi I.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. | Funksionimi i këtij programi studimi në departamentin e Agrobiznesit mbështetet nga institucioni jo vetëm nëpërmjet vetë departamentit, por dhe nëpërmjet bashkëveprimit me staf jashtë departamentit (Fakulteti i Ekonomisë, DMT) dhe jashtë institucionit Bazuar në statusin e UNIKO programet e studimit hartohen nga njësitë bazë dhe miratohen nga Senati Akademik.<br>Bazuar në regulloren e programit të studimit (MP) në "Drejtim Agrobiznesi" programet lëndore hartohen nga titullari i disiplinës, pedagogu i disiplinës ose grup pedagogësh, shqyrtohen në grupin e mësimor dhe të kërkimit në departament, dhe miratohen nga përgjegjësi i departamentit dhe nga Dekani i FB.<br>Në materialet e upload në e-Ascal nuk ka ndonje shtojce apo evidence qe e tregon ketë (shkresë miratimi programi nga departamenti apo dekani).<br>Lidhur me treguesit e performancës, referuar raportit të analizës vjetore në GVB i referohet Shtojca 2.4 Raporti i Analizës Vjetore të Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore & Financiare i UNIKO 2022-2023 (a ka rapport të përditësuar)<br>*Evidenca:*<br>*Shtojca 1.1 Statuti i Universitetit "Fan S. Noli" Korçë, Neni 52, pika 3;*<br>*Shtojca 2.5 Rregullore e Programit të Studimit (MP) në "Drejtim Agrobiznesi" 2024-2025;* |

| | |
|---|---|
| | *Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore Shkencore e FB, Neni 5;*<br>*Shtojca 3.8 Analiza Vjetore e Veprimtarisë së Njësisë Bazë*<br>*Shtojca 2.13 Analiza e Punës Mësimore dhe Kërkimore-Shkencore, e FB për Vitin Akademik 2022-2023*<br>*Shtojca 2.4 Raporti i Analizës Vjetore të Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore & Financiare i UNIKO 2022-2023* |
| **Kriteri 2.** Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj. | UNIKO bashkëpunon më institucione akademike, institucione publike qëndrore dhe lokale, biznese private për tu mundësuar studentëve praktikat mësimore profesionale.<br>Gjatë intervistës me pedagogët u shprehën disa shqetësime që kanë lidhje më praktikat mësimore që e vështirësojnë zhvillimin e saj:<br>- Kosto e transportit të studentëve<br>- Pagesat e siguracionit të studentëve gjatë periudhës së punësimit/praktikës;<br>- Pamundësia e matjes së efektivitetit të praktikave mësimore.<br>Për të adresuar këto shqetësime është ngritur një grup pune këshillimor nga Dekani dhe punohet për ndërgjegjësimin e studentëve.<br><br>*Evidenca:*<br>*Shtojca 2.10 Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave profesionale;*<br>*Shtojca 2.10.3 Lista e Projekteve Kombëtare dhe Ndërkombëtare;*<br>*Shtojca 2.10.2 Listë Përmbledhëse e Marrëveshjeve Institucionale;* |
| **Kriteri 3.** Për realizmin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe | Për realizimin e këtij kriteri UNIKO dhe FB kanë nënshkruar kontrata bashkëpunimi me institucione publike qendrore dhe lokale, Akademinë e Shkencave, Ministri, Institucione Kerkimore, biznese lokale në fushën e agrobiznesit.<br>Për cdo student ka pedagog drejtues i cili pregatit programin e praktikës profesionale sipas lëndëve të programit që ndjek. Kjo bazohet në Rregullore e Njësisë Bazë Departamenti i Agrobiznesit.<br><br>*Evidenca:*<br>*Shtojca 2.10.2 Listë Përmbledhëse e Marrëveshjeve Institucionale*<br>*Shtojca 2.10 Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave profesionale;*<br>*Shtojca 2.10 Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave profesionale;*<br>*Shtojca 2.3 Rregullore e Njësisë Bazë Departamenti i Agrobiznesit, Neni 22, Pika 4,5,6;* |

| | |
|---|---|
| mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve. | *Shtojca 2.3 Rregullore e Njësisë Bazë Departamenti i Agrobiznesit, Neni 22, Pika 9* |
| **Kriteri 4.** Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. | Sipas përgjigjeve të pëdagove bëhen analiza "rreth projekteve në të cilët janë përfshirë anëtarët e departamentit, si dhe për të thelluar mundësitë e bashkëpunimit, përfshirë realizimin e projekteve të përbashkëta kërkimore, kryerjen e praktikave profesionale, si dhe përmirësimin e programeve të studimit me njohuri bashkëkohore".<br>Në materialet e upload në e-Ascal nuk ka ndonje shtojce apo evidence qe e tregon ketë.<br>Referuar raportit të analizës vjetore në GVB i referohet Shtojca 2.4 Raporti i Analizës Vjetore të Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore & Financiare i UNIKO 2022-2023 (a ka rapport të përditësuar)<br><br>*Evidenca:*<br>*Shtojca 3.8 Analiza Vjetore e Veprimtarisë së Njësisë Bazë*<br>*Shtojca 2.13 Analiza e Punës Mësimore & Kërkimore-Shkencore, e FB për Vitin Akademik 2022-2023* |
| **Konkluzione** | *Institucioni përmbush kërkesat lidhur me ofrimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.*<br>*Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe të huaja për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve.*<br>*Institucioni ka nënshkruar marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushe t pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

| **Standardi II.1** |
|---|

| Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). | Bazuar edhe në Rregullore e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore Shkencore të FB (Shtojca 2.2, neni 57) programet mësimore janë të organizuara në lëndë/module dhe të vlerësuara në kredite sipas sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi i ciklit të dytë të studimit (MP) në "Drejtim Agrobiznesi" me shtrirje kohore 1 vit akademik organizohet 60 kredite.<br>Veprimtaritë formuese të programit të studimit bazohen në ligjin përkatës dhe kategorizohen në:<br>a) Lëndë bazë;<br>b) Lëndë karakterizuese ;<br>c) Lëndë ndërdisiplinore/integruese;<br>d) Lëndë plotësuese (module formuese të zgjedhura nga studentët;<br>e) Detyrime përmbyllëse (temë diplome)<br><br>*Evidenca:*<br>*Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore-Shkencore e FB, Neni 57*<br>*Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore-Shkencore e FB;*<br>*Shtojca 2.7 Plani Mësimor i Programit të studimit 2024-2025* |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionesh e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një | Bazuar në shtojcat 2.5 Rregullore e Programit të Studimit (MP) në "Drejtim Agrobiznesi" 2024-2025 Shtojca 1 (Plani Mësimor) dhe 2.7 Plani Mësimor i Programit të studimit 2024-2025 FB prezanton objektivat kryesore të programit të studimit MP Drejtim Agrobiznesi te tilla si: pregatitja e specialisteve te kualifikuar në fushën e drejtimit dhe menaxhimit të sipermarrjeve te agrobiznesit, menaxhimin e burimeve natyrore, nxitjen e aktiviteteve kërkimore, njohuri në fushat e ekonomisë, finance-kontabilitetit, marketingut, teknologjisë dhe inovacionit, etj.<br>*Evidenca:*<br>*Shtojca 2.5 Rregullore e Programit të Studimit (MP) në "Drejtim Agrobiznesi" 2024-2025*<br>*Shtojca 2.7 Plani Mësimor i Programit të studimit 2024-2025*<br>*Shtojca 2.8 Programet Lëndore të Programit të Studimit* |

| | |
|---|---|
| fushë të specializuar studimi ose profesionale. | |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse. | Bazuar në shtojcën 2.7 Plani mësimor i Programit të Studimit 2024-2025, në programin e ciklit të dytë të studimit MP Drejtim Agrobiznesi praktika mësimore profesionale realizohet në dy simestra. Departamenti bën evidentimin e bizneseve apo institucioneve të mundëshme ku mund të kryhen praktikat dhe krijon lidhje me to. Studenti nga ana e ti i propozon departamentit vendin ku do zhvilloje praktikën dhe mes palëve lidhet kontrata e cila firmoset nga dekani.<br>Pedagogu pregatit në cdo fillim vit programming e praktikës mësimore profesionale sipas lëndëve të programuara për këtë qëllim. Studentët njihen me programin e praktikës nga pedagogu udhëheqës i përcaktuar bazuar në planin mësimor semestral.<br>Në fund të praktikës studenti pregatit/prezanton relacionin për punën e kryer dhe ne fund merr vleresimin për të.<br>*Evidenca:*<br>*Shtojca 2.15 Struktura dhe Organigrama e UNIKO Viti Akademik 2024-2025;*<br>*Shtojca 2.7 Plani Mësimor i Programit të Studimit 2024-2025;*<br>*Shtojca 2.10 Marrëveshje Bashkëpunimi në Mbështetje të Praktikave Profesionale* |
| **Kriteri 4.** Programet e ciklit të dytë "Master" në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve "Master", sipas fushave përkatëse të formimit. | **N/A** |
| **Kriteri 5.** Programet "Master" në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të | **N/A** |

| | |
|---|---|
| formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet "Master", që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme. | |
| **Kriteri 6.** Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin. | Pranimi në programet e ciklit të dytë të studimit MP në FB, bëhet sipas përcaktimeve të Ligjit për Arsimin e Lartë, Statutit të universitetit, si dhe rregullores të njësisë kryesore/bazë.<br>Rregullore e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore-Shkencore e FB, neni 38 (shtojca 2.2) përcakton kriteret e pranimit të studentëve në programin e ciklit të dytë të studimit.<br>Statuti i Universitetit "Fan S. Noli" neni 56 përcakton mënyrën e financimit të universitetit.<br><br>*Evidenca:Shtojca 2.15 Struktura dhe Organigrama e UNIKO Viti Akademik 2024-2025;*<br>*Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore-Shkencore e FB, neni 38;*<br>*Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore-Shkencore e FB, neni 38;*<br>*Shtojca 1.1 Statuti i Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, neni 89* |
| **Kriteri 7.** Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind. | Sipas raportit të GVB dhe deklarimeve të pedagogëve në takim, programi i ciklit të dytë të studimit (MP) në "Drejtim Agrobiznesi" është unik në nivelin universitar.<br><br>*Evidenca:*<br>*Shtojca 1.1 Statuti i Universitetit "Fan S. Noli", Korçë* |
| **Kriteri 8.** Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit. | Program i ciklit të dytë të studimit (MP) në "Drejtim Agrobiznesi", me kohë të plotë, i ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë, Universiteti "Fan S. Noli" Korçë (UNIKO), është regjistruar në regjistrin shtetëror të diplomave dhe çertifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor me numër unik identifikimi: KO3437242126.<br>kodit të programit të ciklit të dytë të studimit (MP) në "Drejtim Agrobiznesi" është: (71 MP 0413 S) (Shtojca 2.5.1) dhe përkon me klasifikimin e përcaktuar sipas VKM nr 310 date 11.5.2022.<br>***Evidenca:*** |

<table>
<tr><td colspan="1"></td><td colspan="4">Shtojca 1.1 Statuti i Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, neni 56<br>Shtojca 3.23 Vërtetim i QSHA nr. 2626/9 Prot; datë 16.07.2027 "Për Regjistrimin në Regjistrin Shtetëror të Diplomave";<br>Shtojca 2.5.1 Praktika e plotë e dokumentacionit "Për Kodifikimin e Programeve të Studimit";<br><br>https://arsimi.gov.al/vendim-nr-310-date-11-5-2022-per-specifikimet-dhe-permbajtjen-e-kodifikimit-te-programeve-te-studimit-te-ofruara-nga-institucionet-e-arsimit-te-larte-ne-republiken-e-shqiperise/<br><br>Shtojca 2.5.1 Praktika e plotë e dokumentacionit "Për Kodifikimin e Programeve të Studimit";</td></tr>
<tr><td>Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</td><td colspan="4">Programi i studimit (MP) në "Drejtim Agrobiznesi" ofrohet vetëm nga UNIKO.<br>Evidenca:<br>Shtojca 2.6.1 Urdhër i MAS nr. 453, datë 14.08.2023 "Për hapjen e programit të përbashkët të studimit (MP) në MQAT"</td></tr>
<tr><td>Konkluzione</td><td colspan="4">Elementët e strukturës së programit të studimit dhe aktivitetet formuese të shoqëruara me kredite janë përcaktuar në mënyrë të qartë, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).Ky program synon të përgatisë studentët me aftësi të veçanta në një gamë të gjerë profesionistësh dhe specialitetesh, duke ofruar njohuri të avancuara në një fushë të caktuar studimi apo pune. Ai përfshin gjithashtu të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës përkatëse, dhe nxit zhvillimin e njohurive, aftësive dhe kompetencave të thelluara që nevojiten për të zgjidhur probleme komplekse dhe të paparashikueshme brenda një fushe të specializuar akademike ose profesionale.<br>Organizimi i studimeve, procedura e pranimit të studentëve dhe mënyra e financimit për institucionin realizohen në përputhje me legjislacionin për arsimin e lartë dhe udhëzimet specifike të përcaktuara nga ministria e arsimit.<br>Programi i studimit është i pajisur me kodin përkatës, sipas fushës së tij dhe në përputhje me klasifikimet e publikuara nga ministria. Po ashtu është kryer edhe kodifikimi i lëndëve përkatëse brenda programit.</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Shkalla e përmbushjes së standardit</td><td>Nuk përmbushet</td><td>Përmbushe t pjesërisht</td><td>Përmbushet kryesisht</td><td>Përmbushet plotësisht</td></tr>
<tr><td></td><td></td><td></td><td>X</td></tr>
</table>

| **Standardi II.2**<br>**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin. | Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin. Bazuar në statusin e UNIKO (shtojca 1.1) "Fakulteti është njësia kryesore që bashkërendon mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe zhvillimin kulturor në fusha mësimore-shkencore të përafërta ose të ndërthurura". Departamenti është njësi bazë kërkimore-shkencore në UNIKO. Departamenti i Agrobiznesit (DA), si njësi akademike bazë, përbëhet nga 7 pedagogë me kohë të plotë, nga të cilët 2 të kategorisë professor, dhe 5 pedagogë me gradën Doktor (shtojca 2.13). Pranë departamentit është angazhuar 1 pedagog me kohë të pjesshme që mban titullin Prof. dr.<br>2 Prof.As,<br>5 Dr<br>2023-2024 7 PAE<br>2024-2025 7 PAE/ 1PAK<br><br>*Evidenca:*<br>*Shtojca 1.1 Statuti i Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, neni 5,7,8*<br>*Shtojca 2.3 Rregullore e Njësisë Bazë Departamenti i Agrobiznesit, Neni 5;*<br>*Shtojca 1.1 Statuti i Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, neni 8 pika 4;*<br>*Shtojca 2.13 Analiza e Punës Mësimore dhe Kërkimore-Shkencore, e FB për Vitin Akademik 2022-2023,*<br>*Shtojca 2.3 Rregullore e Njësisë Bazë Departamenti i Agrobiznesit, Neni 5, pika 3;*<br>*Shtojca 2.13 Analiza e Punës Mësimore dhe Kërkimore-Shkencore, e FB për Vitin Akademik 2022-2023* |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin | Departamenti përmbush kushtet lidhur me personelin ndihmës akademik për programin e studimit. Për realizimin e këtij kriteri në Fakultetin e Bujqesise janë punësuar personel ndihmës-akademik me karakter mësimor dhe administrativ ndërsa pranë njësisë bazë |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj. | "Agrobiznes", është atashuar edhe një punonjëse (ndihmës akademik) "sekretar-laborant".<br>*Evidencat:*<br>*Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore-Shkencore e FB, neni 23* | | | |
| **Kriteri 3.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. | Koordinatori i programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij, është anëtar efektiv i Departamentit dhe është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit mësimor dhe praktikave profesionale, në përputhje me objektivat e tyre (Shtojca 2.3), (Shtojca 2.11)<br>Në rregulloren e departamentit janë të përcaktuara detyrat e koordinatorit (Shtojca 2.3).<br>*Evidenca:*<br>*Shtojca 2.3 Rregullore e Njësisë Bazë Departamenti i Agrobiznesit, Neni 14, pika 2 & 3* | | | |
| **Konkluzione** | *Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.*<br>*Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushe t pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi II.3**<br>**Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. | Bazuar në materialet e upload ne e-ASCAL, intervistimit të grupit të GVB dhe takimit me dekanin e FB dhe pedagogët, njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.<br>UNIKO perbehet nga:<br>- Fakulteti i Edukimit dhe Filologjise<br>- Fakulteti i Bujqesise<br>- Fakulteti i Ekonomise |

| | |
|---|---|
| | - Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane<br>FB përbëhet nga 3 departamente: Departamenti i Agrobiznesit; Departamenti i Agronomisë; dhe Departamenti i Agroushqimit. Ndërkohë që Departamenti i Agrobiznesit realizon 3 komponentët kryesorë: Mësim, kërkim, zhvillim. Programet mësimore organizohen në module dhe vlerësohen me ECTC.<br>Nga evidence rezulton si me poshte:<br>- lëndë bazë/të formimit të përgjithshëm (5 kredite ose 8.3%);<br>- lëndë të formimit karakterizues (23 kredite ose 38.3%);<br>- lëndë ndërdisiplinore/integruese (17 kredite ose 28.3%);<br>- lëndë plotësuese (6 kredite ose 10%);<br>- detyrimet përmbyllëse (9 kredite ose 15%)<br>Ne opinionin tone kjo eshte nje shperndarje normale bazuar ne rregulloren e UNIKO dhe planit mesimor 2024-2025.<br><br>*Rerenca:*<br>Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore Shkencore e FB, Kreu II, Neni 4;<br>*Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore Shkencore e FB, Kreu II, Neni 5;*<br>*Shtojca 2.3 Rregullore e Njësisë Bazë Departamenti i Agrobiznesit, Neni 9, pika 1*<br>*Shtojca 2.3 Rregullore e Njësisë Bazë Departamenti i Agrobiznesit, Neni 19;*<br>*Shtojca 2.6.1 Urdhër i MAS nr. 453, datë 14.08.2023 "Për hapjen e programit të përbashkët të studimit (MP) në MQAT"*<br>*Shtojca 2.9 Jetëshkrimet e stafit të përfshirë në programin e studimit*<br>*Shtojca 1.12 Udhëzim për procedurat e miratimit, botimit & shpërndarjes së teksteve mësimore në nivel njësie bazë;*<br>*Shtojca 2.3 Rregullore e Njësisë Bazë Departamenti i Agrobiznesit, Neni 9* |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit. | Bazuar në materialet e upload ne e-ASCAL, intervistimit të grupit të GVB dhe takimit me dekanin e FB dhe pedagogët, Plani mësimor vlerësohet si dokumenti themelor i programit të studimit.<br>Sipas shtojcës 2.7.1 plani mësimor përmban informacion mbi strukturën javore të elementëve të veprimtarisë akademike (javë mësimi, praktike, provime, diploma); shpërndarjen e krediteve sipas çdo disipline në: leksione /seminare/ushtrime /laboratorë etj; ngarkesën në auditor, ngarkesa javore në auditor; kreditet për çdo lëndë/modul etj. |

| | |
|---|---|
| | Ne vleresimin e GVJ shpemdarja e krediteve eshte konform rregullores se UNIKO dhe planit mesimor 2024-2025. Plani Mësimor Aktiv (PMA), përmban informacion të detajuar të planit mësimor të vitit aktual, pedagogët e çdo lënde/moduli, etj.<br>*Evidenca:*<br>*Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore-Shkencore e FB, Neni 58;*<br>*Shtojca 2.7 Plani Mësimor i Programit të Studimit;*<br>*Shtojca 2.7.1 Plani Mësimor Aktiv 2024-2025* |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. | Bazuar në Shtojca 2.2 dhe 3.26, janë të përcaktuara procedurat e programet e ciklit të dytë të studimit, kushtet diplomimit, informacioni për transferimet e studimeve, transferimin e studimeve në të njëjtin cikël studimi, proçedurat për transferim, ekuivalentimi i programeve të studimeve për studentët që transferohen, procedurat e regjistrimit pas transferimit, format e apelimit, proçedurat e ndrimit të programit të studimit, ndjekja e një programi të dytë studimi, dhe modalitetet e ndërprerjes së studimeve apo largimit.<br>*Evidenca:*<br>*Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore Kërkimore-Shkencore e FB, Neni 38;*<br>*Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore-Shkencore e FB, neni 50*<br>*Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore Kërkimore-Shkencore e FB, Neni 83;*<br>*Shtojca 3.26 Praktikë e plotë për procedurat e transferimit të studimeve;*<br>*Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore-Shkencore e FB* |
| **Kriteri 2.** Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | Në ëeb faqen e universitetit dhe në syllabuset e lendëve janë të shprehura qartë detyrimet e studentit, metodat e vlerësimit, pikët e domosdoshme, etj. Vlerësimi bazohen në Rregulloren e Studimeve të UNIKO, në Rregulloren e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore të FB, në Rregulloren e Programit të Studimit (MP) në "Drejtim Agrobiznesi", si dhe në programin lëndor (të çdo lënde/moduli). |

| | |
|---|---|
| | Mënyrat e kontrollit të dijeve përcaktohen në programin e modulit dhe planin mësimor të studimeve të cilat i bëhen të njohura studentit në fillim të procesit mësimor.<br>*Evidenca:*<br>*Shtojca 1.6 Manual i sistemit elektronik PITAGORA* |
| **Kriteri 3.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. | Format e testimit dhe vlerësimit të njohurive janë të përcaktuara në në programet lëndore (syllabuset) e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit, dhe kryhen në bazë të kritereve dhe procedurave të përcaktuara në Rregulloren e Universitetit "Fan S. Noli". Ato reflektohen edhe ne rregulloren e njesisë kryesore (FB) dhe të njësisë bazë (DA)<br>*EvidencaShtojca 1.2 Rregullore e Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, Kreu VII;*<br>*Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB, Neni 53,54;*<br>*Shtojca 2.5 Rregullore e Programit të Studimit (MP) në "Drejtim Agrobiznesi" 2024-2025;*<br>*Shtojca 2.8.1 Model Programi lëndor i Programit të studimit "Metodat e Vlerësimit të Politikave Bujqësore"*<br>*Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB, Neni 53;* |
| **Konkluzione** | *Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.*<br>*Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.*<br>*Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| |
|---|
| **Standardi III.3**<br>**Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.** |

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | Mënyra e vlerësimit dhe testimit të njohurive janë të përcaktuara në Rregulloren e Universitetit "Fan S. Noli" dhe të në rregulloren e njësisë kryesore dhe njësisë bazë. Po ashtu metodat e vlerësimit dhe literaturën prezantohen edhe në syllabusin e lëndës (krahas përshkrimit të lëndës, semestrit, ECTS, objektivat e lendës, detyrimet e studentit për detyra apo projekte te kursit, detyrat individuale apo në grup, etj.<br>Provimi final mund të zhvillohet me shkrim ose me gojë sipas programit të lëndës/modulit përkatës ose i kombinuar në të dyja format. Zgjedhja e formës së provimit bëhet nga pedagogu/ët e lëndës, pasqyrohet në programin lëndor, dhe iu bëhet e ditur studentëve që në fillim të semestrit.<br>Vlerësimi bëhet me pikë nga 1-100 dhe konvertohen sipas rregullores me nota nga 1-10. Nota kaluese minimale është 5 dhe ajo maksimale 10.<br>*Evidenca:*<br>*Shtojca 1.2 Rregullore e Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, neni 84*<br>*Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB;*<br>*Shtojca 2.8.1 Model Programi Lëndor "Metodat e Vlerësimit të Politikave Bujqësore"*<br>*Shtojca 1.2 Rregullore e Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, neni 73;*<br>*Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB, Neni 83*; |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. | UNIKO ka nënshkruar me Fondin Shqiptar Amerikan të Zhvillimit (AADF) një marrëveshje për instalimin e platformës digjitale "CleanScore" për sekretimin dhe leximin elektronik të testeve si dhe për përkthimin e testeve fondamentale. Në UNIKO, tashmë është fakt që nëpërmjet "CleanScore" mundësohet korrigjimi i automatizuar i provimeve.<br>***Evidenca:***<br>**https://ëëë.cleanscore.al/** |
| **Kriteri 3.** Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. | Mënyra e vlerësimit dhe testimit të njohurive janë të përcaktuara në Rregulloren e Universitetit "Fan S. Noli" dhe të në rregulloren e njësisë kryesore dhe njësisë bazë. Po ashtu metodat e vlerësimit dhe literaturën prezantohen edhe në syllabusin e lëndës (krahas |

| | |
|---|---|
| | përshkrimit të lëndës, semestrit, ECTS, objektivat e lendës, detyrimet e studentit për detyra apo projekte te kursit, detyrat individuale apo në grup, etj.<br>Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.<br>Vlerësimi bëhet me pikë nga 1-100 dhe konvertohen sipas rregullores me nota nga 1-10. Nota kaluese minimale është 5 dhe ajo maksimale 10.<br>*Evidenca:*<br>*Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB, Neni 61;*<br>*Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB;*<br>*Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB, Neni 53, 54;* |
| **Kriteri 4.** Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. | Vlerësimi i injohurive, dijeve dhe aftësive profesionale për të gjithë elementët e prezantuara në syllabus si provim i ndërmjetë, detyra individuale, detyra ne grup, detyra kursi, provimi përfundimtar etj, shoqerohet me komente përkatëse të cilat i prezantohen studentit. Per vleresimin e provimit përfundimtar pikët/notat hidhen në sisten brenda 2-8 ditëve ne varesi te mënyrës së realizimit të tëstimit të njohurive me shkrim ose me goje (ose të kombinuara). Mos hedhja në sisten brenda afateve penalizohet bazuar në Rregulloren e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB, Neni 16 dhe 72.<br>Në rast se studenti ka ankesë për vlerësimin ai ka të drejtë të ankimojë ate. Për rivleresimin e provimit apo vlerësimin e ankimimit ngrihet nja grup i cili pasi bën vlerësimin kthen përgjigje. Pas rivleresimit nota është përfundimtare.<br>*Evidenca:*<br>*Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB, Neni 16 dhe 72* |
| Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. | Komisioni i provimit të një lënde/moduli përbëhet nga jo me pak se dy vetë, nga të cilët njeri duhet të jetë pedagogu i lëndës/modulit. Komisioni caktohet nga Pergjegjesi i Departamenti se bashku me zv/Rektorin për mesimin. Nëse për arsye madhore pedagogu i lëndës nuk mund të jetë prezent në provim Pergjegjesi i Departamentit me miratimin e Dekanit e zevendeson atë me një pedagog tjetër. Zëvendësimi bëhet me urdhër me shkrim. |

| | |
|---|---|
| | Studentit përveç mjetit të identifikimit ID/ose pasaportë nuk i lejohet mbajtja dhe përdorimi i materialeve të tjera shkresore apo mbajtja e celularit në provim. Në rast se konstatohet e kundërta gjatë provimit ai përjashtoihet nga provimi.<br>*Evidenca:*<br>*Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB, Neni 73, pika 7*<br>*Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB, 73, pika 5;*<br>*Shtojca 1.2 Rregullore e Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, neni 84 Kreu VII;* |
| **Kriteri 6.** Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. | Vlerësimi i studentit ndahet në dy pjesë: vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për elementët e përcaktuar në programin e modulit të tilla si provimi i ndërmjetëm, detyra individuale apo në grup, detyra kursi etj, si dhe vlerësimi përfundimtar. Hedhja e rezultateve ne sistem behet bazuar në rregulloret përkatëse të UNIKO dhe te FB.<br>*Evidenca:*<br>*Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB, Neni 16 dhe 72* |
| **Kriteri 7.** Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. | Sic u përmend në kriterin 4 Vlerësimi i injohurive, dijeve dhe aftësive profesionale për të gjithë elementët e prezantuara në syllabus si provim i ndërmjetë, detyra individuale, detyra ne grup, detyra kursi, provimi përfundimtar etj, shoqerohet me komente përkatëse të cilat i prezantohen studentit. Per vleresimin e provimit përfundimtar pikët/notat hidhen në sisten brenda 2-8 ditëve ne varesi te mënyrës së realizimit të tëstimit të njohurive me shkrim ose me goje (ose të kombinuara). Mos hedhja në sisten brenda afateve penalizohet bazuar në Rregulloren e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB, Neni 16 dhe 72.<br>*Evidenca:*<br>*Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB, Neni 76* |
| **Kriteri 8.** Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet. | Në rast se studenti ka ankesë për proceduren e realizimit të provimit, trajtimin gjatë provimit apo për vlerësimin, ai ka të drejtë ta ankimojë ate. Për trajtimin e ankimimit ngrihet nje grup i cili pasi bën vlerësimin i kthen përgjigje studentit. Përgjigja dokumentohet dhe arkivohet. Pas rivleresimit nota është përfundimtar.<br>*Evidenca:* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB, Neni 76* | | | |
| **Konkluzione** | *Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.*<br>*Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, Clean Score të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.*<br>*Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.*<br>*Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | X |

| **Standardi III.4**<br>**Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve. | Objektivat e programeve të studimit që ofrohen në FB dhe DA synojnë pajisjen me njohuritë bazë dhe specifike mbi shkencat e Bujqësisë, Agroushqimit dhe Agrobiznesit, sipas profileve përkatëse.<br>Kurrikula e programit të ciklit të dytë të studimit (MP) në "Drejtim Agrobiznesi" mundëson njohuri të thelluara në disiplina të ndryshme si: "Biometri dhe eksperimentim shkencor në bujqësi", "Inovacin në zhvillimin rural", "Menaxhim i burimeve natyrore".<br>Në funksion të studentëve që angazhohen në aktivitete kërkimore-shkencore në kurrikulën e këtij programi studimi është përfshirë edhe lënda "Metodologji Kërkimi".<br>*Evidenca:Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB;*<br>*Shtojca 2.7.1 Plani Mësimor Aktiv (PMA) i Programit të Studimit;*<br>*Shtojca 2.7 Plani Mësimor i Programit të Studimit* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj). | Për tú mundësuar studentëve përfitim të njohurive dhe shprehive praktike për të zhvilluar aftësitë e tyre komunikuese, aftësitë për të punuar në grup, të aftësohen në fushën e teknologjisë dhe informacionit, dhe gjithashtu të përvetësojnë përdorimin e terminologjisë ekonomike në gjuhën angleze, në programin e ciklit të dytë të studimit (MP) në "Drejtim Agrobiznesi" jepen edhe lënde si "Gjuha Angleze"dhe "Biznesi Ndërkombëtar".<br>*Evidenca:*<br>*Shtojca 2.7 Plani Mësimor i Programit të Studimit;*<br>*Shtojca 2.5 Rregullore e Programit të Studimit (MP) në "Drejtim Agrobiznesi" 2024-2025* |
| **Kriteri 3.** Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse. | Syllabusi i lëndës i jep informacion studentit mbi titullarin dhe pedagoget, kohezgjatjen, numrin e krediteve, pershkrimin e temave, mënyrën e vlerësimit, etj.<br>Në përfundim të lendës analizohen kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti. Pedagogët orientojnë studentët tek çështjet më të rendësishme dhe detyrimit përmbyllëse të studentëve.<br>*Evidenca:*<br>*Shtojca 1.2 Rregullore e Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, neni 71*<br>*Shtojca 3.17 Model Analize në përfundim të një moduli;*<br>*Shtojca 2.12.1 Shkresë (Relacion) për angazhim në rishikimin periodik të programeve të studimit;* |
| **Kriteri 4.** Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet | Ndryshimet dinamike të diktuara nga strategjitë rajonale dhe kombëtare të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror, diktojnë nevojën për një përshtatje sa më të mirë të nevojave që ka tregu i punës, me formimin profesional të studentëve.<br>Në funksion të përfitimit të kompetencave dhe mundësimi i zhvillimit të njohurive tek studentët, UNIKO ka nenshkruar marreveshje me institucione publike dhe private për realizimin e praktikave mësimore-profesionale. Po ashtu i kushtohet rëndësi punëve në grup të studentëve, pjesmarrjes së tyre në konferencat shkencore studentore, tryezat e rrumbullakta, etj.<br>Nga ana e tyre pedogogët dhe DA bën rishikimin e literaturës dhe të sillabuseve në funksion të përditësimit të tyre me informacionet më të fundit.<br>Po aq të rëndësishme jane edhe shkembimet dhe mobiliteti me IAL apo universitetet nderkombëtare që ata kanë, të tilla si Universitetit "Nuertingen-Geislingen", Gjermani, Instituti kërkimor "CIHEAM", Mësimdhënie në programin e ciklit të tretë të studimit (Master) pranë UBT, Universitetin e Savonias, Finland. |

| | |
|---|---|
| bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve. | *Evidenca:*<br>*Shtojca 2.7 Plani Mësimor i Programit të studimit 2024-2025;*<br>*Shtojca 2.9.1 Certifikata pjesëmarrje e stafit akademik në bashkëpunime ndërkombëtare*<br>*Shtojca 2.10 Marrëveshje Bashkëpunimi në Mbështetje të Praktikave Profesionale;*<br>*Shtojca 2.19 Model i hartimit të një moduli, në bashkepunim me staf akademik të Universitetit Hohenheim,*<br>*Shtojca 2.20 Model i hartimit të një moduli, në bashkepunim me staf akademik & Institutit kërkimor-shkencor CIHEAM*<br>*Shtojca 3.10 Praktika e Organizimit të Tryezave të Përbashkëta me Operatorët e Sektorit Privat;*<br>*Shtojca 3.12 Studim Tregu për Programin e Studimit "Drejtim Agrobiznesi", 2024;*<br>*Shtojca 3.6 Raporti i Përfitimeve nga Marrëveshjet në Funksion të Programit të Studimit*<br>*Shtojca 3.29.3 Kontratë Pune (Staf Akademik i Angazhuar me Kohë të Pjesshme);*<br>*Shtojca 3.30 Kontrata Mobiliteti të studentëve* |
| **Kriteri 5.** Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit. | Gjatë vitit akademik 2023-2024 janë zhvilluar disa leksione të hapura me tematika të ndryshme, sipas fushave specifike të kërkimit, takime në formën e tryezave të rrumbullakëta që kanë për qëllim shkëmbimin e ideve në lidhje me proçeset e mësimdhënies dhe lidhjes së rezultateve të të nxënit me kualifikimin. (Shtojca 3.10 P).<br>*Evidenca:*<br>*Shtojca 3.8 Analiza Vjetore e Veprimtarisë së Njësisë Bazë*<br>*Shtojca 3.10 Praktika e organizimit të tryezave të përbashkëta me operatorët e sektorit privat;* |
| **Kriteri 6.** Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato. | Nxitjen e zhvillimit të ideve inovative FB , DA e realizon nëpërmjet organizimit të konferencave studentore, pjemarrjes ne konferenca shkencore kombetare dhe ndërkombëtare, tryezave të rrumbullakta, shkembimeve mobile të studentëve dhe pedagogëve, etj |
| **Konkluzione** | *Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.*<br>*Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.*<br>*Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | X |

| **Standardi III.5**<br>**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike. | Sipas Rregullores se Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB, Neni 36, studentët e programit të ciklit të dytë të studimeve diplomohen me provim (formimi) të përgjithshëm përfundimtar, ose me punim diplome, kur plotësojnë kriterin e notës mesatare të vendosur nga njësia bazë. Programi i provimit të përgjithshëm përfundimtar është gjithëpërfshirës, me tematika nga fushat kryesore që mbulon programi i studimit. Studenti që plotëson kriterin e notës mesatare ka të drejtë të shprehë dëshirën (kërkesën) në lidhje me punimin e diplomës që kërkon të zhvillojë, dhe udhëheqsin e tij.<br>Rregullore e Programit të Studimit (MP) në "Drejtim Agrobiznesi" 2024-2025, *(Shtojca 3-Manuali)* departamenti përcakton listën e temave për diploma në fillim të simestrit të dytë për ciklin e dytë të studimive, kriteret dhe standartet e përgatitjes së një punimi diplome të nivelit të dytë (MP), në rregulloren e diplomimit. Më pas departamenti shqyrton listen e kërkesave dhe harton listen e studentëve që plotësojnë kritetret me temën dhe pedagogun udhëheqës ja dërgon listën për miratim dekanit të FB në fillim të semestrit të dytë.<br>*Evidenca:Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB, Neni 36;* |
| | *Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB, Neni 36;*<br>*Shtojca 2.5 Rregullore e Programit të Studimit (MP) në "Drejtim Agrobiznesi" 2024-2025, (Shtojca 3-Manuali);* |

| | |
|---|---|
| | *Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB, Neni 82 dhe 83;*<br>*Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB, Neni 82 dhe 83*<br>*Shtojca 2.3 Rregullore e Njësisë Bazë Departamenti i Agrobiznesit, Neni 9, pika o;*<br>*Shtojca 2.22.1 Vendim Departamenti "Mbi miratimin e fushave të kërkimit dhe temave të diplomës";* |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse. | Sipas Rregullore e Programit të Studimit (MP) në "Drejtim Agrobiznesi" 2024-2025 koordinatori i programit, strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke venë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.<br>*Evidenca:*<br>*Shtojca 2.5 Rregullore e Programit të Studimit (MP) në "Drejtim Agrobiznesi" 2024-2025;*<br>*Shtojca 2.5 Rregullore e Programit të Studimit (MP) në "Drejtim Agrobiznesi" 2024-2025;*<br>*Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB, Neni 36;*<br>*Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB, Neni 36;* |
| **Kriteri 3.** Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. | Programi i provimit të përgjithshëm përfundimtar është gjithëpërfshirës, me tematika nga fushat kryesore që mbulon programi i studimit. Programi hartohet nga stafi i njësisë bazë, miratohet nga Përgjegjësi i Departamentit, si dhe Dekani i Fakultetit. Ai publikohet në faqen ëeb të Fakultetit të Bijqësisë, në ambjentet e fakultetit, u njoftohet studentëve individualidht, etj.<br>Provimi realizohet përpara një komisioni të posaçëm, të përbërë nga pedagogë të departamentit, të fushave që mbulon programi i provimit. Anëtarët e komisionit propozohen nga Përgjegjësi i Departamentit përkatës dhe miratohen nga Dekani.<br>Tezat e provimit të formimit hartohen nga anëtarët e komisionit, të cilët i përzgjedhin pyetjet nga fondi i krijuar në përputhje me peshën specifike të çdo fushe, firmosen nga përgjegjësi i Departamentit dhe miratohen nga Dekani i Fakultetit.<br>Provimi organizohet me gojë. Rezultatet e provimit të formimit u jepen studentëve në fund të çdo dite provimi.<br>***Evidenca:*** |

| | |
|---|---|
| | *Shtojca 3.9 Propozim për Komisionet e Provimeve të Formimit;*<br>*Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB;*<br>*Shtojca 2.22.2 Model Teza Provim Formimi;* |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. | Udhëheqësi i punimit të diplomës përgatit programin e punës së studentit, duke vendosur edhe afatet e përafërta të realizimit të tij. Ndërkohë studenti nga ana e tij duhet të respektojë afatet e percaktuara për dorëzimin e punimit.<br>Para dorëzimit pedagogu udhëheqës rishikon punimin dhe duke e firmosur miraton dorëzimin dhe prezantimin e temes.<br>Tema e diplomës, para mbrojtjes së saj, vlerësohet nga një pedagog oponent i caktuar nga përgjegjësi i departamentit përkatës. |
| **Kriteri 5.** Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit. | Siaps Struktura dhe Organigrama e UNIKO dhe FB (Viti Akademik 2024-2025) FB, si njësi kryesore, krahas infrastrukturës laboratorike didaktike, në strukturën e vet ndihmës akademike ka në administrim edhe Ekonominë Didaktike Eksperimentale (EDE), që shërben si një laborator fushor (natyral), në të cilën asistojnë punonjësit laburantë/sekretarë të departamenteve.<br>Këto struktura ndihmës-akademike shërbejnë për t'ju ardhur në ndihmë pedagogëve dhe studentëve në realizimin veprimtarisë akademike, studimeve, projekteve të ndryshme studimore, praktikave mësimore profesionale si dhe aktiviteteve të ndryshme shkencore. Studetënt kanë të drejtë të përdorin laboratorët e UNIKO dhe FB për të kryer analiza dhe përpunime të dhënash. Stafi akademik si dhe ndihmës akademik ofron mbështetjen, si dhe i konsultojnë për metodologjitë e përpunimit të të dhënave.<br>*Evidenca:*<br>*Shtojca 2.15 Struktura dhe Organigrama e UNIKO dhe FB (Viti Akademik 2024-2025);* |
| **Kriteri 6.** Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë. | Provimi realizohet përpara një komisioni të posaçëm, të përbërë nga pedagogë të departamentit, të cilët propozohen nga përgjegjësi i departamentit dhe miratohen nga Dekani.<br>Rezultatet e provimit të formimit u jepen studentëve në fund të çdo dite provimi. |

| | |
|---|---|
| | Në përfundim të procesit të provimit, komisioni hedh rezultatet në sistem, printon proçesverbalin, i cili firmoset nga të gjithë anëtarët e komisionit të provimit.<br>*Evidenca:*<br>*Shtojca 3.9 Propozim për Komisionet e Provimeve të Formimit;*<br>*Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB, Neni 83* |
| **Kriteri 7.** Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. | Studentët të cilët kanë përfunduar të gjitha detyrimet e programit të studimit (MP), pajisen me dilopmën përkatëse, e cila është dokument zyrtar.<br>Diploma shoqërohet me listën e notave dhe suplementin/shtojcën e diplomës, sipas modelit të miratuar dhe në përputhje me programin e studimit të ndjekur nga studenti.<br>Përmbajtja dhe forma e suplementit të diplomës përcaktohen në statutin e institucioneve të Arsimit të Lartë në përputhje me udhëzimet e Ministrisë përgjegjëse për arsimin.<br>*Evidenca:*<br>*Shtojca 2.5.2 Modeli i Diplomës & i Suplementit të Programit të Studimit (MP) në "Drejtim Agrobiznesi";*<br>*Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB, Neni 62;*<br>*Shtojca 2.5 Rregullore e Programit të Studimit (MP) në "Drejtim Agrobiznesi" 2024-2025;*<br>*Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB;*<br>*Shtojca 1.2 Rregullore e Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, neni 72;*<br>*Shtojca 2.5.2 Suplementi & Modeli i Diplomës së Programit të Studimit;*<br>*Shtojca 3.23 Urdhër & Vërtetim i QSHA nr. 2626/9 Prot; datë 16.07.2027 "Për Regjistrimin në Regjistrin Shtetëror të Diplomave"* |
| **Kriteri 8.** Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen. | UNIKO, në përputhje me legjislacionin në fuqi, ruan kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin, nëse kërkohen.<br>Dokumentacioni për çdo student menaxhohet dhe ruhet nga specialistët e sekretarisë mësimore të Sektorit të studimeve.<br>*Evidenca:*<br>*Shtojca 1.10 Rregullore e Sektorit të Studimeve dhe Sektorit të TIK* |
| **Konkluzione** | *Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *rëndësisë dhe peshës specifike. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me note dhe Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes sëstandardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi III.6**<br>**Në rastin e programit të studimit në "Master Profesional" institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përftimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizmin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale. | FB, në funksion të veprimtarisë akademike, të aktiviteteve kërkimore shkencore si dhe në funksion të aftësimit teorik e praktik të studentëve apo objektivave formues të programit të studimit, ka në administrim 10 laboratore didaktike mësimorë dhe një "laborator fushor".<br>FB u siguron studentëve mundësi për zhvillimin e praktikave profesionale edhe në kompani, apo institucione publike me të cilat bashkëpunon për realizimin e të cilave ka nënshkruar kontrata bashkëpunimi.<br>*Evidenca:*<br>*Shtojca 4 Tabela 16 - Mjediset e Fakultetit / Njesive Bazë të FB;*<br>*Shtojca 1.8 Rregullore e Drejtorisë Financiare (EDE);*<br>*Shtojca 4 Tabela 16 - Mjediset e Fakultetit / Njesive Bazë të FB;*<br>*Shtojca 2.10 Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave profesionale*<br>*Shtojca 2.10.2 Listë Përmbledhëse e Marrëveshjeve Institucionale* |
| **Kriteri 2.** Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive | Për realizimin e praktikave mësimore-profesionale, FB ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh me operatorë të sektorit privat si dhe me institucione të ndryshme rajonale UNIKO, dhe në kontekstin e programit të studimit FB dhe DA kane partneritete e duhura me ente publike dhe kompani private si dhe agjenci shtetërore apo organizma të pushtetit lokal për të ndërtuar një program praktike apo stazhi të studentëve të programit, me qëllim marrjen dhe zbatimin e aftësive dhe njohurive praktike, duke cuar drejt një stafi me kompetencë profesionale në të nesërmen. |



| | |
|---|---|
| dhe kompetencave profesionale. | . <br>*Evidenca:* <br>*Shtojca 2.10 Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave profesionale;* <br>*Shtojca 4 Tabela 16 - Mjediset e Fakultetit / Njesive Bazë të FB* |
| **Kriteri 3.** Praktikat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës. | Departamenti, evidenton kompanitë/institucionet e mundshme për kryerjen e praktikës profesionale, si dhe mundëson krijimin e lidhjeve me to. Studenti mund t'i propozojë departamentit vendin ku mund të kryejë praktikën profesionale. Dekani i FB-së lidh marrëveshje bashkëpunimi me kompanitë pritëse deri një muaj para fillimit të praktikës profesionale. <br>Praktikat profesionale zhvillohen në institucione/kompani sipas profilit të përgatitjes së studentit dhe nën drejtimin e stafit akademik të caktuar nga Departamenti dhe ndiqet nga pedagogu i ngarkuar për këtë qëllim.. <br>Në përfundim të praktikës profesionale, studenti përgatit një relacion për punën e kryer, e cila vlerësohet në datën e caktuar nga departamenti dhe komisioni i ngritur prej tij, pasi merr në konsideratë edhe vlerësimin e kompanisë (qëndrës) ku është kryer praktika. <br>Vlerësimi i praktikës profesionale bëhet me notë. <br>*Evidenca:* <br>*Shtojca 2.10 Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave profesionale;* <br>*Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB, Neni 66;* <br>*Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB, Neni 66, pika 9* <br>*Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB, Neni 66, pika 10* |
| **Konkluzione** | *Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.* <br>*Praktikat profesionale, e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e drejtuesve dhe vlerësimin përkatës.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III | Nuk përmbush et | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

## IV.BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

| **Standardi IV.1**<br>**Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij. | Pranë Departamentit të Agrobiznesit (DA) angazhohen pedagogë me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme. Numri i pedagogëve me kohë të plotë është 9 për këtë program studimi<br>3 mbajnë titullin Prof.Assoc.Dr.<br>6 janë me titullin Doktor i Shkencave.<br>Ky numer nuk ka ndryshuar ne 3 vitet e fundit , ndërsa numri i stafit akademik i angazhuar me kohë të pjesshme, që kontribuojnë në mësimdhënie në programin e ciklit të dytë të studimit (MP) në "Drejtim Agrobiznesi", është aktualisht 1, por ne dy vitet paraardhese ka qene 2. Në këtë mënyrë respektohet kuadri ligjor dhe rregullator (Ligji 80/2015, neni 59 pika 6; Statuti i UNIKO; Rregullore e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore Shkencore e FB; dhe Rregullore e Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore) ku përcaktohet qartë se niveli minimal i gradës për rekrutimin dhe përbërjen e stafit akademik është "Master i Shkencave". Në këtë program studimi, angazhohet edhe 1 (një) Sekretare/Laborante me statusin e personelit ndihmës akademik.. Kriteret e rekrutimit të stafit akademik, per programin e studimit "Drejtim Agrobiznesi", janë përmbushur plotësisht pasi i gjithë personeli është me tituj dhe grada shkencore (minimumi Dr.) Gjithashtu me Vendimin e dates 17.01.2022 janë përcaktuar fushat e kërkimit për DA ku cdo anëtar i stafit akademik, në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij, ka të përcaktuar fushën kërkimore të studimit (të miratuar në department, në përputhje me strategjinë e zhvillimit dhe objektivat e njësisë) |

| | |
|---|---|
| | *Evidenca*<br>*Rregullore e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore Shkencore e FB;*<br>*Shtojca 4 Tabela 6.3 – Cilësia e Stafit Mësimdhënës për Programin e Studimit;*<br>*Shtojca 2.5 Rregullore e Programit të Studimit (MP) në "Drejtim Agrobiznesi" 2024-2025;*<br>*Shtojca 1.4 Rregullore e Drejtorisë Juridike dhe e Burimeve Njerëzore;*<br>*Shtojca 2.22.1 Vendim Departamenti per fushta e kerkimit shkencor dhe temat e diplomes*<br>*Tabela 12.1,2,3* |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në[i] fuqi. | Ngarkesa e plotë mësimore për çdo kategori të personelit akademik është përcaktuar në bazë të kuadrit ligjor në fuqi, konkretisht me Udhëzimet e MAS (Udhezimi nr.29, datë 10.09.2018), Mbi këtë bazë përgatitet ngarkesa e stafit akademik në fillim të çdo viti akademik. Në bazë të nevojës është parashikyar edhe një pëdagog me kohë të pjesshmë. Aktualisht, në zbatim edhe të VKM, nr. 418, datë 10/05/2017, personeli akademik efektiv mbulon afërsisht 100% te ngarkesës mësimore për këtë program. Ngarkesa mësimore vjetore për personelin akademik me kohë të plotë në auditor është e përcaktuar sipas titujve dhe gradave përkatëse. Çdo orë e realizuar mbi këtë përcaktim, konsiderohet orë suplementare, e cila me vendim edhe të organeve drejtuese të UNIKO, paguhet e plotë (deri në masën 200 orë mbi normë)<br>*Evidencat*<br>*Shtojca 2.7 Plani Mësimor i Programit të Studimit;*<br>*Shtojca 1.2 Rregullore e Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, Neni 31;*<br>*Shtojca 1.2 Rregullore e Universitetit "Fan S. Noli", Korçë;* |
| **Kriteri 3.** Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore. | Nga vizita në terren, takimi me Drejtorinë e Burimeve njerëzore, GVJ u informua se për një periudhë 5 (pesë) vjecare asnjë anëtar i stafit akademik të njësisë kryesore nuk është larguar nga puna, gjë që demonstron qëndrueshmërinë e stafit akademik efektiv gjatë viteve të fundit. Drejtoria e Financës në ushtrim të kompetencave të saj, cdo muaj dërgon on-line në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve deklarimin për çdo punonjës mbi derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat nga punësimi.<br>Ne takim u informuam që personeli akademik dhe ai joakademik kanë nëshkruar kontratat përkatëse të punësimit, të cilat |

| | |
|---|---|
| | formalizojnë detyrimet dhe të drejtat e punonjësve, si garanci për qëndrueshmërinë e stafeve. Por ne dokumentacionet e vena ne dispoziicion k a vetem kontrate per staf me kohe te pjesshme Gjithashtu, nga Sektori i Menaxhimit të buxhetit dhe të Ardhurave, plotësohen librezën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore mbi bazën e përllogaritjes së kontributeve që derdh çdo punonjës, duke garantuar qëndrueshmërinë e stafit akademik efektiv<br>*Evidencat*<br>*Shtojca 1.8 Rregullore e Drejtorisë së Financës;*<br>*Vizita në Institucion* |
| **Kriteri 4.** Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit e në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit | Njësia bazë, bazuar në nevojat për personel, përcakton kriteret e punësimit të personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme të cilat më tej miratohen nga Rektori.<br>Procedura e punësimit është transparente dhe formalizohet me një process të hapur Kriteret e përgjithshme të punësimit të personelit akademik përcaktohen edhe në Rregulloren e Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, ndërsa ato specifike në rregulloren e njësisë bazë.<br>Për vlerësimin e kandidatëve pjesëmarrës në konkurrim krijohet një komision *ad hoc* (i posaçëm), i përbërë në shumicë nga përfaqësues të njësisë bazë përkatëse. Dekani i njësisë kryesore, i kërkon Rektorit ngritjen e komisionit *ad hoc*, bazuar në kërkesën e njësisë bazë për personel akademik. Rektori vendos formimin e komisionit *ad hoc,* i cili duhet të ketë në përbërjen e tij 5 (pesë) anëtarë.Komisioni *"ad-hoc"* pasi vlerëson kanidatët bazuar në kriteret e vlerësimit, bën një renditje të tyre dhe këtë listë ia përcjell për miratim Dekanit të FB. Pas miratimit nga ana e Dekanit, merret miratimi përfundimtar nga Rektori , në cilësinë e punëdhënësit. Rektori i UNIKO shpall kandidatin fitues dhe lidh kontratën e punës me të. Vlerësimi i kandidatëve bëhet bazuar në një sistem pikësh ku rankohen si kriteret e përgjithshme ashtu edhe kriteret specifike. Vlerësimi maksimal bëhet me 100 pikë, nga të cilat 95 pikë janë përcaktuar për dosjen e kandidatit dhe 5 pikë për intervistën me gojë. Nga takimi me DBNJ rezultoi se intervista me gojë është për njohjen e kandidatit dhe për të vlerësuar aftësitë e të shprehurit dhe komunikimin e kandidatit.. Në kriteret e përgjithshme merr rëndësi edukimi dhe një notë mesatare e studimeve mbi 8. Për vlerësimin e kritereve të veçanta, në përcaktimin e pikëve i jepet rëndësi kualifikimeve shkencore që ka kandidati, botimeve, pjesëmarrjes në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare etj. Përzgjedhja e stafit akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme reultojnë të jenë me kualifikim të lartë e |

| | |
|---|---|
| | të profilizuar për lëndët për të cilat janë angazhuar në këtë program studimi. Antarët e stafit akademik të departamentit janë aktualisht të përfshirë në procesin e ngritjes së tyre në karrierë përmes angazhimit për marrjen e titujve më të lartë akademikë.<br>*Evidenca*<br>*Shtojca 1.1 Statuti i Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, Neni 45;*<br>*Shtojca 3.29 Procedura e Rekrutimit të Personelit Akademik;*<br>*Vizita në institucion, takimi me Dekanin dhe me DBNJ* |
| **Kriteri 5.** Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit. | Pranë DA është i punësuar një laborant/sekretar në cilësinë e personelit ndihmës akademik me karakter mësimor dhe/ose kërkimor-shkencor, i cili ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe/ose të kërkimit shkencor. Detyrat e personelit ndihmës-akademik të angazhuar pranë njësisë bazë "Agrobiznes" përcaktohen në Rregulloren e Brendshme të Departamentit të Agrobiznesit. Në vepirmtarinë e DA ndihmojnë edhe përfaqësues të personelit ndihmës–akademik me karakter administrativ, në nivel Fakultet<br>*Evidencat*<br>*Shtojca 2.3 Rregullore e Njësisë Bazë Departamenti i Agrobiznesit, Neni 17*<br>*Shtojca 1.4 Rregullore e Drejtorisë Juridike dhe e Burimeve Njerëzore* |
| **Kriteri 6.** Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ. | Të dhënat mbi personelin administrohen nga DJBNJ , nga e cila mblidhen, ruhen dhe përditësohen. Kjo Drejtori menaxhon dhe arkivon praktikën që lidhet me proçedurat e punësimit dhe dosjeve përkatëse. Këto të dhëna u përkasin anëtarëve të personelit akademik të përfshirë në programin e studimit, të përgjegjësit të Departamentit, i cili është edhe personi përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin akademik të çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.<br>Gjithashtu, të dhënat e përditësuara sipas kualifikimeve të stafit akademik dhe ndihmës akademik që angazhohen në programet e studimit, mbahen edhe në Departament nga Sekretaria e departamentit.<br>Angazhimi i cdo antari të Departamentit cdo fillim viti akademik, bazuar në Rregulloren e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore të FB, dhe në Rregulloren e Brendshme të Departamentit të Agrobiznesit, përcaktohet në planet mësimore (kurrikulat) nga përgjegjësi i departamentit. Aty pasqyrohen disiplinat mësimore, orët, kreditet si edhe mënyra e kontrollit të dijeve etj. |

| | |
|---|---|
| | Planet mësimore të hartuara çdo fillim viti akademik, miratohen nga dekani i FB dhe nga Senati Akademik i UNIKO.<br>Për çdo lëndë/modul që bën pjesë në programin e studimit, përcaktohet stafi akademik që do të përfshihet në realizimin e tij..<br>*Evidencat*<br>*Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB, Neni 46*<br>*Shtojca 2.3 Rregullore e Njësisë Bazë Departamenti i Agrobiznesit, Neni 22;*<br>*Shtojca 2.5 Rregullore e Programit të Studimit (MP) në "Drejtim Agrobiznesi" 2024-2025,*<br>*Shtojca 1.2 Rregullore e Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, Neni 100* |
| **Kriteri 7.** Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. | Praktika profesionale është pjesë e programit mësimor dhe si e tillë ajo merr vëmendjen maksimale të Departamentit. Procedura e realizimit dhe mbrojtjes së praktikës përcaktohet në aktet rregullatore si në: rregulloren e FB, në rregulloren e DA, si dhe në rregulloren e programit të studimit.<br>UNIKO dhe FB ka nënshkruar marrëveshje me bizneset në të cilat formalizohen dhe modalitett për bashkëpunim lidhur me praktikat profesionale. Në këtë mënyrë u krijoëhen mundsi studentëve dhe lehëtsi për kryerjen e praktikave pranë kompanive apo institucioneve publike..<br>UNIKO ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione qëndrore dhe vendore, kompani, OJF etj. Janë nënshkruar marrëveshje me rreth 20 kompani e shoqata biznesi.<br>Edhe studenti mund t'i propozojë departamentit vendin ku mund të kryejë praktikën profesionale. Studentët kanë detyrimin e kryerjes së plotë të praktikës profesionale<br>Mbikqyrja e praktikave nga pedagogët bëhet sipas orëve që ndahen në Departament sipas lëndëve aplikative. Programi i praktikës që përgatitet nga pedagogët u jepet studentëve të cilët në përfundim të praktikës paraqesin relacionin bazuar në të cilin do të vlerësohen nga komisioni i vlerësimit, i përbërë nga pedagogët që ndjekin praktikën profesionale. Vlerësimi i studentit për praktikën profesionale bëhet me notë.<br>Studenti mund të përmbyllë studimet me provim ose temë diplome. Departamenti, pasi shqyrton kriteret dhe kërkesat e studentëve për temë diplome, harton listën dhe udhëheqësin e studentëve që plotësojnë kriteret dhe ia paraqet për miratim drejtuesit të njësisë kryesore të FB. Nuk ka ndonjë manual që pëcakton kriteret dhe standardet për përgatitjen dhe mbrojtjen e temës së diplomës , por |

| | |
|---|---|
| | vetem nje vendim te 17.01.2022 per temat e diplomes, por ky eshte per programin e vjeter GVJ vëren se Departamenti ka staf të mjaftueshëm e të kualifikuar për mbikqyrjen dhe realizimin e praktikave profesionale si edhe të temave të diplomës<br>*Evidencat*<br>*Shtojca 2.3 Rregullore e Njësisë Bazë Departamenti i Agrobiznesit, Neni 22;*<br>*Shtojca 2.5 Rregullore e Programit të Studimit (MP) në "Drejtim Agrobiznesi" 2024-2025, S*<br>*Shtojca 2.3 Rregullore e Njësisë Bazë Departamenti i Agrobiznesit, Neni 22*<br>*3.23. Rregullore e praktikave profesionale* |
| **Kriter 8.** Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale. | Pedagogët e angazhuar si mbikqyrës të praktikave në ambjentin pritës angazhohen në realizimin e praktikave profesionale të studentëve sipas marrëveshjeve me kompanitë apo institucionet përkatëse. Në përfundim të praktikës profesionale, vleresohen mbi bazën e relacionit Pra studenti mbikqyret nga një pedagog, ai ka detyrimin të ndjekë orët e praktikës, ai vlerësohet nga një komision por edhe nga vetë institucioni /kompania ku ka realizuar praktikën<br>*Evidencat*<br>*Shtojca 2.3 Rregullore e Njësisë Bazë Departamenti i Agrobiznesit, Neni 22;*<br>*Shtojca 2.5 Rregullore e Programit të Studimit (MP) në "Drejtim Agrobiznesi" 2024-2025, Shtojca 3;*<br>*3.23. Rregullore e praktikave profesionale*<br>*Shtojca 2.3 Rregullore e Njësisë Bazë Departamenti i Agrobiznesit, Neni 22* |
| **Konkluzione** | *Institucioni përmbush kërkesat lidhur me angazhimin e stafeve në këtë program studimi, si nga pikëpamja sasiore, ashtu edhe nga pikëpamja cilësore.*<br><br>*-Për realizimin e programit të studimit MP "Drejtim agrobiznesi" UNIKO ka angazhuar 100% staf akademik efektiv, të cilët mbajnë tituj dhe gradë shkencore apo Msc, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi..*<br><br>*- Formimi akademik dhe përvoja e pedagogëve përputhet me lëndët mësimore që ata zhvillojnë në këtë program studimi, gjë që dokumentohet në Cv e stafeve dhe ngarkesën mësimore*<br><br>*-IAL, ka ndjekur të gjitha procedurat ligjore dhe parimet bashkëkohore të rekrutimit të stafeve dhe ka formalizuar marrëdhënien e punës përmes kontratave përkatëse që garantojnë qëndrueshmërinë e stafeve dhe përmbushen e detyrimeve por edhe* |

| | |
|---|---|
| | *të drejtat e tyre. Në qëndrueshmërinë e stafeve ndikon edhe mjedisi i punës dhe politikat mbështetëse që zbatohen.*<br>*-IAL disponon një bazë të dhënash për anëtarët e personelit akademik dhe ndihmës të përfshirë në programin e studimit e cila përditësohet periodikisht dhe zbaton kuadrin ligjor në fuqi që lidhet me mbrojtjen e të dhënave personale.*<br>*-Institucioni ka politika të qarta dhe procedura për ndjekjen e praktikave mësimore dhe projekteve të dipomimit, të formaliztuara në Rregulloret përkatëse.*<br>*-Zyrat mbështetëse të procesit mësimor janë në funksionim të plotë dhe mundësojnë një infrastrukturë mësimdhënieje të standardeve të larta dhe mbështetje maksimale të studentëve dhe pedagogëve.*<br>***Sugjerime** :*<br>*-Procesi i vlerësimit të standardizohet përmes një formati vlerësimi me pikë, gjë që do të rriste transparencën dhe objektivitetin në vlerësim. Në gjykimin e GVJ caktimi i vetëm 5 pikëve për intervistën me gojë , vlerësim ky mjaft i rëndësishme për të punuar në një institucion të arsimit të lartë, duket të jetë jo i mjaftueshëm. Prandaj sugjerojmë të rishikohet* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit:** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. | Nga vizita ne mjediset e Fakultetit të Bujqësisë rezulton se godina përmbush kushtet teknike dhe standardet e ndërtimeve civile. Gjithashtu ajo mundëson plotësimin e kushteve optimale higjieno-sanitare për studentët dhe stafet .Kushtet e mësimit janë optimale, nisur nga fakti që auditorët kanë akustikë të mirë dhe të gjitha mjediset e universitetit janë pajisur me sistem ngrohjeje qëndrore. Fakulteti në të cilin do të zhvillohet ky program studimi ka siguruar të gjithë inftastrukturën e nevojshme si auditorë , laboratore, zyra , salla mbledhjesh , laboratorë kompjuterash, bibliotekë etj., |

| | |
|---|---|
| | Fakulteti plotëson normativën mesatare të sipërfaqes së shfrytëzueshme, U është kushtuar vëmendje investimeve për të përmirësuar normativat teknike të ndriçimit natyral, dhe aktualisht koefiçienti i ndriçimit vlerësohet rreth 23% të sipërfaqes së dyshemesë. FB dispnon edhe tabelat përkatëse treguese për mjediset dhe daljet për raste emergjence. Të gjitha mjediset (korridoret) janë të pajisura me sensorë termikë dhe me pajisje të sistemit të mbrojtjes nga zjarri.. Programi i ciklit të dytë të studimit (MP) në "Drejtim Agrobiznesi" zhvillohet kryesisht në godinën e FB, i cili është organizuar dhe funksionon në brendësi të kampusit të UNIKO.<br>Gjatë vizitës në terren verifikuam se FB ka një sipërfaqe të mjaftueshme (3006 m2), si dhe një infrastrukturë adekuate për mësim dhe veprimtari shkencore: 4 auditore, 12 klasa per seminare, 9 laboratore, 1(një) bibliotekë etj.<br>Vëerejmë se FB disponon salla gtë mëdha për leksione si edhe të vogla për semiaret me një numër më të ulët studentësh. Klasat, zyrat, laboratoret dhe auditoret janë të pajisura me mjete audiovizuale dhe të teknologjisë së informacionit. FB disponon salla konferencash (sisteme video konferencash dhe klasa hibride) të cilat janë të pajisura me pajisje bashkëkohore të IT si videoprojektorë, smartborde, ëhiteboards etj. Gjithashtu, për realizimin e veprimtarive praktike nga studentët dhe veprimtarive kerkimore shkencore pranë FB funksionon Ekonomia Didaktike Eksperimentale (EDE), si një qendër e formimit profesional. EDE ka një sipërfaqe 16.5 ha dhe ofron infrastrukturën për aktivitetin studentor në terren. Fakulteti është angazhuar për shndërrimin e kësaj njësie në qendër të kërkimit të zbatuar, një pikë mbështetëse për problemet bujqësore të fermerëve dhe zhvillimet e ardhshme bujqësore në rajon. Qendra do të mbështesë projektet shkencore të cikleve të dyta dhe të treta të programeve të studimit, të cilat do të mundësojnë gjenerimin e të ardhurave për të ardhmen<br>UNIKO ka bibliotekat të pasura me literaturë të gjerë nga autorë të huaj dhe vendas; me sallë bashkëkohore studimi me kompjutera, internet , ku studentët dhe pedagogët punojnë për të realizuar kërkime të ndryshme apo projekte. Kësaj i shtohet edhe libraria online "U-LIBRARY", e cila mundëson akses në materiale studimore dhe kërkimore të përditësuara.<br>*Evidencat*<br>***http://unkorce.edu.al/ede/*** |

| | |
|---|---|
| | *Shtojca 4 Tabelë përmbledhëse e Kapaciteteve Infrastrukturore dhe Laboratorike të FB, (Tabela 16)*<br>*Shtojca 4 Tabelë përmbledhëse e Laboratorëve dhe përdorimi i tyre në mësimdhënie (Tabela 16);*<br>*Shtojca 3.20.1 Infrastruktura e Përfituar nga Projektet;*<br>*Vizita në institucion* |
| **Kriteri 2.** Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. | Mjediset (auditoret e leksioneve, klasat e seminareve, laboratoret) janë të pajisura me video projektorë dhe disa prej tyre dhe me pc-kompjuter. Gjithashtu është siguruar linja e dedikuar e internetit tek Godina e FB si edhe dhe intraneti (kabëll interneti optik) në të gjitha zyrat e personelit, klasat, laboratorët dhe auditorët. Gjithashtu, funksionon edhe sistemi ëireless i internetit, duke u mundësuar studentëve akses interneti edhe në ambjentet e jashtme. Edhe sallat e aktiviteteve e mbledhjeve janë të pajisura me pajisje kompjuterike, monitorë, videoprojektorë, smartborde, ëhiteboards etj. Për investimet në pajisje kompjuterike dhe të TIK vec fondeve të UNIKO (të ardhurat e veta), janë shfrytëzur edhe financimet e ndryshme në kuadër të pjesëmarrjes së FB dhe DA në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare. Pedagogët krahas pajisjeve kompjuterike (pc-kompjuter desktop), posedon edhe laptop, apo edhe videoprojektor portativ, të cilat garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, duke përdorur metoda bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies<br>*Evidencat*<br>*http://unkorce.edu.al/ede/*<br>*Shtojca 4 Tabelë përmbledhëse e Kapaciteteve Infrastrukturore dhe Laboratorike të FB, (Tabela 16)*<br>*Shtojca 4 Tabelë përmbledhëse e Laboratorëve dhe përdorimi i tyre në mësimdhënie (Tabela 16);*<br>*Shtojca 3.20.1 Infrastruktura e Përfituar nga Projektet;*<br>*Vizita në institucion* |
| **Kriteri 3.** Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi. | Në FB funksionojnë 10 (dhjetë) laboratore didaktike/mësimorë të pajisur me pajisje bashkëkohore dhe një "laborator fushor" siç është EDE.. Përvec tyre studentët brenda kampusit universitar shfrytëzojnë edhe laboratorë të fakulteteve të tjerë si ai i informatikës. Mjediset (auditoret e leksioneve, klasat e seminareve, laboratoret) janë të pajisura me video projektorë dhe disa prej tyre dhe me pc-kompjuter. Gjithashtu është siguruar linja e dedikuar e internetit tek Godina e FB si edhe dhe intraneti (kabëll interneti optik) në të gjitha zyrat e personelit, klasat, laboratorët dhe auditorët. Gjithashtu, funksionon edhe sistemi ëireless i internetit, duke u mundësuar studentëve akses interneti edhe në |

| | |
|---|---|
| | ambjentet e jashtme. Edhe sallat e aktiviteteve e mbledhjeve janë të pajisura me pajisje kompjuterike, monitorë, videoprojektorë, smartborde, ëhiteboards etj. Për investimet në pajisje kompjuterike dhe të TIK vec fondeve të UNIKO (të ardhurat e veta), janë shfrytëzur edhe financimet e ndryshme në kuadër të pjesëmarrjes së FB dhe DA në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare. Pedagogët krahas pajisjeve kompjuterike (pc-kompjuter desktop), posedon edhe laptop, apo edhe videoprojektor portativ, të cilat garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, duke përdorur metoda bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies<br>*Evidencat*<br>*http://unkorce.edu.al/ede/*<br>*Shtojca 4 Tabelë përmbledhëse e Kapaciteteve Infrastrukturore dhe Laboratorike të FB, (Tabela 16)*<br>*Shtojca 4 Tabelë përmbledhëse e Laboratorëve dhe përdorimi i tyre në mësimdhënie (Tabela 16);*<br>*Shtojca 3.20.1 Infrastruktura e Përfituar nga Projektet;*<br>*Vizita në institucion* |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron. | Për realizimin e programit të ciklit të dytë të studimit (MP) në "Drejtim Agrobiznesi" përdoren: laboratori i transferimit të teknologjive, laboratori i informatikës, laboratori fushor (EDE), laboratori (klasa) hibride etj, ku studentët kryesisht realizojnë orët e seminareve për këtë program studimi. |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe | Praktikat nuk zhvillohen ne institucion |

| | |
|---|---|
| ambulatore me kapacitetet e nevojshme. | |
| **Konkluzione** | *Infrastruktura, mjediset mësimore, teknologjia e informacionit, shërbimet për studentët janë të përshtatshme për zhvillimin e një procesi cilësor mësimor, sipas standardeve bashkëkohore të mësimdhënies dhe të sigurisë.*<br><br>*-UNIKO ka laboratorë e salla te pajisura me pajisje bashkkohore të zhvillimit të procesit mësimr dhe të aktiviteteve të ndryshme , ka edhe laborator të IT në funksion të programit të studimit, të cilët përdoren për një qasje më praktike të procesit të mësimdhënies dhe për ta bërë atë sa më tërheqës .*<br><br>*–Në funksion të programit të studimit MP në "Drejtim agrobiznesi ", janë vënë bibilioteka dhe laboratorët e Informatikës, të pajisur me kompjutera dhe programe specifike që përdoren nga studentët pa pagesë, për qëllim mësimi apo përgatitje të projekteve në kuadër të programit mësimor.*<br>*-Studentët dhe pedagogët kanë akses në Wifi free* |

| Shkalla e përmbushjes së standardit: | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi IV.3**<br>**Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit. | Studentët pajisen me literaturën bazë për cdo lëndë mësimore, por në mbështetje të programit mësimor,atyre u vihet në dispozicion edhe literaturë shtesë nga autorë vendas dhe të huaj, e cila mund te aksesohet në bibliotekën e UNIKO, si dhe në bibliotekën e FB. Biblioteka ofron edhe informacione on-line dhe aksesi burimeve elektronike EIFL (Electronic Information for Library). Literatura bazë ofrohet në formën e teksteve mësimore, leksioneve të shkruara por edhe në formën e dokumentacionit elektronik, si edhe projekteve e punimeve të realizuara më herët nga studentë të tjerë, etj.<br>Literatura bazë shoqërohet edhe me materiale mbështetëse , të cilat lektorët i ofrojnë përmes mterialeve të printuara ose në formë elektronike në Platformën Microsoft Teams Tekstet janë shkruar si |

| | |
|---|---|
| | nga autorë apo bashkautorë të UNIKO ose autorë të tjerë të njohur brenda ose jashtë vendit. Secili Fakultet i UNIKO ka bibliotekën e tij, pra edhe FB .Gjatë vizitës në institucion pamë se në fondin e bibliotekës së FB disponohen libra, revista, enciklopedi, por edhe fjalorë terminologjikë, të fushave specifike. Ka një numër të konsiderueshëm titujsh ku fondi i përgjithshëm arrin 17205 tituj (dhe 44042 kopje) në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaja, kryesisht në anglisht dhe frëngjisht. Bibliotekat ofrojnë një hapësirë studimi të madhe me një sipërfaqe prej 562 m2 si dhe disponojnë pajisje kompjuterike. Orari i shpallur gjatë ditëve të javës është 8:00- 16:00. Niveli i frekueetimit është i kënaqshëm, ku 1444 studentë dhe 270 pedagogë (me kohë të plotë dhe të pjesshme) kanë kartelat e tyre personale në këto biblioteka.<br>Pasurimi i bibiotekes është në vëmendjje të strukturave dhe për të institucioni parashikon fonde vjetore bazuar në kërkesat e personelit akademik të çdo njësie. Bazuar në rëndësinë që i jep, , UNIKO ka fituar një fond prej 14.000.000 ALL, përmes AKKSHI-t për Infrastrukturë të Kërkimit Shkencor për Dixhitalizimi e Fondit të Bibliotekës Shkencore (përfshi edhe Fondin Nolian.)<br>Gjithashtu, në sajë të investimit AADF (Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim), në kuadër të projektit "CleanScore", Biblioteka Shkencore ka qasje në JSTOR: https://ëëë.jstor.org[1]<br>*Evidencat*<br>*Vizita ne Institucion*<br>*Shtojca 2.17 Listë e Botimeve të Stafit Akademik;*<br>*Shtojca 3.28 Tabelë Përmbledhëse e Fondit të Bibliotekave* |
| **Kriteri 2.** Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit. | Përmes emaileve zyrtare punonjësit e bibliotekës Shkencore të UNIKO dhe bibliotekës së FB, informojnë stafet akademike mbi përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit. Raportimet bëhen për autorë vendas dhe të huaj. Ndërsa studentët infirmohen mbi literaturën e përditësuar gjatë frekuentimit të mjedisve të bibliotekës ose nga përdorimi i bibliotekës virtuale që është vënë në dispozicion të tyre.<br>*Evidencat*<br>*Shtojca 2.17 Listë e Botimeve të Stafit Akademik;*<br>*Shtojca 3.28 Tabelë Përmbledhëse e Fondit të Bibliotekave* |
| **Kriteri 3.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të | Biblioteka është në dispozicion të studentëve më mjediset e saj me një orar të përditshëm. Ajo ofron edhe informacione on-line nga burime të ndryshme elektronike si EIFL (Electronic Information for Library). Biblioteka Shkencore. . Fondi i përgjithshëm arrin 17205 tituj (dhe 44042 kopje) në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaja, kryesisht në anglisht dhe frëngjisht. Bibliotekat ofrojnë një |

| | |
|---|---|
| barabartë nga studentët e programit të studimit. | hapësirë studimi prej 562 m2 si dhe pajisje kompjuterike në dispozicion të studentëve. Orari i shpallur gjatë ditëve të javës është 8:00-16:00. 1444 studentë dhe 270 pedagogë (me kohë të plotë dhe të pjesshme) kanë kartelat e tyre personale në këto biblioteka<br>*Evidencat*<br>*Shtojca 2.17 Listë e Botimeve të Stafit Akademik;*<br>*Shtojca 3.28 Tabelë Përmbledhëse e Fondit të Bibliotekave*<br>*Vizita ne institucion* |
| **Kriteri 4.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. | Studentët pajisen me literaturën bazë për cdo lëndë mësimore, por në mbështetje të programit mësimor,atyre u vihet në dispozicion edhe literaturë shtesë nga autorë vendas dhe të huaj, e cila mund te aksesohet në bibliotekën e UNIKO, si dhe në bibliotekën e FB. Biblioteka ofron edhe informacione on-line dhe aksesi burimeve elektronike EIFL (Electronic Information for Library). Litertura bazë ofrohet në formën e teksteve mësimore, leskioneve të shkruara por edhe në formën e dokumentacionit elektronik, si edhe projkete e punime të realizuara më herët nga studentë të tjerë, etj. Literatura bazë shoqërohet edhe me materiale mbështetëse , të cilat lektorët i ofrojnë përmes mterialeve të printuara ose në formë elektronike në Platformën Microsoft Teams Tekstet janë në autorësi nga autorë apo bashkëautorë të UNIKO ose autorë të tjerë të njohur brenda ose jashtë vendi. Secili Fakultet i UNOKO ka bibliotekën e tij, pra edhe FB .Gjatë vizitës në institucion pamë se në fondin e bibliotekës së FB disponohen libra, revista, enciklopedi, por edhe fjalorë terminologjikë, të fushave specifike. Fondi i përgjithshëm arrin 17205 tituj (dhe 44042 kopje) në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaja, kryesisht në anglisht dhe frëngjisht.. Në këtë mënyrë thuajse përçdo lëndë/modul studentët gjejnë literaturën bazë të rekomanduar pranë bibliotekës së FB.<br>*Evidencat*<br>*Shtojca 2.17 Listë e Botimeve të Stafit Akademik;*<br>*Shtojca 3.28 Tabelë Përmbledhëse e Fondit të Bibliotekave;* |
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit. | Biblioteka e FB ofron informacione online nga burime të ndryshme elektronike si EIFL (Electronic Information for Library). Biblioteka Shkencore e UNIKO, duke qënë anëtare e Konsorciumit të Bibliotekave Shqiptare, ka siguruar akses në burime te ndryshme elektronike, informacione të cilat mund të shfrytëzohen nga çdo student dhe pa pagesë..<br>*Evidencat*<br>*Takimi me punonjës të Bibliotekës* |

| | |
|---|---|
| | *Takimi me studentët* |
| **Kriteri 6.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët. | Salla e studimit të bibliotekës së FB është e pajisur me kompjutera (internet), fotokopje dhe video-projektorë duke krijuar mundësi që studentët të punojnë edhe në grup për përgatitjen e detyrave e projekteve . Në kompjutera janë të instaluar programe bazë kompjuterike, të cilat përdoren nga studentët për realizimin e detyrave sipas specifikave të lëndëve/moduleve. Duke qënë se numri i posteve të punës në ambjentet e bibliotekës është i mjaftueshëm , si edhe i, kompjuterave , bëhet i mundur përdorimi pë kufizim për cdo student<br>*Evidenca*<br>*Vizita në institucion .* |
| **Kriteri 7.** Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. | Biblioteka funskionon me një orar të përshtathsëm për akomodimin e studentëve në cdo ditë të javës nga 8:00- 16:00. Kapaciteti i studentëve përdorues është: 1444 studentë. Stafi i bibliotekës është i specializuar dhe i trajnuar. Oraret dhe kapacitete e bibliotekës I përgjigjen nevojave të studentëve dhe programit mësimor<br>*Evidenca*<br>*Vizita në institucion* |
| **Kriteri 8.** Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik. | Stafi i punonjësve të bibliotekës realizon raportimin e informacionit që ka të bëjë me përditësimin e fondit fizik dhe fondit on-line të bibliotekës dhe shkallën e shfrytëzimit të fondit të titujve nga personeli akademik dhe studentët. Ato mbajnë evidencë mbi kartelat e të abonuarvefg frekuentimin e sallave Buxheti institucional parashikon fonde vjetore për pasurimin e bibliotekave të fakulteteve me botime të kërkuara nga personeli akademik i çdo njësie, të cilat vihen në dispozicion të studentëve në veprimtaritë e tyre hulumtuese për realizimin e detyrave të kursit, projektet lëndore apo punimet e diplomës. Aktualisht, UNIKO ka fituar një fond prej 14.000.000 ALL, thirrja e AKKSHI-t për Infrastrukturë të Kërkimit Shkencor për Dixhitalizimin e Fondit të Bibliotekës Shkencore (përfshi edhe Fondin Nolian).<br><br>Evidenca<br>Vizita në institucion<br>Shtojca 3.14.1Info Bibliotekes shkencore |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Konkluzione** | *UNIKO ofron një bibliotekë me hapësira të dedikuara për studentët dhe me orare të përshtatshme sipas hapësirave që u lejon programi mësimor. Orari eshtë i afishuar në hyrje të bibliotekës dhe në ëebsite të UNIKO.*<br><br>*-Institucioni angazhohet maksimalisht në ofrimin e teksteve bazë dhe ndihmëse të përditësuara dhe dedikon një fond vjetor për këtë qëllim.Madje aplikon edhe per projekte .*<br><br>*-Biblioteka siguron literaturë fizike dhe digjitale/ on line me një fond të larmishëm dhe me platforma bashkëkohore.*<br><br>*-Biblioteka ështe e pajisur me kompjutera, që kanë të instaluara programet përkatëse për aksesin në literaturë .*<br><br>*-Aksesi i literaturës online lehtësohet përmes aksesit free në ëifi*<br><br>***Sugjerim : GVJ rekomandon***<br>• *Biblioteka të qëndrojë e hapur edhe gjatë fundjavës*<br>• *.Të ketë një monitorim më të mirë të përditësimit të literaturës nëpëmjet kontrollit më të saktë të syllabuseve.*<br>• *Duhet të bëhet analizë e efektivitetit të përpjekjeve për pasurimin e fondit fizik dh atij online , të kërkesave për tituj, etj* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit:** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | **X** | |

| **Standardi IV.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. | UNIKO është pjesë e sistemit të Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH) që shërben si një sistem dixhital të integruar informacioni në administrimin e bazës së të dhënave. Sistemi mundëson administrimin e të dhënave nga ana e stafit akademik, marrje të informacionit në kohë reale nga ana e studentëve, shërbime më të mira sekretarie që lehtësojnë proceset e hedhjes dhe ruajtjes së të dhënave, Përmes tij bëhet edhe , paraqitja e grafikut të provimeve, rezultatet, kreditetet. Mënyra e funksionimit të sistemi është formalizuar në Rregulloren e këtij programi . Aktualisht UNIKO ka |

| | |
|---|---|
| | nënshkruar marrëveshjen e re me RASH[2] për përdorimin e sistemit të ri digjital "PITAGORA". Përmes tij sigurohet gjurmimi i informacionit që në regjistrim e deri në diplomim të studentëve. UNIKO publikon në faqen zyrtare, ëëë.unkorce.edu.al, e cila përditësohet vazhdimisht me informacion në gjuhën shqipe dhe angleze.. Ekziston edhe Programi i Transparencës, i cili pasqyron një gamë të gjerë informacioni dhe kornizën ligjore të veprimtarisë së stafit akademik, administrativ dhe të studentëve, marrëdhëniet me publikun, palët e interesit, personat juridikë, etj. Nëpërmjet projektit të shërbimeve të paketës Office 365 behete komunikimi i stafit akademik dhe studentëve nëpërmjet adresave elektronike me domain @unkorce.edu.al. UNIKO menaxhon edhe forma informimi më të gjerë si Guida e Universitetit, broshura promocionale për programet e studimit dhe kriteret e pranimit, lajmërime në media, etj. Pranë UNIKO funksionon edhe zyra e informimit të studentëve e cila është pjesë e drejtorisë së kurrikulës dhe vlerësimit institucional. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të kësaj zyre përcaktohet në rregulloren e sektorit të studimeve dhe sektorit të TIK. UNIKO disponon regjistra që përbëjnë dokumentacionin themelor për studentët i) Regjistri themeltar i studentit (vërteton regjistrimin e studentit që pajiset me numër matrikulimi deri në marrjen e diplomës ose çertifikatës) ii) Regjistri i arritjeve akademike të studentit (vërteton rezultatet e studentit gjatë aktivitetit të tij akademik.) iii) Regjistri i lëshimit të diplomave dhe çertifikatave (i cili vërteton emërtimin e çertifikatave dhe diplomave). UNIKO disponon arkivin si strukturë përgjegjëse për ruajtjen e dokumentacionit në letër. UNIKO ka struktura të veçanta për dixhitalizimin e të dhënave dhe ruajtjen e dokumentacionit në formë elektronike, për mbledhjen e të dhënave statistikore. Shtojca 1.6 Manuali i Sistemit Elektronik PITAGORA<br>*Evidenca*<br>*Shtojca 1.6.1 Marrëveshja me RASH për Sistemin PITAGORA*<br>*https://unko.pitagora.rash.al/*<br>*Shtojca 2.23 Raport Instalimi i projektit OFFICE 365;*<br>*http://unkorce.edu.al/guida-uniko/,*<br>*https://unkorce.edu.al/njoftim-per-masterin-nderkombetar-menaxhim-i-qendrueshem-ne-agroturizem/*<br>*http://unkorce.edu.al/kendi-i-maturanteve/,*<br>*https://unkorce.edu.al/njoftim-per-pjesemarrje-ne-programin-e-praktikave-nga-biznesi-gjerman-diha/* |

[2] Shtojca 1.6.1 Marrëveshja me RASH për Sistemin PITAGORA

| | *Shtojca 1.10 Rregullore e Sektorit të Studimeve dhe sektorit të TIK* |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit . | Institucioni ka një system komunikimi lidhur me administrimin e informacionit, ne varësi të llojit të tij. Strukturat të cilat janë angazhuar me administrimin e informacionit janë departamenti, Dekanati, Drejtoria Juridike dhe e Burimeve njerëzore, ajo e financës si edhe hallkat më të larta drejtuese. Kështu, dokumentacioni që arkivohet pranë departamentit përmban: planet mësimore; regulloret e programeve të studimit që ofron Departamenti; formularët e planifikimit dhe realizimit të ngarkesave mësimore vjetore; marrëveshjet e organizimit të kohës vjetore të punës, etj. Drejtoria Juridike dhe e Burimeve Njerëzore, arkivon një bazë të plotë të dhënash të proçedurave të punësimit, të kuadrit ligjor, të dokumentacionit përkatës dhe të marrëveshjeve të nënshkruara në përfundim të gjithë procesit.Drejtoria e Financës administron dokumentacionin që ka të bëjë me pagat, honoraret, kontributet dhe format e tjera të shpërblimeve. UNIKO ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike dhe private<br>*Evidencat*<br>*Shtojca 1.4 Rregullore e Drejtorisë Juridike dhe e Burimeve Njerëzore;*<br>*2.3. Rregullore e Njesisë Bazët*<br>*Vizita ne institucion*<br>*2.10.1 Marreveshjet me institucione* |
| **Kriteri 3.** Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. | UNIKO ka siguruar akses të dedikuar për stafin akademik, stafin ndihmës-akademik dhe studentët. Stafi informohet mbi mundësitë e aksesimit të informacioni përmes takimeve e trajnimeve të organizuara nga Sektori i TIK. Këto takime zhvillohen me anëtarët e stafit akademik të çdo njësie kryesore dhe të njësive bazë. Në këto takime paraqiten format e menaxhimit të informacionit për çdo kategori përdoruesish. Ndërsa dokumentat e analizave vjetore të punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, raportet mbi rezultatet e anketimeve periodike të studentëve, fushat e kërkimit dhe temat e diplomës u komunikohen të gjithë anëtarëve të stafit dhe diskutohen në takime pune me tematika specifike.Ëebsite-t personale të pedagogëve janë një burim tjetër i ndarjes së informacionit, Në mjediset e FB, janë ekspozuar nformacione të nevojshme edhe përmes stendave të dedikuara. Një burim i rëndësishëm informacioni që përdoret është edhe ëebsite i UNIKO, ku cdo Fakultet ka seksionin e tij , në të cilin jepen informacionet për programet, departamentet.<br>*Evidencat* |

| | |
|---|---|
| | *Shtojca 1.6 Manuali i Sistemit Elektronik PITAGORA*<br>*http://unkorce.edu.al/guida-uniko/,*<br>*Vizita në institucion* |
| **Kriteri 4.** Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve. | UNIKO pëdor platformën digjitale "PITAGORA", e cila mundëson aksesin në informacione të ndryshme komunikimi interaktiv. Sistemi ka rezultuar të jetë efikas për administrimin e të dhënave si nga ana e stafit akademik, ashtu edhe nga studentët. Përmes këtij sistemi arrihet informacioni në kohë reale nga ana e studentëve mbi shërbime sekretarie Gjithashtu, përmes sistemit lehtësohet komunikimin interaktiv mes strukturave Funskionet e sistemit dhe roli i aktorëve të përfshirë janë të përcaktuara në Rregulloren e tij. Në portal studenti mund të marrë informacion në sitet e pedagogeve për materiale të ndryshme në lidhje me module specifike dhe të informohet rreth elementëve të modulit, detyrimeve vjetore, etj. Një burim i rëndësisëhm informacioni është ëëë.unkorce.edu.al, e cila përditësohet vazhdimisht me informacion në gjuhën shqipe dhe angleze. UNIKO ka edhe Programin e Transparencës, të instaluar në ëeb, i cili përditësohet vazhdimisht. Gjithashtu, përmes Office 365 realizohet komunikim nëpërmjet adresave elektronike me domain @unkorce.edu.al dhe përdorimin e Microsoft Teams për mësimin në distancë apo edhe transferim materialesh mësimore tek studentët.<br>*Evidencat*<br>*https://unk.pitagora.rash.al/*<br>*Shtojca 2.23 Raport Instalimi i projektit OFFICE 365*<br>*Shtojca 1.6 Manuali i Sistemit Elektronik PITAGORA* |
| **Kriteri 5.** Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese. | Institucioni shfrytëzon sistemin digjital "PITAGORA" për evidentimin në kohë reale dhe monitorimin në se stafi akadmeik ka integruar informacionet përkatëse. Kështu, strukturat ndihmës-akademike (sekretaritë), dhe autoritetet drejtuese (zv. Rektorit për mësimin), mund të evidentojnë problematikat që lidhen më mungesë informacioesh sipas rregulloreve apo mosrespektimin e afateve nga ana e pedagogëve. Në mënyrë periodike përgjegjësi i sekretarisë së sistemit, dërgon informacion tek dekani dhe përgjegjësit e njësive bazë për të reflektuar mbi problematikat e krijuara. Funksionimi i sistemit është formalizuar përmes Manualit të sistemit elektronik PITAGORA.<br>Nuk refereohen raportime indicviduale<br>*Evidence*<br>*Shtojca 1.6 Manuali i Sistemit Elektronik PITAGORA*<br>*Vizita ne institucion* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 6.** Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe. | Cdo Fakultet ka seksionin e tij në faqen ëeb të UNIKO, ku pasqyrohet dhe përditësohet cdo informacion mbi programin e studimit, aktivitetet e ndryshme dhe personelin akademik. Në faqen ëeb të UNIKO< të cilën e vizituam rezulton që të jetë publikuar informacioni lidhur me programin e studimit MP në Drejtim Agrobiznesi, brenda seksionit të Departamentit të Agrobiznesit, në Fakultetin e Bujqësisë. Por vetëm në gjihën shqipe<br>Evidencat<br>**ëëë.unkorce.edu.al/archive/programet_studimet/FB/index.php;**<br>**https://unkorce.edu.al/fakulteti-i-bujqesise-dhe-universiteti-fan-s-noli-si-nje-qender-kerkimi-shkencor-qe-nderlidh-dijen-me-fushen-e-bujqesise-ishte-fokusi-i-takimit-qe-stafi-i-ketij-fakulteti-zhvilloi-m/;**<br>**https://unkorce.edu.al/ne-kuaderte-projektit-identifikimi-i-barrierave-qe-ndikojne-ne-implementimin-e-ekonomise-rrethore-ne-fermat-blegtorale-ne-shqiperi-paraqiten-rezultatet-e-studimit-ne-bashkite-e-dibre/** |
| **Konkluzione** | *UNIKO realizon menaxhimin e informacioneve për studentët në të gjitha fazat e studimit që nga regjistrimi e deri tek diplomimi, përmes platformës elektronike PITAGORA.*<br>*-Në sistemin PITAGORA hidhen, ruhen dhe përpunohen të dhëna në lidhje me frekuentimin, ecurinë dhe vlerësimin e studentit.*<br>*-Faqja zyrtare e UNIKO përmban informacionet kryesore në lidhje me aktivitetin si edhe misionin, drejtimin, funksionimin, organogramën si edhe mbi kurrikulën e programit të studimit MP : "Drejtim agrobiznesi".*<br>*Sugjerim : të publikohet në gjihën angleze programi i studimit*<br>- |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit:** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. | Departamenti i Agrobiznesit si njësi bazë funksionon në përbërje të Fakultetit të Bujqeësisë si njësi kryesore dhe nuk ka buxhet të vetin si njësi shpenzuese. etj.<br>Plani për mbështetjne financiare dhe mënyra e ndarjes dhe përdorimit të fondeve janë hartuar në bazë fakulteti Buxhetimi finaciar hartohet çdo vit nga Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e Financës në drejtimin e administratorit të UNIKO. Buxheti ndahet sipas përcaktimeve të rregullores financiare> Projekt-buxheti afatmesëm (PBA) hartohet dhe miratohet nga organet drejtuese të UNIKO. Për këtë qëllim departamentet paraqesin cdo vit një kërkese për financim të të gjitha aktiviteteve vjetore që kanë planifikuar.<br>Plani i financimit miratohet në nivel institutícional nga Bordi i Administrimit ku përfshihen të gjitha kostot dhe të ardhurat e parashikuara edhe për Departamnetite si njësi bazë..Gjithashtu, hartohet edhe raporti i analizës financiare, me të cilin njihet Departamenti dhe përmes diskutimit të tij ka mundësi të jetë pjesë e proçeseve vendimmarëse.<br>*Evidencat*<br>*Shtojca 1.8.1 Rregullore Financiare e Shpërndarjes së të Ardhurave e UNIKO, Neni 4;6*<br>*Shtojca 1.7 Rregullore e Drejtorisë Ekonomike;*<br>*Shtojca 1.8 Rregullore e Drejtorisë së Financës;*<br>*Shtojca 3.15 Praktika e Miratimit të Buxhetit UNIKO;*<br>*Shtojca 4 Tabela 18 - Të Ardhurat & Financimet e Ndryshme në 3 Vitet e Fundit;*<br>*Shtojca 4.1 Evideca e të Dhënave Financiare për Kostot e Programit të Studimit* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të | Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit bëhet në koherencë me procedurat e planifikimit të financimit në nivel Fakulteti. .Ai përmban të gjithë zërat buxhetorë që lidhen me financimin e burimeve njerëzore , shpenzimet për aktivitete,etj .<br>*Evidencat*<br>*Shtojca 4.2 Model Plani të Financimit të Njësisë Bazë, Përgjegjëse për Programin e Studimit* |
| **Kriteri 3.** Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar tëv tij. | Institucioni u nënshtrohet auditimeve : të brendshme nga vetë institucioni, audtitimit mga MAS si edhe nga KLSH.<br>Auditimi i brendshëm financiar kryhet nga strukturat e kontrollit të brendshëm të institucionit, të ngritura (çdo vit me urdhër të nëpunësit autorizues) në bazë të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;<br>Rezultatet e auditimit të brendshëm financiar bëhen publike dhe diskutohen në takimet e Rektoratit dhe të Bordit të Administrimit. E njëjta gjë ndodh edhe me auditimet e jashtme Nga RVB informohemi se rezultatet e auditimit diskutohen në takimet e analizave vjetore të punës,dhe publikohen nga Rektorati në Programin e Transparencës, në faqen zyrtare të internetit. Në faqen zyrtare nuk shohim të jenë publikuar raporte auditimi<br>Cdo vit përgatitet raporti financiar, I cili i dërgohen MAS..Institucioni kryen analizën e treguesve të monitorimit financiar e cila konsiston në analizimin e efektivitetit të shpenzimeve, krahasuar me periudhat e mëparshme;realizimet apo mosrealizimet dhe shkaqet për këtë<br>*Evidencat*<br>*Shtojca 2.4 Raporti i Analizës Vjetore të Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore & Financiare i UNIKO 2022-2023*<br>*Vizita ne institucion* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4.** Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës. | Cdo vit përgatitet raporti financiar. Raporti financiar i përgatitur nga administratori i universitetit i dërgohet MAS..<br>Institucioni kryen analizën e treguesve të monitorimit financiar e cila konsiston në analizimin e efektivitetit të shpenzimeve, krahasuar me periudhat e mëparshme,realizimet apo mosrealizimet dhe shkaqet për këtë , duke u fokusuar kryesisht në informacionin mbi arritjet (në terma sasiore dhe vlera të zërave buxhetorë), duke identifikuar mosarritjet, shkaqet e tyre, si dhe duke propozuar në të njëjtën kohë, masa për përmirësimin e situates. Ky raport diskutohet në takime të hapura me asamblenë akademike, ku sigurisht merr pjesë edhe stafi I DA. Kur gjykohet e arsyeshme ose me kërkesë të stafit të DA, mundësohen informacione më analitike në nivel program studimi. Proçesi i zbatimit të buxhetit monitorohet nga Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS), i kryesuar nga nëpunësi autorizues (Administratori i Universitetit) Nuk ka ndonje akt per grupin e menaxhimit strategjik GMS, as raport financiar vjetor<br>*Evidencat*<br>*Shtojca 2.4 Raporti i Analizës Vjetore të Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore & Financiare i UNIKO 2022-2023*<br>*Vizita ne institucion* |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve. | Qëndrueshmëria financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë sigurohet përmes fondeve që alokohen nga buxheti i shtetit në formën e transfertës së pakushtëzuar dhe të ardhurat e veta që krijon vetë institucioni..<br>Në rastet kur nevojitet financim shtesë,me kërkesë të njësisë bazë dhe me miratim të organeve drejtuese planifikohen ndërhyrje të posaçme në zërat e shpenzimeve<br>*Evidenca*<br>*Shtojca 1.1 Statuti i Universitetit "Fan S. Noli", Korçë* |
| **Konkluzione** | UNIKO h*arton raporte vjetore financiare të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin e buxhetit për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e tij.*<br>*-Shpërndarja e fondeve bëhet në bazë të nevojave që paraqesin* |

| | |
|---|---|
| | *njësitë kryesore dhe kërkesave të planifikuara për mësim dhe kërkim në çdo filllim viti akademik.*<br>*-Buxheti vjetor miratohet nga bordi i adminstrimit dhe GMF.*<br>*- Në përfundim të vitit, Njësia bazë dhe ajo Kryesore njihet me raportin financiar të institucionit. Ato marrin informacion mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës dhe planifikimin e buxhetit për vitin pasardhës.*<br>*-Universiteti garanton qëndrueshmërinë financiare për realizimin e objektivave dhe misionit të tij, bazuar në të ardhurat nga buxheti i shtetit dhe ato që siguron nga aktivitetii i tij*<br>*-Sugjerim*<br>*UNIKO u është nënshtruar auditimeve të jashtme , dhe atyre të brendshme, por nuk janë publikuar raportet e auditimit. Të publikohen në funksion të rritjes së transparencës* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit:** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

| **Standardi V.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në | UNIKO ka të formalizuara në rregulloret e tij, sipas shkallës hierarkike politikat dhe procedurat që lidhen me ciklin akademik të studentëve që nga regjistrimi në universitet e deri tek diplomimi i tyre . Kriteret dhe procedurat bazohen në legjislacionin në fuqi dhe reflektohen në statutin dhe rregulloret e studimeve të UNIKO si edhe të Fakultetit të Bujqësisë e për më tej në atë të DA.<br>Në ndihmë të studentëve, për të sqaruar e orioentuar lidhur me këto rregulla funksionon zyra e informimit të studentëve, e cila asiston studentët me informacione të ndryshme, që nga regjistrimi i tyre në momentin e pranimit dhe deri në diplomim. Struktura të tjera në ndihmë të studentëve janë edhe sekretaria mësimore, sekretaria e sistemit "PITAGORA", por gjithashtu edhe sekretaria e departamentit , të cilat ofrojnë shërbime informuese dhe këshillimore, duke lehtësuar procesin mesimor të studentëve . |

| | |
|---|---|
| fuqi dhe aktet e veta rregullatore. | *Evidencat .*<br>*Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB,*<br>*Shtojca 1.2 Rregullore e Universitetit "Fan S. Noli", Korçë*<br>*Shtojca 2.3 Rregullore e Njësisë Bazë Departamenti i Agrobiznesit,*<br>*Takimi me studentët* |
| **Kriteri 2.**Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. | Studimet në UNIKO mund të ndiqen nga çdo person dhe nga çdo shtetas i huaj, kundrejt respektimit të kuadrit ligjor në fuqi.[3].<br>Procedurat zbatojnë parimin e barazisë, i cili sanksionohet në statutin e UNIKO në të cilin theksohet barazia si parim bazë. Ky parim zbatohet si për regjistrimin ashtu edhe përgjatë gjithë hallkave të ciklit të studimeve, pra në lidhje me procesin e mësimdhënies, vlerësimit dhe me shërbimet mbështetëse<br><br>*Evidencat*<br>*Shtojca 1.2 Rregullore e Universitetit "Fan S. Noli", Korçë;*<br>*Shtojca 1.1 Statuti i Universitetit "Fan S. Noli", Korçë* |
| **Kriteri 3.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të | Procesi i pranimit në programet e ciklit të dytë të studimit (MP) të FB, bëhet në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë, Statutin e UNIKO, si dhe rregulloret e njësive bazë[4].Kuotat e pranimit dhe kriteret e pranimit të aplikantëve për çdo vit akademik përcaktohen nga DA, miratohen nga FB e me tej nga Senati [5].<br><br>*Evidencat*<br>*Shtojca 1.1 Statuti i Universitetit "Fan S. Noli", Korçë*<br>*Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB, ;*<br>*Shtojca 2.3 Rregullore e Njësisë Bazë Departamenti i Agrobiznesit, Neni 9;*<br>*Shtojca 1.2 Rregullore e Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, neni 47;* |

| | |
|---|---|
| maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. | |
| **Kriteri 4.** Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. | Kriteret dhe proçedura e pranimit, kuotat apo programet e studimit e cdo informacion tjetër në shërbim të studentëve është i përcaktuar në Rregulloren e Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, Rregulloren e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore Shkencore e FB, si edhe Rregulloren e programit të ciklit të dytë të studimit (MP) në "Drejtim Agrobiznesi", Pra këto rregullore specifikojnë kriteret, proçedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimin përgjatë kursit të studimit, transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit. Informacioni është i aksesueshmë edhe në ëebsite të UNIKO.<br><br>*Evidencat*<br>*Shtojca 1.2 Rregullore e Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, neni 47;*<br>*Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB, Neni 36;*<br>*Shtojca 2.5 Rregullore e Programit të Studimit (MP) në "Drejtim Agrobiznesi" 2024-2025;*<br>*ëëë.unkorce.edu.al*<br>*Takimi me studentët* |
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të | Kriteret dhe proçedura e pranimit, kuotat apo programet e studimit e cdo informacion tjetër në shërbim të studentëve është i përcaktuar në Rregulloren e Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, Rregulloren e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore Shkencore e FB[6], si edhe Rregulloren e programit të ciklit të dytë të studimit (MP) në "Drejtim Agrobiznesi", Pra këto rregullore specifikojnë kriteret, proçedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit. Informacioni është i aksesueshmë edhe në ëebsite të UNIKO. UNIKO publikon informacione të përditësuara në faqen e vet zyrtare, , në gjuhën shqipe dhe angleze mbi programet e studimit.<br>Gjithashtu, informacioni ofrrohet edhe përmes monitorëve dhe stendave informuese si edhe instrumentë informues si Guida e Universitetit· broshura promocionale për programet e studimit dhe kriteret e pranimit· lajmërime në media, etj. Studentët informohen vazhdimisht edhe përmes rrjeteve sociale |

| | |
|---|---|
| programit të studimit. | (FB dhe Instagram), mbi çështje të rëndësishme që lidhen me veprimtarinë e tyre të përditshme akademike..<br><br>*Evidenca*<br>**ëëë.unkorce.edu.al/archive/programi_transparences/programi_i_transparences.php**<br>**http://unkorce.edu.al/guida-uniko/**<br>[1]**http://ëëë.unkorce.edu.al/sq/kriteret-e-pranimit,**<br>**http://ëëë.unkorce.edu.al/sites/default/files/regjistrimi2020.pdf,**<br>**http://ëëë.unkorce.edu.al/sq/kriteret-e-pranimit,**<br>**https://ëëë.facebook.com/unkorce/posts/4017993801558643,**<br>**https://ëëë.facebook.com/unkorce/posts/4025316040826419,** |
| **Kriteri 6.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të margjinalizuara. | Në UNIKO në mbështetje të integrimit të shtresave sociale vulnerabël , të gjitha programet e studimit parashikojnë kuota për kandidatët nga shtresat sociale në nevojë, komuniteti i egjiptianëve dhe romëve. Këta studentë, si dhe ata që janë jetimë (nga të paktën një prej prindërve) përjashtohen nga pagesat e tarifave të shkollimit. Edhe në programin e ciklit të dytë të studimit (MP) në "Drejtim Agrobiznesi", parashikohen kuota të dedikuara për kandidatë me aftësi të veçanta, nga pakica dhe shtresa të marxhinalizuara.<br><br>*Evidencat*<br>*Shtojca 3.21.1 Shkresë nr. 71, 72 prot, datë 12.01.2024 "Propozim për Kuotat & Kriteret e Pranimit të Studentëve"* |
| **Kriteri 7.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera. | UNIKO në rregulloren e tij përcakton se studimet në ciklin e dytë të studimeve mund të ndiqen nga çdo person që ka përfunduar me sukses ciklin e parë të studimeve, si dhe nga çdo shtetas i huaj, kundrejt pagimit të tarifës së caktuar me vendim të Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit[7].<br>*Thuhet qe Departamenti i Agrobiznesit çdo vit akademik propozon kritere të pranimit të studentëve për shtetas të huaj, por nuk ka evidence .*<br>*Evidenca*<br>*Shtojca 3.21.1 Shkresë nr. 71, 72 prot, datë 12.01.2024 "Propozim për Kuotat & Kriteret e Pranimit të Studentëve";*<br>*Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB, Neni 38* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 8.** Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit. | Në UNIKO në mbështetje të integrimit të shtresave sociale vulnerabël , të gjitha programet e studimit parashikojnë kuota për kandidatët nga shtresat sociale në nevojë, komuniteti i egjiptianëve dhe romëve. Këta studentë, si dhe ata që janë jetimë (nga të paktën një prej prindërve) përjashtohen nga pagesat e tarifave të shkollimit<br>Për çdo program studimi që ofrohen nga FB, përfshi edhe programin e ciklit të dytë të studimit (MP) në "Drejtim Agrobiznesi", parashikohen kuota të dedikuara për kandidatë me aftësi të veçanta, nga pakica dhe shtresa të marxhinalizuara.*Nuk ka ndonjëe informacion për programe prioritare*<br>*Evidencat*<br>• *Shtojca 3.21.1 Shkresë nr. 71, 72 prot, datë 12.01.2024 "Propozim për Kuotat & Kriteret e Pranimit të Studentëve"*<br>. |
| **Konkluzione** | *UNIKO ka hartuar procedura dhe politika të plota dhe të kuptueshme të cilat mbulojnë çdo aspekt të rrugëtimit të studentëve në ciklin e plotë të studimit nga regjistrimi deri në diplomim në programin MP " Drejtim agrobiznesi". Këto formalizohen në Statutin e UIKO si edhe në Rregulloret e njësive , të cilat janë hartuar duke respektuar legjislacionin në fuqi që ka të bëjë me studimet dhe studentët.*<br><br>*-Proçedura e pranimit të studentëve bazohet në kriteret e miratuara nga Senati sipas Udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve.*<br><br>*- -Studentëve u mundesohet studimi në UNIKO bazuar në parimet e trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit, gjë që sanksionohet në rregulloret e studimit.*<br><br>*- Kuotat e pranimit bëhen publike nga UNIKO dhe i përcillen Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe MAS.*<br><br>*-UNIKO zbaton kriteret e regjistrimit të studentëve të huaj* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Shkalla e përmbushjes së standardit:** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| |
|---|
| **Standardi V.2** |

| **Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. | Për këtë program studimi MP kohëzgjatja e studimeve është 1 (një) vit akademik, gjë që është specifikuar në kuadrin ligjor të UNIKO Këto rregullore specifikojnë në mënyrë të detajuar kohëzgjatjen e studimeve dhe kriteret e procedurat për kalimin në vitin pasardhës. . Studentët dhe gjithë të intersuarit gjejnë këto akte të publikuara në faqen ëeb të UNIKO, ku kanë lehtësisht akses . Gjithashtu, në çdo fillim viti akademik, organizohen takime me studentët ku ata informohen në detaje rreth kritereve dhe proçedurave të ecurisë së procesit mësimor dhe rregullat e frekuentimit, etj . Një mundsi tjetër informimi është edhe përmes "Zyrës së informimit të studentëve", sekretarisë mësimore të departamentit apo sekretarisë së sistemit. Studentët informohen edhe për kriteret apo kërkesat në nivel lënde/moduli, pëmes faqes ëeb , informcioneve të pedagogëve , mbi programin/syllabusin e lëndës/modulit që mbulon, kreditet, modalitete e vlerësimit, literaturën etj. Nga takimi me studentët rezulton se ata kanë informacion të plotë dhe strukturat përmbushin detyrimet sipas rregulloreve<br>Numri i studenteve te regjistrat ne kete program studimi per vitin akademik 2024-2025 eshte 12. Nderkohe qe ne vitin akademik 2023-2024 ka qene 11, ndersa ne vitin 2022-2023 ka qene 12. Pra ka nje numer te qendrueshem studentesh te regjistruar<br><br>*Evidencat*<br>*Shtojca 1.2 Rregullore e Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, neni 47;*<br>*Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB, Neni 36;*<br>*Shtojca 2.5 Rregullore e Programit të Studimit (MP) në "Drejtim Agrobiznesi" 2024-2025;*<br>*Tabela 21*<br>*ëëë.unkorce.edu.al*<br>*Takimi me studentët* |
| **Kriteri 2.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e | UNIKOInformon studnett për procedurat e njohje së kualifikimeve të mëparshme. Si procedurë është përgjegjësi i njësisë bazë që krijon komisionin i cili konsideron kërkesën. Sipas akteve në fuqi[8] |

| | |
|---|---|
| njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. | Departamentet dhe fakultetet përcaktojnë fushat e përafërta të studimit që lejohen për transferimin e studimeve për programet e studimit që kanë nën përgjegjësi. Bazuar në kuotat në dispozicion transferimet bëhen në vite të ndërmjetme dhe pranohen kandidatët me rezultate më të larta . Pranohen në rastet kur kreditet janë më të mëdha se 30. Mund të njohen plotësisht ose pjesërisht kreditet e fituara, në përputhje me procedurën e njohjes dhe ekuivalentimit të moduleve. Vendimi merret nga Komisioni i Ekuivalentimit të Njësisë bazë bazuar në rregulloren e njësisë kryesore.<br>Sistemi i iformimit të studentëve është i njëjtë si më lart Nga takimi me studnettë rezulton se ata kanë informacion të plotë dhe strukturat përmbushin detyrimet sipas rregulloreve<br>*Evidencat*<br>*Shtojca 1.2 Rregullore e Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, neni 47;*<br>*Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB, Neni 36;*<br>*Shtojca 2.5 Rregullore e Programit të Studimit (MP) në "Drejtim Agrobiznesi" 2024-2025;*<br>*ëëë.unkorce.edu.al*<br>*Takimi me studentët.* |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. | Kriteret dhe procedurat për vlerësim janë specifikuar në kuadrin ligjor të UNIKO dhe në rregulloren e programit të ciklit të dytë të studimit (MP) në "Drejtim Agrobiznesi" Në këto rregullore specifikohet në mënyrë të detajuar kohëzgjatja e studimeve dhe kriteret e procedurat për kalimin në vitin pasardhës. . Studentët dhe gjithë të intersuarit gjejnë këto akte rregullative të publikuara në faqen ëeb të UNIKO, ku kanë lëjtësisht akses . Gjithashtu, në çdo fillim viti akademik, organizohen takime informuese me studenttë ku ata informohen në detaje rreth kritereve dhe proçedurave të ecurisë së procesit mësimor dhe rregullat e frekuentimit, etj . Një mundsi tjetër informimi është edhe përmes "Zyrës së informimit të studentëve", sekretarisë mësimore të departamentit apo sekretarisë së sistemit. Studentët informohen edhe për kriteret apo kërkesat në nivel lënde/moduli, pëmes faqes së pedagogëve , mbi programin/syllabusin e lëndës/modulit që mbulon, kreditet, modalitete e vlerësimit, literaturën etj.<br>Nga takimi me studnettë rezulton se ata kanë informacion të plotë dhe strukturat përmbushin detyrimet sipas rregulloreve<br>*Evidenca*<br>*Shtojca 1.2 Rregullore e Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, neni 47;* |

| | |
|---|---|
| | *Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB, Neni 36;*<br>*Shtojca 2.5 Rregullore e Programit të Studimit (MP) në "Drejtim Agrobiznesi" 2024-2025;*<br>**ëëë.unkorce.edu.al**<br>*Takimi me studentëtEvidencat* |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. | Procedurat lidhur me procesin e diplomimit specifikohen në kuadrin rregullator që nga rregullorja e njësisë bazë, si edhe në Rregulloren e Programit të ciklit të dytë të studimit (MP) në "Drejtim Agrobiznesi" . Në përfundim të kursit të plotë të studimeve (MP), studenti ka të drejtë të diplomohet duke përfituar "DIPLOMË UNIVERSITARE" (MP) në "DREJTIM AGROBIZNESI". Diplomimi bëhet me mbrojtje e tezës së diplomës ose me provim formimi.<br>Lidhur me temat e dipomave : duke respektuar rregulloren e njësisë bazë, në fillim të semestrit të dytë, departamenti përcakton fushat e studimit, listën e temave të diplomës si dhe pedagogun udhëheqës, duke u mbështetur në fushat e studimit që mbulon departamenti.<br>Lidhur me tezat : tezat e provimit të formimit synojnë të vlerësojnë mendimin logjik të studentit.<br>Gjithashtu, studentët informohen edhe për kriteret apo proçedurat e punimit të diplomës dhe provimit të formimit nga koordinatori i Programit të studimit dhe personeli akademik që asistojnë studentët, duke u vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës[9], [10]<br>*Evidencat*<br>*Shtojca 1.2 Rregullore e Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, neni 47;*<br>*Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB, Neni 36;*<br>*Shtojca 2.5 Rregullore e Programit të Studimit (MP) në "Drejtim Agrobiznesi" 2024-2025;*<br>*ëëë.unkorce.edu.al*<br>*Takimi me antaret e Departamentit*<br>. |
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, | Departamenti i Agrobiznesit, në koordinim me strukturat e FB dhe UNIKO, përfshirë edhe QKA, organizon takime informuese në lidhje me elementët e përmbajtjes së programeve të studimit dhe |

| | |
|---|---|
| institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit. | nevojat e tyre të të nxënit. Është dhënë një informacion mbi organizimin e fushatave promovuese , dhe një shkresë mbi praktikën e saj, e cila është e një përiudhe të tejkaluar. Nuk jepet informacion se si zhvillohen fushatat promovuese per ciklin e dytë të studimeve .<br>Fletëpalosje dhe broshura për programet e studimeve që ofrohen janë vënë në dispozicion të studentëve.<br>*Evidencat* [1]<br>*(https://ëëë.unikorce.edu.al/sites/default/files/udherefyesi2020.pdf)*<br>*(Prezantimi Vitet e I);*<br>*http://unkorce.edu.al/programet-e-studimit-2/;*<br>*Shtojca 4.3 Materiale Promovuese;*<br>*https://ëëë.facebook.com/share/v/1YaËMFN6AU/;*<br>*Shtojca 3.27 Fushat promovuese* |
| **Konkluzione** | *UNIKO ka formalizuar procedurat dhe kriteret e përparimit akademik dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin, si dhe shkallën e frekuentimit të detyruar për programin e studimit në rregulloren e departamentit dhe rregulloren e programit të studimit, ku cdo student gjen informacion të plotë edhe mbi kriteret e njohjes së kualifikimeve të mëparshme apo studimeve të pjesshme.*<br>*-Proçedurat e vlerësimit të përparimit akademik janë të detajuara në rregulloren e programit të studimit dhe ne syllabuset e lëndëve përkatëse.*<br>*-Institucioni nuk ka përgatitur një rregullore dhe një manual udhëzues për përgatitjen e projektit të diplomës.*<br>*Studentët asistohen gjatë përgatitjes së projektit të diplomës nga udhëheqësi.*<br>*-Informimi i publikut kryhet në mënyrë të strukturuar përmes planeve dhe strukturave të dedikuara të cilat përdorin instrumenta të ndryshëm të promovimit si mediat, fletëpalosjet, por edhe panairet, vizita nga dhe tek gjimnazet, etj*<br>*Sugjerim : Të përgatitet një document i përditësuar për praktikën e promovimit të programeve të ciklit të dytë* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit:** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

**Standardi V.3**

| **Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. | Informacion i hollësishëm mbi programin gjendet në Rregulloren e programit, e cila u vihet në dispozicion studentëve sapo fillojnë vitin e parë akademik. Zyra e Çështjeve Studentore është përgjegjëse për informimin e studentëve përmes takimeve, emaileve, broshurave. etj. Nga takimi që zhvilluam në Institucion më personelin e kësaj zyre u informuam mbi këtë komunikim me studentët. Në fillim të çdo viti akademik, bëhen takime me studentët e viteve të para, ku shpërndahet çdo informacion në lidhje strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programeve të studimit. Informacioni është i aksesueshëm edhe në faqen ëeb.<br><br>Nga diskutimi me studentët rezultoi se ata ishin të mirëinformuar lidhur me programin e studimit, strukturën e tij, kohëzgjatjen, elementët e vlerësimit, etj.<br><br>Eshtë hartuar gjithashtu, për këtë qëllim, edhe Udhërrëfyesi I studentëve,<br>*Evidencat*<br>*Shtojca 3.16 Udhërrëfyesi i Studentëve (Prezantimi Vitet e I);*<br>*Vizita në institucion* |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. | DA i njeh studentët me dokumentacionin shpjegues për programin e studimit. GVJ konstaton se ky dokumentacion është i plotë dhe i organizuar në përputhje me kërkesat e ligjit të arsimit të lartë dhe akteve nënligjore në fuqi. Në këtë dokumentacion, i cili vihet në dispozion të studentëve me regjistrimin e tyre , por edhe nga çdo lektor i lëndës, në orën e parë të çdo semestri, studenti gjen informacion të detajuar për lëndën përkatëse, organizimin dhe shpërndarjen në semestra. Gjithashtu, çdo syllabus është një dokument përmes të cilit studenti informohet për tematikat dhe mënyrën e organizimit të orës mësimore (leksion, seminar, projekt, etj). Imformacioni gjendet dhe në faqen zyrtare ëeb te UNIKO<br><br>Nga takimi me studentët u konfirmua se ata njihnin lëndët, përmbajtjen dhe mënyrat e vlerësimit përmes dokumentave dhe zyrës përkatëse. |

| | |
|---|---|
| | Studentët informohen edhe për kriteret apo kërkesat në nivel lënde/moduli, pëmes faqes së pedagogëve , mbi programin/syllabusin e lëndës/modulit që mbulon, kreditet, modalitete e vlerësimit, literaturën etj.<br>Nga takimi me studentët rezulton se ata kanë informacion të plotë dhe strukturat përmbushin detyrimet sipas rregulloreve<br>Informcioni gjithashtu merret përmes monitorëve dhe stendave informuese Guidës së Universitetit, broshurave promocionale për programet e studimit, lajmërime në rrjetet social e e media, etj..<br><br>*Evidenca*<br>*Shtojca 3.16 Udhërrëfyesi i Studentëve (Prezantimi Vitet e I);*<br>*Shtojca 2.5 Rregullore e Programit të Studimit (MP) në "Drejtim Agrobiznesi" 2024-2025;*<br>**http://unkorce.edu.al/guida-uniko/;**<br>**, https://ëëë.facebook.com/unkorce/posts/4017993801558643,**<br>**https://ëëë.facebook.com/unkorce/posts/4025316040826419,** |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës. | Është treguar kujdes që ky program studimi të jetë përshtatur me nevojat e tregut të punës, me synimin për t'iu dhënë mundësi punësimi studentëve menjëherë pas diplomimit. Qëndra e karrierës në mënyrë sistematike, angazhohet për orientimin e studentëve në tregun e punës, në evidentimin e mundësive të tyre për karrierë. QK ka krijuar daat base me të dhëna mbi punësimin e studentëve të diplomuar dhe ka krijuar rrjetin e komunikimit me studentët pas diplomimit të tyre<br>Përmes një rrjeti komunikimi institucional, që përfshin institucionet arsimore në rajon, organizatat qeveritare dhe joqeveritare, njësitë administrative, bizneset private është bërë e mundur marrja e të dhënave dhe përpunimi i tyre rreth punësimit të studentëve dhe efektivitetit të diplomave që ofrohen, si dhe rreth nevojave të tregut për fushën e kompetencave që mbulon programi. SKVIA ka krijuar profilin e një ure lidhëse mes tregut të punës dhe UNIKO. Në ndihmë vjen edhe platforma GRADUA, ku mundësohet përditësimi i vazhdueshëm i njoftimeve për vende të reja pune. Është Qendra e Karrierës që njofton në kohë reale studentët e diplomuar (dhe ata aktualë) për çdo njoftim që vjen nga Agjensia e Punësimit. Stafi akademik i Departamentit të Agrobiznesit, bashkëpunon me këto struktura për përgatitjen e broshurave dhe fletëpalosjeve informuese dhe këshilluese.<br><br>*Evidence* |

| | |
|---|---|
| | **http://ëëë.graduaproject.com/** **https://unkorce.edu.al/studente-te-fakultetit-te-bujqesise-universitetit-fans-noli-moren-pjese-ne-panairin-ditet-e-bujqesise-2024/** |
| **Kriteri 4.** Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. | Sistemi i informimit të studentëve është gjithëpërfshirës, që nga stendat e monitorët, guidat, sistemi PITAGORA, faqja ëeb, rrjetet sociale, sinjalistika lihdhur me logjistikë e zhvillimit të mësimit. Sektori i Studimeve dhe Sektori i TIK menaxhon mbledhjen, përpunimin, dhe transmetimin e të dhënave që kanë të bëjnë me veprimtarinë akademike që nga regjistrimi i studentëve deri në diplomimin e tyre.[11].<br>Studentët kan në dispozicion edhe zyrat përkatëse si zyra e informimit të studentëve apo sekretaria e departamentit.<br>*Evidencat*<br>*Shtojca 1.6 Manual i sistemit elektronik PITAGORA*<br>*Vizita ne institucion*<br>*Shtojca 1.10 Rregullore e Sektorit të Studimeve dhe sektorit të TIK* |
| **Kriteri 5.** Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë. | Sistemi i informimit të studentëve është gjithëpërfshirës, që nga stendat e monitorët, guidat, sistemi PITAGORA, faqja ëeb, rrjetet sociale, sinjalistika lihdhur me logjistikë e zhvillimit të mësimit. Sektori i Studimeve dhe Sektori i TIK menaxhon mbledhjen, përpunimin, dhe transmetimin e të dhënave që kanë të bëjnë me veprimtarinë akademike që nga regjistrimi i studentëve deri në diplomimin e tyre.[12].<br>Studentët kan në dispozicion edhe zyrat përkatëse si zyra e informimit të studentëve apo sekretaria e departamentit.<br>*Evidencat*<br>*Shtojca 1.6 Manual i sistemit elektronik PITAGORA Shtojca 1.10 Rregullore e Sektorit të Studimeve dhe sektorit të TIK*<br>*Vizita ne institucion*<br>. |
| **Konkluzione** | *Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën e programit, organizimin dhe kohëzgjatjen e tij.*<br>*- Dokumentacioni shpjegues për programin e studimit është i plotë dhe i organizuar në përputhje me kërkesat e ligjit të arsimit* |

https://www.facebook.com/unkorce/posts/4095984270426262)

| | |
|---|---|
| | *të lartë dhe akteve nënligjore në fuqi.*<br><br>*- Gjatë vlerësimit të dokumentacionit dhe takimit me studentët evidentojmë që ata informohen hollësisht dhe gjërësisht për infrastrukturën dhe organizimin e programit të studimit, duke filluar nga organizimi i syllabuseve, orari i mësimit, aktivitetet jashtëkurrikulare, logjistika, laboratorët, modalitetet e organizimit të praktikave mesimore si edhe strukturat ndihmëse.*<br><br>*-Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për mundësitë e punësimit, përmes zyrës së karrierës dhe alumni*<br>*Sugjerim: Institucioni duhet te hartoje nje rregullore te qendres se karrieres* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit:** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit. | UNIKO mban të dhënat lidhur me numrin e studentëve e të diplomuarve, në cdo program studimi. Koordinimi i mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave vjetore bëhet nga Sektori i Studimeve dhe TIK në bashkëpunim me SKVIA. Specialisti i statistikave bazuar në të dhënat që merr nga Sektori i TIK dhe sektorë të tjerë përpunon statistikat dhe ua komunikon ato njësive përkatëse në universitet. Në përputhje me kriteret dhe procedurat e formatet e përcaktuara nga aktet nënligjore ky informacion përcillet edhe në bazën e të dhënave të sistemeve të MAS.<br>*Evidenca*<br>*Shtojca 1.10 Rregullore e Sektorit të Studimeve dhe sektorit të TIK;*<br>*Shtojca 1.5 Rregullore e Drejtorisë së Kurrikulave;*<br>*Shtojca 1.10 Rregullore e sektorit te studimeve* |
| **Kriteri 2.** Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e | UNIKO mban të dhënat lidhur me numrin e studentëve e të diplomuarve, në cdo program studimi. Statistikat vjetore lidhur me numrin e studentëve sigurohen nga sistemi ku mund të aksesohen të dhënat për numrin e studentëve të regjistruar, atyre |

| | |
|---|---|
| studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. | që shkëputen përkohësisht apo përfundimisht. Gjithashtu, në sekretari depozitohen dosjet e studentëve të plotësuara sipas kuadrit ligjor në fuqi, listat e frekuentuesve si dhe një numër dokumentacionesh për proçedurat e transferimit dhe të çregjistrimit. Përmes sistemit gjenerohen raporte të nevojshme për të informuar strukturat drejtuese si edhe MAS, ASCAL apo QSHA. Koordinimi i mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave vjetore bëhet nga Sektori i Studimeve dhe TIK në bashkëpunim me SKVIA. Specialisti i statistikave bazuar në të dhënat që merr nga Sektori i TIK dhe sektorë të tjerë përpunon statistikat dhe ua komunikon ato njësive përkatëse në universitet. Në përputhje me kriteret dhe procedurat e formatet e përcaktuara nga aktet nënligjore ky informacion përcillet edhe në bazën e të dhënave të sistemeve të MAS.Në bazë të detyrave të saj funskonale, sekretaria mësimore mbledh dhe përpunon të dhënat statistikore për regjistrimet e studentëve sipas programeve, përfshirë edhe numrin e studentëve të regjistruar, numrin e të diplomuarve, numrin e studentëve që ndërpresin studimet, etj. Këto të dhëna përpunohen në nivel programi dhe ndahen me njësitë bazë dhe njësinë kryesore përkatëse dhe janë pjesë e analizës vjetore të njësive kryesore[13] apo edhe të njësive bazë<br><br>*Evidenca*<br>*Shtojca 2.13 Analiza e Punës Mësimore dhe Kërkimore-Shkencore, e FB për Vitin Akademik 2022-2023;*<br>*Shtojca 3.8 Analiza Vjetore e Veprimtarisë së Njësisë Bazë;Shtojca 1.10 Rregullore e Sektorit të Studimeve dhe sektorit të TIK*<br>*Shtojca 1.10 Rregullore e sektorit te studimeve*<br>*Shtojca 1.6 Manual i Sistemit Elektronik PITAGORA* |
| **Kriteri 3.** Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. | Sistemi përmes të cilit menaxhohen të dhënat e studentëve është sistemi Pitagora. Secili student ka username dhe passëord të tijin, që i mundëson aksesin e lehtë në këtë sistem. Në këtë sistem, ka të dhëna për studentët në nivel individual dhe hidhen të dhënat nga pedogogët në lidhje me vlerësimin e studentëve (gjatë vitit dhe në provime).<br>Sistemi përditësohet me të dhëna nga pedagogët në lidhje me ecurinë e studimeve universitare, përfshi rezultatet e provimeve në mënyrë individuale dhe konfidenciale. Respektohet parimi i |

;

| | |
|---|---|
| | konfidencialitetit dhe legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale dhe rregulloren e brendshme të universitetit.<br>*Evidenca*<br>*Shtojca 1.6 Manual i sistemit elektronik PITAGORA;*<br>*Shtojca 1.9 Rregullore për Mbrojtjen, Ruajtjen dhe Përpunimin e të Dhënave Personale;* |
| **Kriteri 4.** Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse. | Për matjen e treguesve të performancës dhe planin e punes per permiresime te mundshme punon sektori i kurrikulës vlerësimit institucional dhe Alumni (SKVIA).<br>Detyrat funksionale të tij përcaktohen edhe në Manualin e Cilësisë të UNIKO . Aktiviteti i tij detajohet në planin kalendarik të veprimtarisë së këtij sektori. Ky sektor është përgjegjës për koordinimin e punës së NJSBC në fakultete, sekretaritë mësimore. Ai raporton tek strukturat drejtuese për ecurinë dhe nevojat për ndërhyrje dhe bën vlerësimin periodik të efikasitetit të veprimtarive mësimore, si një strukturë që ka pavarësi veprimi dhe akses në të dhënat e universitetit. Sekretaria mësimore vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.<br><br>*Evidenca*<br>*Shtojca 3.31 Raport i kontrollit të ushtruar për dokumentacionin mësimor;*<br>*Shtojca 1.16 Manuali i cilësisë së UNIKO*<br>*Shtojca 1.5 Rregullore e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional;*<br>*Shtojca 3.8 Analiza vjetore e veprimtarisë së njësisë bazë;*<br>*Shtojca 2.13 Analiza e Punës Mësimore dhe Kërkimore-Shkencore, e FB për Vitin Akademik 2022-2023*<br>*Vizita në institucion* |
| **Kriteri 5.** Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. | Cdo vit Njësia bazë "Agrobiznes", kryen analiza të cilat formalizohen përmes raporteve të detajuara mbi ecurinë e veprimtarisë akademike Në to preken edhe aspekte që kanë të bëjnë me cilësinë, në hyrje dhe dalje të studentëve, si edhe mundësitë për punësim sipas kërkesave të tregut të punës. Raportet, janë cështje diksutimi në Departament e më tej, përfshihen në analizat studimore të njësisë kryesore (FB), . Raportet shoqërohen edhe me propozime për përmirësime të nevojshme.<br>*Evidenca* |

| | |
|---|---|
| | *Shtojca 3.31 Raport i kontrollit të ushtruar për dokumentacionin mësimor;*<br>*Shtojca 1.16 Manuali i cilësisë së UNIKO*<br>*Shtojca 1.5 Rregullore e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional;*<br>*Shtojca 3.8 Analiza vjetore e veprimtarisë së njësisë bazë;*<br>*Shtojca 2.13 Analiza e Punës Mësimore dhe Kërkimore-Shkencore, e FB për Vitin Akademik 2022-2023* |
| **Konkluzione** | *-Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes një sistemi të brendshëm të infomacionit, PITAGORA i cili është i aksesueshëm në cdo kohë nga studentët*<br>*-Sistemi aksesohet nga sekretaria për gjenerimin e raporteve analitike të nevojshme.*<br>*-UNIKO përgatit raportet e analizës vjetore të cilët përmbajnë të dhëna kryesisht për kalueshmërinë, frekuentimin dhe ecurinë e proçesit mësimor.*<br>*- Sugjerim: Sugjerojmë ngritjen e njësisë së auditimit të brendshëm* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit:** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit. | Në zbatim të akteve ligjore dhe rregullatore në fuqi UNIKO ka mundësuar përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese. Kështu, studentët janë organizuar në këshilla studentorë në nivel njësie kryesore dhe institucioni. Këto këshilla shprehin mendime dhe propozime për cështje që lidhen me procesin mësimor si për planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve, përcaktimin e tarifave të studimit dhe kontributeve të tjera për studentët, bilancet vjetore paraprake të shpenzimeve ose ndarjen e burimeve financiare, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive etj., |

| | |
|---|---|
| | Këshillat e studentëve zgjidhen çdo dy vjet nga votat e studentëve dhe mbështeten në legjislacionin në fuqi.. Gjithashtu, studentët marrin pjesë aktive përmes përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse.si në Senatin Akademik, në NJSBC si edhe një përfaqësues i zgjedhur nga studentët angazhohet edhe në Bordin e Administrimit[14].<br>*Evidenca*<br>*Shtojca 2.24.1 Model - Anëtarësimi i studentëve në senatin akademik;*<br>*Shtojca 3.11 Lista e NJSBC*<br>*Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB, Neni 94;*<br>*Shtojca 2.24.1 Model - Anëtarësimi i studentëve në senatin akademik* |
| **Kriteri 2.** Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme. | Në zbatim të akteve ligjore dhe rregullatore në fuqi UNIKO ka mundësuar përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese. Kështu, studentët janë organizuar në këshilla studentorë në nivel njësie kryesore dhe institucioni. Këto këshilla shprehin mendime dhe propozime për cështje që lidhden me procesin mësimor<br>Këshillat e studentëve zgjidhen çdo dy vjet nga votat e studentëve dhe mbështeten në legjislacionin në fuqi.. Gjithashtu, studentët marrin pjesë aktive përmes përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse.si në Senatin Akademik, në njësinë e sigurimit të brendshëm të cilësisë si edhe një përfaqësues i zgjedhur nga studentët angazhohet edhe në Bordin e Administrimit[15]. Studentët janë të përfaqësuar në Senatin Akademik dhe në Komisionet e përhershme në nivel të njësisë kryesore, me të drejtë të plotë vote.<br>Nga takimi me studentët rezultoi që ata janë të përfshuirë institucionalisht në këto struktura por roli i tyre nuk është aktiv aq sa duhet.<br>*Evidenca*<br>*Shtojca 2.24.1 Model - Anëtarësimi i studentëve në senatin akademik;*<br>*Shtojca 3.11 Lista e NJSBC*<br>*Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB, Neni 94;*<br>*Shtojca 2.24.1 Model - Anëtarësimi i studentëve në senatin akademik*<br>*Shtojca 1.17 Rregullorja e Këshillit Studentor,* |

| | |
|---|---|
| | **(https://ëëë.facebook.com/Keshilli.Studenteve.Fan.S.Noli/posts/3673764606006400,**<br>*Vizita në institucion*<br>. |
| **Kriteri 3.** Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj. | Nga takimi që zhvilluam në Institucion, u informuam se koordinatori i programit që është dhe përgjegjësi i Departamentit që mbulon këtë program studimi është në kontakt të përhershëm me studentët dhe shërben si urë komunikimi midis tyre dhe stafit të departamentit, për të adresuar problemet që dalin në kohë reale.<br><br>Rol shumë të rëndësishëm luajnë pyetësorët e vlerësimit, të cilët janë një instrument i drejtpërdrejtë për të mbledhur opinionet dhe sugjerimet e studentëve për procesin mësimor dhe për mësimdhënien. Vlerësimet që studentët bëjnë u përcillen pëdagogëve, shefit të departamentit, dekanit dhe rektorit dhe ato shërbejnë si inpute për përmirësime të nevojshme të programit të studimit.<br><br>Gjithashtu, pjesëmarrja si antarë në komisione e studentëve, shihet si një mënyrë për të marrë opinionet e tyre rreth prograneve të studimit.<br><br>Këshillat studentore shprehin mendime dhe propozime për planet dhe programet e studimeve. Dekani i FB organizon takime periodike me studentët , konkretisht me përfaqësues të këshillave studentorë dhe drejtuesit e njësive bazë, ku diskutohen dhe shkëmbehen ide në lidhje me procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit, me qëllim reflektimin e sugjerimeve të studentëve.<br>*Evidenca*<br>*Shtojca 3.13 Pyetësori i NJSBC pas sezonit në bashkëpunim me këshillin studentor;*<br>*Shtojca 3.14 Të dhëna nga pyetësorët me studentët;* |
| **Kriteri 4.** Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ | Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet e drejta e studentit për të ankimuar rezultatin e vlerësimit. Gjithashtu në këte rregullore detajohet procedura se si bëhet ankesa, si ndiqet deri në përgjigjen përfundimtare. Studenti e adreson ankesën pranë Zyrës së Çështjeve studentore, më tej ajo kalon në Departament e po të jetë e nevojshme në Dekanat.. Për trajtimin e ankimimit është ngritur Komisioni që trajton ankimimin dhe vendos në se ai pranohet apo refuzohet.<br><br>GVJ pasi shqyrtoi dokumentacionin e gjen atë të plotë dhe shumë të kuptueshëm. Ata njohin procedurën |

| | |
|---|---|
| njësisë/pedagogut përgjegjës. | *Evidenca*<br>*Shtojca 2.3. rregullore e programit të studimit*<br>*Vizita në institucion*<br>. |
| **Konkluzione** | *Studentët janë të përfaqësuar në strukturat vendimmarëse të UNIKO Ata kanë një përfaqësues të zgjedhur prej tyre në organin më të lartë vendimmarës që është Senati Studentët janë Antarë në Këshillat studentorë, në Bordin e Administrimit dhe në RVB*<br>*-Përfshirja e studentëve në vendimmarrje dhe vlerësim të proçesit akademik realizohet edhe përmes tërheqjes dhe vlerësimit të opinionit të tyre në raport me mësimdhënien, praktikën, përfshirjen në projekte e grupe studimore.*<br>*-Studentët vlerësojnë pozitivisht cilësinë e mësimdhënies.*<br>*-Institucioni aplikon procedura të qarta për shqyrtimin e ankesës së studentit për rezultatin e provimit, të formalizuara në rregulloren e departamentit dhe rregulloren e programit të studimit.*<br>*-Koordinatori i programit është në kontakt të përhershëm me studentët dhe shërben si urë komunikimi midis tyre dhe stafit të departamentit për të adresuar problemet që dalin në kohë reale.*<br>*-Koordinatori kujdeset për përfshirjen e studentëve në proçesin e rishikimit të kurrikulës, duke reflektuar opinionet e dhëna nga ata përmes pyetësorëve të vlerësimit.*<br>*Sugjerime : Duhet të përfshihen në pyetësorë më shumë pyetje për programin*<br>*Studentët që janë antarë të komisioneve duhet të bëjnë takime me studentët e tjerë dhe të luajnë rol më aktiv në përfaqësimin e interesave të tyre* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Shkalla e përmbushjes së standardit:** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | **X** | |

| **Standardi V.6**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit. | Në funksion të informimit të studentëve në varësi të çështjeve të ndryshme janë:<br>- Zyra e Studimeve<br>- Zyra e Karrierës dhe ALUMNI;<br>- Sekretaria mësimore<br>Funksionet e këtyre zyrave përcaktohen në Statutin e UNIKO si edhe në rregulloret respektive të zyrave. Zyra për çështjet studentore përgjigjet për informim të studentëve deri në regjistrim. Sekretaria i informon lidhur me çështjet e frekuentimit dhe vlerësimit, Zyra e karrierës dhe alumni mbi qasjet ndaj tregut të punës, internshipet dhe mundësitë për punësim. Nga takimi me studentët rezultoi se ata janë në kontakt të vazhdueshëm me këto zyra, të cilat janë shumë bashkëpunuese dhe të gatshme për ofrimin e informacioneve që ata kërkojnë.<br>UNIKO është pjesë e Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH), dhe përdor sistemin "Pitagora" në shërbim të studentëve.. Edhe në ëebsitin e UNIKO gjendet informacion i vlefshëm dhe i besueshëm për sa i përket veprimtarisë akademike të universitetit, strukturave dhe njësive përbërëse, programeve të studimit si edhe kuadri ligjor dhe rregullator etj. Informcioni akeseohet ehde përmes programit të transparencës,. Nëpërmjet projektit të instalimit të shërbimeve të paketës *"Office 365"* u mundësua komunikimi i stafit akademik dhe studentëve duke përfshirë komunikim nëpërmjet adresave elektronike me domain @*unkorce.edu.al*.<br>Stendat dhe Guidat gjithashtu ndihmojnë në informimin e studentëve dhe stafeve<br>*Evidenca .*<br>*https://unk.pitagora.rash.al/https://unk.pitagora.rash.al/*<br>*Shtojca 2.23 Raport Instalimi i Projektit OFFICE 365*<br>*Shtojca 1.10 Rregullore e studimeve*<br>*Shtojca 2.24 Jeta studentore dhe QKA* |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të | Në UNIKO dhe FB funksionon një sistem i plotë që u shërben studentëve për informim dhe këshillim. Strukturat që përbëjnë këtë sistem janë : Llogaritë personale të çdo studenti në platformën dixhitale Pitagora, Sektori i Studimeve dhe TIK, Rrjete sociale (FB dhe Instagram)., Qendra e Karrierës, Stenda dhe monitorë në mjedise të dukshme, Zyra e informimit të studentëve, Sekretaria e departamentit |

| | |
|---|---|
| bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. | Detyrat funksionale të secilës trukturë përcaktohen në rregulloret përkatëse, ku specifikohen edhe aspektet e punës së secilit në shërbim të studentëve dhe stafeve.Kështu, , në se strukturat e tjera kanë për detyrë informimin e studetëve për ecurinë e procesit mësimor dhe ndjekjen e përparimit të tyre, është QËndra e karrierës, ec ila që I assiton ata dhe I këshillon për aspekte që lidhen me karrierën.<br><br>*Evidenca*<br>*Shtojca1.6 Manual i Sistemit Elektronik PITAGORA*<br>*Shtojca 2.24 Jeta studentore dhe QKA*<br>*Shtojca 1.10 RRegullore e tudimeve* |
| **Kriteri 3.** Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. | Pranë UNIKO funksionon Qendra e Karrierës dhe Alumni , e cila në bashkëpunim me dekanatet organizon takime informuese me studentët, shpërndan informacionin rreth organizimit të studimeve, të drejtat dhe detyrat e studentëve, vlerësimin dhe sistemin e krediteve, pjesë nga rregulloret e studimeve të universitetit, informacione të rëndësishme kontakti etj.<br>SKVIA, ka krijuar profilin e një ure lidhëse mes tregut dhe UNIKO. Platforma GRADUA, mundeson përditësimin e vazhdueshëm të njoftimeve për vende të reja pune. Gjothashtu, tek studentët përcillte dhe informacioni që vjen nga agjensitë e punësimit[16].<br>Informimi dhe këhillimi bëhet nga Qendra e Karrierës . Por ajo bashkëpunon me strukturat të tjera për marrjne dhe përpunimin e informacioneve si Sektori i Studimeve, Sektori i Kurrikulave dhe Vlerësimit Institucional dhe Sektorin e Informacionit dhe Promocionit Prevec përmes takimeve, informacioni përcillet edhe përmes broshurave dhe fletëpalosjeve . Studentëve u përcillet edhe informacioni mbi praktikat profesionale, të cilat kryhen kryesisht në subjekte e institucione me të cilat UNIKO ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi. .<br><br>*Evidenca gff*<br>*Shtojca 3.16 Udhërrëfyesi i Studentëve (Prezantimi Vitet e I);*<br>*http://ëëë.graduaproject.com/*<br>*Shtojca 3.10 Praktika e Organizimit të Tryezave të Përbashkëta me Operatorët e Sektorit Privat;* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4.** Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. | Aktualisht nuk ka një sistem por Qendra e Karrierës, në bashkëpunim me njësitë kryesore po krijon një bazë të dhënash në lidhje me punësimin e studentëve të diplomuar. Sistemi synon të krijojë një strukturë të qëndrueshme për analizat statistikore në lidhje me shkallën e punësimit dhe zgjerimin e rrjetit të komunikimit me studentët pas diplomimit të tyre.<br>Do të bëhet edhe gjurmimi nëpërmjet alumnit, ku evidentohet raporti i të punësuarve në profil[17].<br><br>*Evidenca*<br>*Shtojca 3.12.1 Strategjia e studimit të tregut;*<br>*Shtojca 2.21 Gjurmimi Alumni* |
| **Konluzione** | *UNIKO ka ngritur një sistem funksional për informimin e studentëve në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.*<br><br>-Në *funksion të informimit të studentëve në varësi të çështjeve të ndryshme janë: Zyra e Studimeve , Zyra e Karrierës dhe ALUMNI;Sekretaria mësimore, pranë së cilës studentët gjejnë mbështetje dhe informacione të vlefshme si për internshipet gjatë zhvillimit të procesit mësimor, ashtu edhe për qasjen dhe mundësitë e tregut të punës, .*<br><br>*-Zyra e Karrierës dhe Alumni nuk ka sistem per mbajtjen e te dhenave per ku jane punesuar*<br>*Sugjerim: Duhet te krijohet një sistem për të gjurmuar punësimin e studentëve* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit:** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

| **Standardi VI.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve. | Institucioni ka në vëmendje aplikimin e metodave bashkëkohore innovative të mësimdhënies dhe në këtë kuadër ka siguruar edhe infrastruturën e nevojshme për këtë qëllim duke pajisur mjediset me Smartboarde, All in One Interactive Flat Panel, Videoprojektorë etj) të cilat janë të instaluara në çdo klasë apo auditor të FB). Elementë të cilësisë së mësimdhënes që lidhen me metodat inovative analizohen edhe cdo vit në kuadër të analizës vjetore.Gjithashtu, pedadogët përdorin edhe platforma online si Google Meet / Classroom, Zoom dhe Teams. Për këto ka udhëzues të përgatitur nga Sektori i TIK, dhe janë organizuar takime trajnuese me anëtarë të stafit akademik të çdo departamenti.<br><br>*Evidenca*<br>*Shtojca 3.8 Analiza vjetore e veprimtarisë së njësisë bazë;*<br>*Shtojca 3.24 Manual Trajnimi për mësimin online*<br>*Vizita ne institucion*<br>. |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik. | Monitorimi dhe vlerësimi i aftësive mësimdhënëse dhe inovative kryhet përmes strukturave për sigurimin e cilësisë që janë NJSBC, NJSBC është njësia bazë, e cila përdor mekanizmat për sigurimin e cilësisë sic janë pyetësorët. Institucioni ka hartuar rregulloren për secilën strukturë ku paraqiten funksionet e tyre dhe modalitetet e bashkëpunimit. Rezultatet e pyetësorëve u shpërndahen pedagogëve individualisht, por edhe përmes Përgjegjësit të Departamentit dhe Dekanit. NJBSC harton raportin vjetor mbi bazën e përpunimit të të dhënave nga pyetësorët. Tek pyetësori i studentëve ka pyetje për përdorimin e mjeteve të inovacionit dhe teknologjisë, përmes të cilave vlerësohen edhe aftësitë inovative të personelit.<br>Çdo vit bëhet vlerësimi i performancës akademike, përmes : pyetësorëve që plotësohen nga studentët, pyetësorëve që plotësohen nga kolegët si edhe një raport vetëvlerësimi, ku secili pedagog ballafaqon objektivat me arritjet vjetore. Këto pasqyrohen në raportin e departamentit e më tej në atë të Fakultetit dhe Universitetit. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore monitoron në mënyrë periodike cilësinë e programeve të studimit, aplikimin e metodave të reja të mësimdhënies, rekrutimin e stafit me gradat dhe titujt e duhura, anketimet dhe kontrollet e vazhdueshme të procesit mësimor, si dhe çdo aktivitet që shërben për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe jetës studentore. Nuk ka evidence |

| | |
|---|---|
| | per vlerësimin e stafeve ndihmëse<br><br>Nga takimi me përfaqësues të NJBSC rezultoi se është bërë një analizë vjetore e detajuar lidhur me pyetësorët Institucioni ka përgatitur dhe një Manual të posaçëm për sigurimin e cilësisë.<br><br>*Evidenca*<br>*Shtojca 3.7.1 Raporti institucional i vlerësimit të brendshëm UNIKO (Relacioni);*<br>*Shtojca 1.16 Manuali i Cilësisë së UNIKO;*<br>*Shtojca 3.13 Pyetësori i NJSBC pas sezonit në bashkëpunim me këshillin studentor;*<br>*Shtojca 3.17 Model analiza në përfundim të një moduli;*<br>*Shtojca 3.8 Analiza vjetore e veprimtarisë së njësisë bazë;*<br>*Shtojca 3.14 Të dhëna nga pyetësorët me studentët* |
| **Kriteri 3.** Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve. | Përfshirja e studentëve në vlerësimin e mësimdhënies është garantuar përmes të drejtës së tyre për të qënë antarë të strukturave përkatëse, të fomalizuara në aktet rregulatore e ligjore të UNIKO. Në funksion të dëgjimit të zërit të tyre, strukturat drejtuese të UNIKO organizojnë takime periodike me bazë 3-mujore me studentët , me përfaqësuesit e këshillave studentorë dhe drejtuesit e njësive bazë, ku diskutohen dhe shkëmbehen ide në lidhje me procesin e përmirësimit të programeve të studimit, përdorimi i formave dhe metodave të mësimdhënies, mënyrat dhe format e vlerësimit të dijeve, me qëllim reflektimin e sugjerimeve të studentëve. Pyetësorët janë instrumenti më ëfektiv që përdoret sepse përmes tyre, studentët kanë mundësinë të shprehin opinionet, qëndrimet dhe sugjerimet e tyre, ndër të tjera, edhe për përdorimin e formave dhe metodave të mësimdhënies, mënyrat dhe format e vlerësimit të dijeve etj.<br>Edhe procedurat e ankimimit janë të formalizuara[18].<br>*Evidenca*<br>*Shtojca 3.13 Pyetësori i NJSBC pas sezonit në bashkëpunim me këshillin studentor;*<br>*Shtojca 3.14 Të dhëna nga pyetësorët me studentët;*<br>*Shtojca 3.14 Të dhëna nga pyetësorët me studentët* |
| **Kriteri 4.** Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në | Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion vërejmë se UNIKO publikon raportet e vlerësimit të jashtëm. Gjatë vizitës në IAL u informuam se raporti vjetor i NJSBC publikohet në ëeb. Në të është edhe plani i masave për përmbushjen e rekomandimeve. Kjo |

[18] Shtojca 3.14 Të dhëna nga pyetësorët me studentët;

| | |
|---|---|
| mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit. | tregon transparencë në procesin e vlerësimit të cilësisë në këtë institucion.<br>Rezultatet e anketimeve përmes pyetësorëve diskutohen në mbledhjet e Dekanateve ose në departamente.Gjithashtu, në fund të çdo viti, rezultatet e auditimit raportohen në takimet që organizohen për analizën vjetore të punës, me pjesëmarrje të gjerë të asamblesë akademike dhe studentëve; Rektorati mundëson edhe publikimin e tyre në Programin e Transparencës, në faqen zyrtare të internetit.<br>*Evidenca*<br>*Shtojca 3.14 Të dhëna nga pyetësorët me studentët;*<br>**http://unkorce.edu.al/programi-i-transparences-2** |
| **Kriteri 5.** Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. | . Promovimi i stafeve bëhet përmes angazhimit të tyre të motivuar në programe e trajnime të ndryshme. Përmendet hartimi i modulit "Instruments and Policy Evaluation Methods" në bashkepunim me staf akademik dhe ekspertë të Universitetit Hohenheim, Gjermani; Hartimi i modulit "Territory Innovation and actions" në bashkepunim me staf akademik dhe Institutin kërkimor-shkencor CIHEAM, Montpellier, Francë, Hartim i modulit "Supply Chain Management" në bashkëpunim me staf akademik të Universitetit "Nuertingen-Geislingen", Gjermani; Mësimdhënie pranë universitetit "Nuertingen-Geislingen" në programin e studimit Master Shkencor; gjithashtu edhe udhëheqje e përbashkët e tre studentëve nga Instituti kërkimor "CIHEAM", pjesë e programit MIDAS; Mësimdhënie në programin e ciklit të tretë të studimit (Master Ekzekutiv) pranë UBT etj.<br>Gjithashtu, stafit akademik i mundësohet kryerja e studimeve brenda dhe jashtë vendit nëpërmjet vitit sabatik, si dhe nxitet të marrë pjesë në tryeza të rrumbullakëta diskutimesh dhe në trajnime, që janë pjesë e kornizës zbatuese të projekteve ndërkombëtare ku UNIKO është partner.<br>Një praktikë tjetër përmes të cilës UNIKO promovon stafin akademik është edhe organizimi i veprimtarive që prezantojnë për një publik më të gjerë kontributin akademik dhe shoqëror të kërkimit shkencor të stafit të tij.<br>*Evidenca*<br>*Shtojca 2.19 Model i hartimit të një moduli, në bashkepunim me staf akademik të Universitetit Hohenheim, Gjermani;*<br>*Shtojca 2.20 Model i hartimit të një moduli, në bashkepunim me staf akademik & Institutit kërkimor-shkencor CIHEAM;*<br>*Shtojca 2.9.1 Certifikata pjesëmarrje e stafit akademik në bashkëpunime ndërkombëtare;* |

| | |
|---|---|
| | *Shtojca 2.10.2 Listë Përmbledhëse e Marrëveshjeve Institucionale;*<br>*Shtojca 2.4 Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare të UNIKO (2022-2023* |
| **Konkluzione** | *Pranë UNIKO janë miratuar politikat, janë krijuar strukturat dhe hartuar procedurat për sigurimin e cilësisë , duke krijuar një sistem funksional, i cili monitoron e vlerëson periodikisht cilësinë e programit të studimit.*<br>*-Studentëve u garantohet e drejta për të qënë pjesë aktive e strukturave për Sigurimin e Standardeve te Cilësisë, si edhe e komisioneve të tjerë në nivel institucional, fakulteti dhe departamenti.*<br>*- UNIKO në fund të çdo viti harton një raport në nivel institucional, me gjetjet e analizës lidhur me sigurimin e cilësisë , i cili shoqërohet me planin e ndërhyrjeve për përmirësime cilësore të mëtejshme.*<br>*-Të dhënat e raportit të vlerësimit të cilësisë, që evidentojnë arritjet e stafeve i shërbejnë promovimit të praktikave të mira, ngritjes në karrierë dhe nxitjes së stafit akademik për përmirësim të nivelit të mësimdhënies.*<br>*-Procedurat për garantimin e sigurimit të brendshëm të cilësisë janë formalizuar në Rregulloret e strukturave përkatëse si NJSBC,dhe Manualin e Sigurimit të cilësisë*<br>*Sugjerim Mund të aplikohen edhe stimuj financiarë për pedagogë që kanë arritje të spikatura në procesin mësimor dhe kërkimor dhe të bëhet dhe vlerësimi për stafet ndihmësakademike* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit:** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi VI.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për | UNIKO ka ngritur sistemin e duhur për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Ky sistem përbëhet nga strukturat, politikat dhe procedurat |

| | |
|---|---|
| Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. | e sigurimit të cilësisë, bazuar në kuadrin ligjor në fuqi. . Politikat përkatëse janë formalizuar në dokumentat strategjikë si Statuti, Rregullorja e UNIKO. Procedurat janë formalizuar në Rregulloret e funksionimit të NJSBC, KPSSC dhe Manualin e Sigurimit të Cilësisë. Të gjithë këta dokumenta zbatojnë kërkesat e legjislacionit të Arsimit të lartë.<br>Strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë janë NJSBC dhe Komisioni i përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë. NJSBC është njësia bazë, e cila përdor mekanizmat për sigurimin e cilësisë sic janë pyetësorët. Kjo njësi i mbledh, i përpunon dhe rezultatet ia kalon KPSSC, i cili është një organ i një niveli më strategjik.<br>Pra i gjithe sistemi bazohet në Ligjin nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" ; VKM nr. 531, datë 11.09.2018 mbi "Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë"; Statutin e UNIKO, Planin Strategjik të Zhvillimit të UNIKO, 2022-2027, Rregulloren e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore të UNIKO. Standardet për sigurimin e cilësisë hartohen nga UNIKO, në përputhje me Kodin e Cilësisë, hartuar nga ASCAL dhe MAS. Në FB, sigurimi i brendshëm i cilësisë realizohet sipas rregullave të përcaktuara në kapitullin VIII të Rregullores së Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore të FB "Vlerësimi i cilësisë " ku specifikohen proçedurat dhe strukturat për vlerësimin e cilësisë.<br>*Evidenca*<br>*Shtojca 1.3 Plani Strategjik i Zhvillimit të Universitetit 2022-2027*<br>*Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB, Neni 96* |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm. | UNIKO ka ngritur Sistemin e brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, ku përfshihen edhe studentë dhe bashkëpunëtorë të jashtëm. NJSBC bashkëpunon me Departamentet për të këshilluar mbi vlerësimet që lidhen me cilësinë e mësimdhnies. UNIKO nuk ka rekrutuar një ekspert të jashtëm për sigurimin e cilësisë.. Në KPSSC bën pjesë dhe një student. Nga takimi me antarë të KPSSC u informuam se në rastet kur bëhen rishikime kurrikulash apo programesh, ata zhvillojnë edhe takime me ekspertë të fushave të studimit, për të përshtatur programet e studimit me kërkesat cilësore të tregut të punës.<br>Elementët e vlerësimit të cilësisë janë pjesë integrale e kuadrit |

| | |
|---|---|
| | strategjik të institucionit. Në të gjithë dokumentat strategjikë si Plani strategjik, Statuti, e më tej në rregulloret e strukturave përkatëse demonstrohet rëndësia që i jep ky institucion përmirësimit të cilësisë në mësimdhënie e mësimnxënie, në mënyrë që të bëhet sa më konkurrues në tregun e punës.Nuk ka ekspert të jashtëm për vlerësimin e cilësisë.<br>*Evidenca*<br>*Shtojca 2.4 Raport i analizës së veprimtarisë mësimore, shkencore dhe financiare të UNIKO;*<br>*Shtojca 1.16 Manuali i cilësisë së UNIKO;*<br>. |
| **Kriteri 3.** Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit. | UNIKO i është nënshtruar procesit të akreditimit institucional, bazuar në Ligjin për Arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë, përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm. Në këtë kuadër institucioni ka vënë në dispozicion strukturat e tij të vlerësimit të cilësisë. UNIKO ka konsideruar me seriozitet dhe angazhim profesional raportet e vlerësimit të jashtëm dhe ka hartuar dhe zbaton plane pune të detajuara për përmbushjen e rekomandimeve të dhëna nga GVJ dhe Bordi i Akreditimit të ASCAL. Funksionon<br>Drejtoria e Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional si pjesë e administratës së Rektoratit që nga viti 2008[19].<br>UNIKO i është nënshtruar me sukses (dy herë) Akreditimit Institucional, ndërsa vetëvlerësimi i programit të ciklit të dytë të studimit (MP) në "Drejtim Agrobiznesi", po kryhet në kuadër të procesit të akreditimit.<br>*Evidencë*<br>*Vizita në institucion*<br>*2.1.1 Certifikatë dhe vërtetim akreditimi* |
| **Kriteri 4.** Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën | Për të analizuar arritjet në nivel institucional si dhe kontributin e tyre për arritjet e objektivave strategjike, UNIKO ka përcaktuar dhe treguesit e performancës. Lista e treguesve të performancës realizohet dhe rifreskohet në mënyrë të vazhdueshme nga NjBSCdhe KPSSC. Ndër treguesit kryesorë të përformancës përmendim publikimet, botimet, pjesëmarrjet në konferenca e aktivitete kombëtare e ndërkombëtare, pozicionet menaxheriale si edhe elementët e mësimdhënies. Treguesit janë sasiorë dhe cilësorë. NJSBC përpiqet për monitorimin e |

[19] Shtojca 1.5 Regullore e Drejtorisë të Kurrikulave dhe Vlerësimit Institucional;

| | |
|---|---|
| promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit. | proceseve të brendshme të sigurimit të cilësisë, të cilat janë standardizuar si procese që kryhen si në nivel institucional, ashtu edhe në nivel programi studimi, duke realizuar vlerësime analitike e krahasuese, si dhe proçese të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në bazë të Kodit të Cilësisë në Arsimin e Lartë. Rezultatet e treguesve të performancës, diskutohen në fund të çdo viti<br>Mekanizmat e sipërpërmendur shërbejnë për evidentimin e arritjeve më të spikatura të stafeve në procesin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor,<br>*Evidenca*<br>*Shtojca 2.13 Raporti vjetor i Veprimtarisë së FB;*<br>*Shtojca 3.8 Analiza vjetore e veprimtarisë së njësisë bazë*<br>*Shtojca 3.8 Analiza vjetore e veprimtarisë së njësisë bazë*<br>. |
| **Konkluzione** | *Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë, institucioni ka krijuar një sistem funksional të menaxhimit të cilësisë të përbërë nga politika dhe proçedura, si dhe struktura për sigurimin e brendshëm të cilësisë*<br>.<br><br>*-NJSBCdhe KPSSC kryejnë vlerësimin dhe monitorimin e proçeseve të sigurimit të brendshëm të cilësisë përmes instrumemtave si pyetësorët, raportet vjetore, etj. ,*<br><br>*-Vlerësimi i brendshëm i cilësisë kryhet periodikisht përmes një sistemi të bazuar në standarde, duke realizuar vlerësime dhe analiza të detajuara që synojnë të promovojnë praktikat më të mira dhe përmirësojnë cilësinë.*<br><br>*- UNIKO përdor tregues konkretë të performancës, të cilët përbëjnë bazën e analizave të cilësisë. Lista e treguesve të performancës përmban tregues që lidhen me procesin mësimor, kërkimin shkencor si edhe angazhimin institucional. Ajo realizohet dhe rifreskohet në mënyrë të vazhdueshme nga NJSBC dhe KPSSC*<br>*Sugjerim*<br>*Mund të përdoren më mirë aspekte promovuese të stafeve akademike për arritjet e tyre*<br>*Të angazhohet një ekspert i jashtëm për vlerësimin e cilësisë.* |

| Shkalla e përmbushjes së standardit: | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

**Standardi VI.3**

| Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.<br>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit. | UNIKO përdor mekanizma e procese formale të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit. Ky poces fillon që nga vendosja e objektivave vjetore nga vetë stafet, monitorimi i realizimit të tyre në nivel individual, Departamenti, Fakulteti dhe Universitetit. Gjetjet e këtyre analizave janë pjesë e Raportit që përgatitet në mënyrë hierarkike. Disa nga instrumentat e përdorur janë analizat periodike të punës në nivel departamenti, të cilat u përcillen strukturave më të larta për përgatitjen e raporteve në nivel Fakulteti dhe Universiteti. Vetëvlerësimi është një proces sistematik i mbledhjes, rishikimit dhe përdorimit të të dhënave sasiore dhe cilësore nga burime të ndryshme, me qëllim përmirësimin e mësimnxënies së studentëve dhe vlerësimin e përmbushjes së standardeve akademike.<br><br>Raportet e performancës akademike, raportet e vlerësimit bazuar në pyetësorët, përbëjnë instrumentat kryesorë për monitorimin e programeve të studimit. Këto raporte analizohen nga strukturat që merren me sigurimin e cilësisë, NJSBC dhe KPSSC pasi janë shqyrtuar nga Departamentet përkatëse.<br><br>Gjatë vizitës në institucion u informuam se NJSBC ishte aktive në përgatitjen e këtyre raporteve si edhe në ndjekjen e rekomandimeve të lëna në kuadër të procesit të akreditimit, përmes një plani pune. Koordinatori i programit luan një rol të rëndësishëm në koordinimin me Departamentin përkatës.<br><br>FB, bazuar në Rregulloren e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore Shkencore, organizon në fund të çdo viti akademik rishikimin periodik të programeve të studimit dhe rregulloren mësimore. Gjithashtu nga Dekani i Fakultetit angazhohet një komisionin ad-hoc për rishikimin e programeve të studimit dhe rregulloreve përkatëse. Përme këtij procesi bëhet rishikimi i shpërndarjes së krediteve për modulin apo grup-modulet përkatëse; rishikimi I programeve mësimore të moduleve të veçanta; dhe rishikimi i opinioneve/feedback-ut të marrë nga studentët. |

| | |
|---|---|
| | Pedagogët, në përfundim të vitit akademik relatojnë për të gjitha aspektet e organizimit të mësimdhënies për modulet përkatëse, duke evidentuar problemet dhe sugjeruar zgjidhje<br>Si shembull sillen ndryshimet e bëra gjatë vitit 2023, në kuadër të riorganizimit të programit të studimit, në përputhje me gjetjet e përftuara përmes Platformës GRADUA dhe konkluzioneve studimore në kuadër të analizave të tregut të punës.<br>*Evidenca*<br>*Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB*<br>*Shtojca 3.8 Analiza vjetore e veprimtarisë së njësisë bazë*<br>*Shtojca 2.13 Raporti vjetor i Veprimtarisë së FB për vitin akademik 2022-2023;* |
| **Kriteri 2.** Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët. | Raportet vjetore përfshijnë analizën e arritjeve të stafeve, Departamenteve, bazuar në objektivat e vendosura në nivel përsonal dhe departamenti. Gjithashtu, bazuar në gjetjet e analizës së vlerësimit përmes pyetësorëve evidentohen edhe mangësitë dhe nevojat për ndërhyrje në funksion të rritjes së cilësisë së programeve të studimit. Njësia kryesore, në fund të çdo viti akademik përgatit analizën vjetore e cila i përcillet departamenteve për konsultim dhe reflektim, në funksion të përmirësimit të programit të studimit. Të dhënat e vlerësimit përfshihen në raportet vjetore të departamentit dhe Fakultetit. Në mbledhjet e departamentit, ku analizohen të dhënat e vlerësimit, diskutohet dhe plani i masave për adresimin e mangësive dhe përmirësimin e cilësisë.<br><br>Bazuar në analizat e realizuara, evidentohen edhe rastet e praktikave më të mira, të cilat promovohen përmes ngritjes në karrierë "<br><br>Këto informacione u konfirmuan edhe gjatë takimit ne institucion Pjesë e raportit të analizës vjetore të veprimtraisë së FB është edhe seksioni i parashikimit të aktiviteteve mësimore dhe kërkimore-shkencore për vitin e ardhshëm akademik.<br><br>*Evidenca*<br>*Shtojca 2.4 Raporti i Analizës Vjetore të Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore & Financiare e UNIKO;*<br>*http://unkorce.edu.al/programi-i-transparences-2*<br>*Shtojca 2.13 Raporti vjetor i Veprimtarisë së FB për vitin akademik 2022-2023;*<br>*Shtojca 1.3 Plani Strategjik i Zhvillimit të Universitetit 2022-2027* |

| | |
|---|---|
| | *Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB*<br>*Shtojca 2.5 Rregullore e Programit të Studimit (MP) në "Drejtim Agrobiznesi" 2024-2025;*<br>*Shtojca 3.14 Të dhëna nga pyetësorët me studentët* |
| **Kriteri 3.** Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera. | Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies bëhet përmes : vetëvlerësimit, vlerësimit nga kolegët, vlerësimit nga studentët. Gjithashtu, pedagët ndjekin seancat e mësimdhënies të njëri-tjetrit, për të evidentuar teknikat më të mira dhe nevojat për përmirësime. Vlerësimi i performancës së veprimtarisë akademike ballafaqon standardet e paracaktuara në formën e objektivave për sigurimin e cilësisë, me nivelin e realizimit të tyre.Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies bazohet në të dhënat që përftohen nëpërmjet anketimit të studentëve.<br>Në funksion të rritjes së cilësisë dhe promovimit të metodave cilësore të mësimdhënies janë zhvilluar leksione të hapura nga pedagogë me tituj shkencorë (profesorë dhe titullarë lëndësh, me eksperiencë të gjatë në mësimdhënie), Për vlerësimin e provimeve, në çdo rast aplikohet ngritja e komisioneve të provimit, me synimin për të bërë një vlerësim sa më objektiv të rezultateve.<br>*Evidenca*<br>*Shtojca 2.2 Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FB*<br>*Shtojca 2.5 Rregullore e Programit të Studimit (MP) në "Drejtim Agrobiznesi" 2024-2025;*<br>*Shtojca 3.14 Të dhëna nga pyetësorët me studentët*<br>*Shtojca 2.4 Raporti i Analizës Vjetore të Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore dhe Financiare i UNIKO;* |
| **Kriteri 4.** Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e | Në raport përmenden metodat bazë të vlerësimit të programeve, por jo metoda të posacme të vlerësimit të tërthortë. Përmendet pjesëmarrja e stafeve në trajnime e projekte si edhe në tryeza të rrumbullakëta diskutimesh. Fakulteti organizon në fund të çdo viti akademik, rishikimin periodik të programit të studimit dhe rregullores mësimore të tij ku i kushtohet opinioneve/feedback-ut të marrë nga studenti.<br>Sjellja dhe veprimtaria e stafit akademik matet edhe me t[20], intervistat në panairin e karrierës, anketimet e ndryshme me të diplomuarit në FB, për të vlerësuar programet e studimit. Studentët marrin pjesë në takime punetë cilat kontribuojnë në drejtim të |

[20] Shtojca 3.14 Të dhëna nga pyetësorët me studentët

| | |
|---|---|
| administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program. | përmirësimit të treguesve të performancës së veprimtarisë akademike.<br>*Evidenca*<br>*Shtojca 3.14 Të dhëna nga pyetësorët me studentët*<br>*Shtojca 1.16 Manuali i Cilësisë së UNIKO* |
| **Konkluzione** | *Programet e studimit vlerësohen përmes mekanizmave e proçeseve formale të dokumentuara lidhur me shqyrtimin, miratimin dhe mbikqyrjen e herë pas hershme të tyre .*<br>*-Të dhënat e analizave vjetore përfshihen në raportet vjetore të Departamentit, Fakultetit dhe Universitetit*<br>*- Të dhënat e vlerësimit analizohen nga çdo Departament përmes mbledhjes së Departamentit.*<br>*-Raportet e vlerësimit shoqërohen me planin e masave për adresimin e mangësive dhe ndërhyrjet për përmirësimin e cilësisë.*<br>- |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit:** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi VI.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. | UNIKO ka ngritur një sistem për sigurimin e vazhduesshëm të cilësisë, të përbërë nga NJSBC dhe KPSSC. Detyrat funksionale dhe procedurat e punës së këtyre strukturave të menaxhimit të cilësisë janë të sanksionuara në Statut, në planin strategjik të institucionit, në rregulloren e NJSBC dhe Manualin për sigurimin e cilësisë Ky sistem garanton përfshirjen e formalizuar të strukturave në procesin e sigurimit të cilësisë, ku bëjnë pjesë dhe studentët. Përmirësimi i cilësisë së këtij programi studimi ndjek të gjitha procedurat e formalizuara në dokumentat startegjikë dhe rregulloret që lidhen me procesin e sigurimit të cilësisë si Statuti, Rregullorja e NjSBC, Rregullore e KPSSCManuali i sigurimit të cilësisë .. |

| | |
|---|---|
| | Studentët marrin pjesë në qeverisjen e UNIKO përmes anëtarësisë së tyre në Senatin Akademik, dhe në komisione sipas rregulloreve të miratuara. Ndërsa pedagogët dhe stafi ndihmës-akademik janë pjesë e vlerësimit të cilësisë pjesëmarrjes aktive në takimet që organizon njësia bazë, dhe të asamblesë së njesisë kryesore, apo edhe në nivel Universiteti. UNIKO ka edhe Bordin Këshillimor, Rektorati këshillohet herë pas here, kur e sheh të arsyeshme me Bordin Këshillimor, të cilët janë përfaqësues nga organet vendore dhe institucione të tjera, veprimtaria e të cilave lidhet me atë e institucionit.Vitet e fundit, DA ka organizuar tryeza të rrumbullakëta me operatorët e sektorit privat, për të diskutuar në lidhje me çështje në interes të përbashkët, që kanë të bëjnë kryesisht me shkëmbime opinionesh për sa i përket përshtatjes së programeve me nevojat e tregut të punës;.<br>*Evidenca*<br>*Shtojca 2.14 Vendimi për krijimin e Bordit Këshillimor;*<br>*Shtojca 2.10 Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave profesionale;*<br>*Shtojca 1.1 Statuti i Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, Kreu IX, Neni 84;*<br>*Shtojca 3.7 Raporti vjetor i NJSBC Fakulteti i Bujqësisë;*<br>*Shtojca 2.13 Raporti vjetor i Veprimtarisë së FB për vitin akademik 2022-2023* |
| **Kriteri 2.** Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave. | UNIKO ka ngritur një sistem për sigurimin e vazhduesshëm të cilësisë, të përbërë nga NJSBC dhe KPSSC. Detyrat funksionale dhe procedurat e punës së këtyre strukturave të menaxhimit të cilësisë janë të sanksionuara në Statut, në planin strategjik të institucionit, në rregulloren e NJSBC dhe Manualin për sigurimin e cilësisë Ky sistem garanton përfshirjen e formalizuar të strukturave në procesin e sigurimit të cilësisë, ku bëjnë pjesë dhe studentët. Përmirësimi i cilësisë së këtij programi studimi ndjek të gjitha procedurat e formalizuara në dokumentat startegjikë dhe rregulloret që lidhen me procesin e sigurimit të cilësisë si Statuti, Rregullorja e NjSBC, Rregullore e KPSSC, Manuali i sigurimit të cilësisë .Studentët marrin pjesë në qeverisjen e UNIKO përmes anëtarësisë së tyre në Senatin Akademik, dhe në komisione sipas rregulloreve të miratuara. Ndërsa pedagogët dhe stafi ndihmës-akademik janë pjesë e vlerësimit të cilësisë pjesëmarrjes aktive në takimet që organizon njësia bazë, dhe të asamblesë së njesisë kryesore, apo edhe në nivel Universiteti. UNIKO ka edhe Bordin Këshillimor, Rektorati këshillohet herë pas here, kur e sheh të arsyeshme me |

| | |
|---|---|
| | Bordin Këshillimor, të cilët janë përfaqësues nga organet vendore dhe institucione të tjera, veprimtaria e të cilave lidhet me atë e institucionit.<br>*Evidenca*<br>*Shtojca 2.14 Vendimi për krijimin e Bordit Këshillimor;*<br>*Shtojca 2.10 Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave profesionale;*<br>*Shtojca 1.1 Statuti i Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, Kreu IX, Neni 84;*<br>*Shtojca 3.7 Raporti vjetor i NJSBC Fakulteti i Bujqësisë;*<br>*Shtojca 2.13 Raporti vjetor i Veprimtarisë së FB për vitin akademik 2022-2023*<br>. |
| **Kriteri 3.** Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit. | Procedurat që lidhen me sigurimin e cilësisë kanë garantuar përfshirjen e njësive bazë dhe kryesore, stafeve akademike, adminstrative dhe studentëve. Nga pikëpamja rregullatore kjo sigurohet përmes faktit që secila strukturë ka të përcaktuar rolin e saj në dokumentat strategjike dhe rregulloret përkatëse. Gjithashtu kjo reflektohet në faktin se raportet vjetore që lidhen me sigurimin e cilësisë përgatiten në bazë të raporteve inividuale të vetëvlerësimit, raporteve të analizës së performancës së Departameneteve, gjetjeve të pyetësorëve ku përfshihen stafet dhe studentët. Procedura e vlerësimeve përfshin të gjithë aktorët, që nga vetë pedagogu, përmes vetëvlerësimit, tek studentët përmes fomularit të vlerësimit të pedagogëve nga studentët, vlerësimin nga kolegët. NJSBC funksionon në nivel institucioni dhe koordinon sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në njësitë kryesore dhe me tej në njësitë bazë.<br>Të gjithë anëtarët e personelit akademik dhe ndihmës-akademik janë aktivë me diskutimet, opinionet apo sugjerimet e tyre, në drejtim të konkluzioneve apo rekomandimeve të pasqyruara në raportet e analizave vjetore që diskutohen dhe miratohen në takimet e organizuara nga Departamenti i Agrobiznesit apo edhe në nivel njësie kryesore..<br>*Evidenca*<br>*Shtojca 1.1 Statuti i Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, Kreu IX, Neni 84;*<br>*Shtojca 3.7 Raporti vjetor i NJSBC Fakulteti i Bujqësisë;*<br>*Shtojca 2.13 Raporti vjetor i Veprimtarisë së FB për vitin akademik 2022-2023* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4.** Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. | Procedurat e përzgjedhjes së antarëve të strukturave që lidhen me vlerësimin janë transparente dhe zbatojnë parimin e mosdiskriminimit, të parazisë dhe të integritetit professional. UNIKO ka hartuar Kodin e Etikës dhe ka krijuar Komisionin e Etikës konform akteve ligjore në fuqi që lidhen me etikën në arsimin e lartë. Shmangia e diskriminimit dhe garantimi i respektimit të lirisë dhe integritetit akademik janë pjesë e politikës së UNIKO, formalizuar në Kodin e etikës. Gjithashtu, instrumenti kryesor i vlerësimit të programit të studimit, pyetësori, është realizuar në kushte të plota anonimiteti.<br>Në takimin e zhvilluar me studentët dhe pedagogët u konfirmua se në asnjë rast nuk janë ndeshur me praktika diskriminuese. Ata konfirmuan se në strukturat e menaxhimit të cilësisë ka pedagogë dhe studentë me integritet të lartë dhe të përgjegjshëm. Në procesin e vlerësimit respektohet integriteti akademik dhe shmanget çdo lloj forme diskriminimi apo pabarazie kundrejt stafit akademik apo studentëve<br>*Evidenca*<br>*Shtojca 1.19 Rregullore e këshillit të etikës;*<br>*Shtojca 3.14 Të dhëna nga pyetësorët me studentët*<br>*Shtojca 3.14 Të dhëna nga pyetësorët me studentët*<br>*Shtojca 3.7.1 Raporti Institucional i Vlerësimit të Brendshëm UNIKO Vizita ne Institucion* |
| **Kriteri 5.** Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj. | Në procesin e vlerësimit instucioni shfrytëzon eksperiza nga institucionet me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi, studentët e diplomuar, bashkëpunimet ndërkombëtare në kuadër të projekteve si ERASMUS. Mendimet e sugjerimet e tyre janë një kontribut i vlefshëm në lidhje më përmirësimin e programit të studimit dhe lidhjen më efikase me kërkesat e tregut të punës.<br>Gjithashtu, vlerësimet e jashtme të programit nga ekspertët në kuadër të akreditimit shërbejnë si një bazë e rëndësishme për ndërmarrjen e hapave përmirësues që lidhen me proceset e sigurimit të brendshëm të cilësisë.<br>UNIKO dhe FB bashkëpunon me institucione dhe partnerë të ndryshëm brenda dhe jashtë Shqipërisë, të cilët marrin pjesë në diskuime të cilat ndihmojnë në vlerësimin e porgrameve të studimit dhe ndërmarrjen e masave që të bëhet një përshtatje më e mirë me tregun e punës.<br>Organizimi i takimeve me aktorë të jashtëm dhe palë të treta, synojnë përmirësimin e kurrikulës apo programeve të veçanta të lëndëve /moduleve, për të përmbushur sa më mirë nevojat e |

<table>
<tr><td></td><td>punëdhënësve potencialë. Edhe studimi i tregut të punës është bazuar në konsulta dhe intervista me aktorë të ndryshëm (punëdhënës potencialë). Gjithashtu, .<br>është mundësuar përfitimi i vlerësimeve shumë të vyera nga ekspertë të ndryshëm në lidhje me cilësinë e programeve të studimit dhe përmirësimin e mundshëm të tyre. Stafi akademik i universitetit e ka nxitur dialogun mes palëve të interesit, përfshi edhe institucionet qeveritare, me anë të kontributit të drejtpërdrejtë si ekspertë të fushës.<br>Evidenca<br>Shtojca 2.10.2 Listë Përmbledhëse e Marrëveshjeve Institucionalee;<br>Shtojca 2.10 Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave profesionale;<br>Shtojca 2.10 Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave profesionale;<br>Shtojca 2.10 Marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të praktikave profesionale</td></tr>
<tr><td>Konkluzione</td><td>KPSSC dhe NJSBC funksionojnë në nivel institucioni dhe koordinojnë sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në të gjitha njësitë kryesore dhe me tej në njësitë bazë.<br><br>-Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit MP në "Drejtim agrobiznesi ", njësia bazë garanton përfshirjen e të gjithë strukturave, të cilat janë përgjegjëse për programin e studimit, siç është personeli akademik, ndihmës akademik e administrativ dhe studentët.<br><br>-.Detyrat funsionale, rolet dhe përgjegjësitë e struktuarve që merren me sigurimin e cilësisë janë të garantuara përmes dokumentave të politikave dhe rregulloreve përkatëse<br><br>Sugjerim: Në procesin e vlerësimit të brëndshëm të programeve të studimit, institucioni t ë përfshijë ekspert të jashtëm. ,</td></tr>
</table>

| Shkalla e përmbushjes së standardit: | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi VI.5**<br>**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. | Të gjithë dokumentat që lidhen me politikat dhe strategjitë e UNIKO dhe në këtë kuadër edhe ato që lidhen me sigurimin e brendshëm të cilësisë bëhen publike përmes faqes ëeb të institucionit. Aty të gjithë të interesuarit, pedagogët, studentët, institucionet apo personat nga jashtë institucionit kanë akses në Statutin e UNIKO, Strategjinë, rregulloren e NJSBC dhe KPSSC, Manualin e Cilësisë.<br>Informacionet përcillen dhe në formë shkresore në njësinë kryesore dhe njësitë bazë, ku janë të aksesueshme nga personeli akademik, ndihmës akademik dhe studentët.<br>Raporti i NJSBC është publik dhe i aksesueshëm nga studentët dhe publiku në faqen ëeb të IAL.<br>*Evidencë*<br>**ëëë.uniko.edu.al** |
| **Kriteri 2.** Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. | NJSBC realizon pyetësorët në fund të çdo viti akademik, Ata janë pjesë e raportit vjetor të cilësisë, i cili publikohet rregullisht duke zbatuar parimin transparencës, në përputhje me rregulloret që lidhen me menaxhimin e cilësisë. Në hartimin e raportit, NJSBC respekton lirinë akademike dhe kodin e etikës si dhe kuadrin ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale (ligji 48/2012 "Për mbrojtjen e të dhënave personale").<br>Raporti u komunikohet strukturave e autoriteteve përkatëse. Dekanët organi Institucioni publikon raportin e vetëvlerësimit të brendshëm për akreditimin institucional në faqen e tij elektronike, për të gjithë aktorët që kanë lidhje me universitetin dhe publikun e interesuar.<br>*Evidenca*<br>*Shtojca 2.1.1 Certifikatë dhe vendim akreditimi institucional*<br>*Shtojca 2.13 Raporti vjetor i Veprimtarisë së FB për vitin akademik 2022-2023;*<br>*Shtojca 2.4 Raporti i Analizës Vjetore të Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore dhe Financiare i UNIKO;*<br>*Shtojca 3.8 Analiza vjetore e veprimtarisë së njësisë bazë;*<br>*Vizita ne institucion* |
| **Kriteri 3.** Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe | Rezultatet e vlerësimit të brendshëm, të procesit të akreditimit raportohen pranë rektoratit dhe dekanateve të fakulteteve. Në analizën e saj NJSBC-ja informon njësitë bazë dhe ato kryesore lidhur me pikat e forta dhe dobësitë e tyre. Raportet e vlerësimit të |

| | |
|---|---|
| synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. | cilësisë përvec pjesës narrative nuk kanë edhe një plan për adresimin e rekomandimeve përkatëse apo adresim të problematikave, të cilat synojnë përmbushjen e mangësive dhe dobësive të evidentuara..<br>*Evidenca*<br>*Shtojca 3.7 Raporti vjetor NjSBC 2022-2023*<br>*Shtojca 2.13 Analiza vjetore e FBt* |
| **Kriteri 4.** Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. | Strukturat e vlerësimit të cilësisë janë tashmë të konsoliduara dhe kanë ekepriencën e nevojshme. Atyre u është dhënë e gjithë mbështetja institucionale për rritjen e efektivitetit të vlerësimeve. Gjetjet e raporteve të vlerësimit bëhen objekt diskutimi në mbledhjen e Departamentit, ato gjithashtu janë pjesë e raportit vjetor të Departamentit dhe mbi bazën e tyre përgatitet edhe një plan veprimi. Gjithashtu, për ndërhyrjet të cilat kanë nevojë për mbështetje financiare, paraqiten nevojat e Departamentit cdo vit pranë Dekanatit dhe këto bëhen pjesë e plan buxhetit të vitit përkatës.<br>Në takimet me pedagogët u reflektua fakti që UNIKO është shumë mbështetës për nevojat e tyre lidhur me pëmirësimin cilësor të procesit të studimit dhe kërkimit shkencor si përshembull pajisja me literaturën e fundit, pajisjet elektronike në funksion të metodave inovative të mësimdhënies, etj Stafet angazhohen për plotësimin e rekomandimeve nga vlerësimi i brendshëm i cilësisë.. Shtojca 3.8 Analiza vjetore e veprimtarisë së njësisë bazë;<br>*Evidenca*<br>*Shtojca 2.4 Raporti i Analizës Vjetore të Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore dhe Financiare i UNIKO;*<br>*Shtojca 3.7 Raporti vjetor NjSBC 2022-2023*<br>*Shtojca 2.13 Analiza vjetore e FBt* |
| **Kriteri 5.** Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. | Raportet vjetore të cilësisë janë një veprimtari periodike për të informuar mbi situatën lidhur me sigurimin e cilësisë, problematikat që ndeshen dhe nevojat për përmirësime. Në mënyrë periodike organizohen në bazë departamenti apo fakulteti, aktivitete të ndryshme, seminare, ëorkshop, trajnime, leksione të hapura, konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare.<br>Trajnimet organizohen edhe nga institucione të lidhura me arsimin e lartë si ASCAL, i cili ka organizuar trajnimin mbi sondazhin |

| | |
|---|---|
| | kombëtar të studentëve. Ky u konsiderua nga përfaqësues të KPSSC si një instrument i rëndësishëm për ndërgjegjësimin e studentëve lidhur me rëndësinë e këtyre pyetësorëve dhe përgjegjshmërinë që ata duhet të reflektojnë gjatë plotësimit të tyre, duke patur parasysh ndikimin që do të kenë në vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies.<br><br>Nëpërmjet organizimit të këtyre takimeve bëhet i mundur ndërgjegjësimi i stafit, për ndërhyrje të mundshme (në rast nevoje), me synim përmirësimin e treguesve cilësorë të performancës së veprimtarisë akademike dhe aktiviteteve kërkimore-shkencore.<br>*Evidencë*<br><br>*Shtojca 3.7 Raporti vjetor NjSBC 2022-2023*<br><br>*Vizita n institucion* |
| **Konkluzione** | *Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit nëfaqen zyrtare, on line të universitetit.*<br><br>*-NJSCB realizon pyetësorët institucionalë në fund të çdo viti akademik, në bazë të të cilëve hartohet raporti vjetor i sigurimit të cilësisë , i cili publikohet në faqen ëeb të institucionit.*<br><br>*-Bazuar në gjetjet e pyetësorëve përgatiten raportët vjetore të vlerësimit të cilësisë të cilët u komunikohet individëve, strukturave e autoriteteve përkatëse dhe shërbejnë si bazë për ndërhyrjet institucionale në funksion të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.*<br><br>*-Në bazë të gjetjeve të raporteve hartohet një plan veprimi ku reflektohen rekomandimet për përmirësime dhe mënyra e adresimit të tyre.*<br><br>*-Institucioni ka realizuar aktivitete për të mundesuar një monitorim sa më efektiv të standardeve të cilësisë, sic janë edhe trajnimet e pedagogëve për këtë qëllim.*<br><br>*-Institucioni vë në funksion buxhete vjetore për të mundësuar përmirësimin e infrastrukturës së mësimdhënies dhe punës shkencore (literatura, pjesëmarrja në konferenca, publikimet shkencore etj)*<br><br>Sugjerim :*Studentët duhet të luajnë një rol më aktiv në strukturat ku ata marrin pjesë.* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *Duhet që raportet e vleresimit të performancës të shoqërohen me plan masash* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit:** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | **X** | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI:** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Master Profesional "Drejtim agrobiznesi "." të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë "Universiteti "Fan S.Noli", Korcë**

**Pikat e forta:**

- Programi i studimit paraqet një risi dhe një nevojë të tregut të punës dhe si i tillë premton lehtësimin e aksesit të studentëve në tregun e punës.
- Programi i studimit është organizuar në mënyrë të strukturuar mirë, me një kurrikul të pasur, duke harmonizuar përfshirjen e lëndëve bazë, karakterizuese dhe ndërdisiplinore të fushës së agrobiznesit . .
- Mësimdhënia reflekton harmonizim të metodave tradicionale dhe atyre bashkëkohore, duke ekuilibruar teorinë me praktikën dhe nxitjen e aftësive të punës individuale të studentëve.
- Stafet akademike që marrin pjesë në këtë program studimi reflektojnë kapacitete akademike dhe menaxheriale të spikatura , falë eksperiencës së tyre në akademi
- Institucioni reflekton një qëndrueshëmri të stafeve dhe qëndrueshmëri financiare,duke garantuar ecuri normale dhe të pa rrezikuar të programit të studimit.
- Infrastruktura fizike si dhe ajo e mësimdhënies është e përshtatshme dhe mundëson lehtësimin e procesit mësimor dhe veprimtarive praktike në mjediset laboratorike dhe bibiotekën, duke kontribuar në zhvillimin e aftësive praktike të studentëve.
- Institucioni ka ngritur një sistem funksional të menaxhimit të cilësisë, i cili garanton realizimin e misionit të tij për një mësimdhënie dhe kërkim shkencor sipas standardeve më të larta bashkëkohore.
- Institucioni ka nje sistem funksional qe lidhet me procesin mesimor , ne sherbim te te cilit jane stafet ndihmes akademike dhe administrative

**Pikat e dobëta**:

- Njohje jo e plotë nga ana e studentëve e përfshirjes së përfaqësuesve të tyre në strukturat vendimmarrëse (StandardiV/5, kriteri 3)
- Mospërfshirje e studentëve në proceset që lidhen me permbajtjen e programeve te studimit (StandardiV/5, kriteri 2)
- Syllabus nuk janë në përputhje më VKM Nr 41, datë 24.1.2018, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"
- Mungon përditësimi i literaturës dhe rishikimi i tyre prej nje persidhe 3-4 vjecare.

**Rekomandime**:

- Në RVB ka raste që informacioni mbi kriterin jepet shumë i gjatë dhe për më tepër jo i lidhur drejtpërsëdrejti me kerkesat e kriteret. Sugjerojmë të shmangen këto raste në vijim
- Sugjerohet të ndiqen edhe metoda të tjera të tërthorta për të vlerësuar cilësinë e programeve të studimit, sic është bashkëpunimi me institucione që janë të lidhura me këto programe

studimi, të cilat mund të kërkojnë edhe studime e kërkime nga Departamenti, por edhe shihen në cilësinë e punëdhënësve potenciale

- Mund të aplikohen edhe stimuj financiarë për pedagogë që kanë arritje të spikatura në procesin mësimor dhe kërkimor.
- Të bëhet një gjurmim më i plotë i studenteve dhe të krijohet një bazë të dhënash që edhe se ku janë punësuar studentët.
- Të bëhet rishikimi i pyetësorëve në mënyrë që të përfshihen në to më shumë pyetje për programin e studimit
- Studentët që janë antarë të komisioneve duhet të bëjnë takime me studentët e tjerë dhe të luajnë rol më aktiv në përfaqësimin e interesave të tyre.
- Sugjerojmë ngritjen e njësisë së auditimit të brendshëm, e cila do të mundësonte një monitorim dhe auditim të aspekteve jofinanciare për përmirësimin e funksionimit të sistemeve të ndryshme të menaxhimit.
- -Procesi i vlerësimit të standardizohet përmes një formati vlerësimi me pikë, gjë që do të rriste transparencën dhe objektivitetin në vlerësim. Caktimi i vetëm 5 pikëve për intervistën me gojë , vlerësim ky mjaft i rëndësishme për të punuar në një institucion të arsimit të lartë, duket të jetë jo i mjaftueshëm. Prandaj sugjerojmë të rishikohet
- Duhet të përgatitet një manual që pëcakton kriteret dhe standardet për përgatitjen dhe mbrojtjen e temës së diplomës
- Të ketë një monitorim më të mirë të përditësimit të literaturës nëpëmjet kontrollit më të saktë të syllabuseve.
- Përditësimi i literaturës dhe rishikimi i tyre prej nje persidhe 3-4 vjecare.
- Syllabus të përditësohen sipas VKM Nr 41, datë 24.1.2018, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"
- Duhet të bëhet analizë e efektivitetit të përpjekjeve për pasurimin e fondit fizik dh atij online , të kërkesave
- Në procesin e vlerësimit të brëndshëm të programeve të studimit, institucioni t ë përfshijë ekspert të jashtëm.
- Duhet që raportet e vleresimit të performancës të shoqërohen me plan masash

**Strengths:**

- The study program represents an innovation and meets a clear labor-market need, thereby facilitating graduates' access to relevant employment opportunities.
- The curriculum is well-structured and comprehensive, harmonizing foundational, specialized, and interdisciplinary courses in the field of agrobusiness.
- Teaching methods combine traditional and contemporary approaches, balancing theory with practice and fostering students' individual skill development.
- Academic staff engaged in this program demonstrate outstanding academic and managerial capacities, thanks to their extensive experience in higher education.
- The institution shows stability in both faculty retention and financial resources, ensuring uninterrupted, secure delivery of the program.
- Physical infrastructure and teaching facilities—laboratories and library—are appropriate, supporting practical activities and contributing to students' hands-on skill acquisition.
- A functional quality-management system is in place, guaranteeing that teaching and research are conducted according to high, contemporary standards.
- There is an effective support system with dedicated academic and administrative personnel assisting students and faculty.

**Weaknesses:**

- Students' representatives are not fully involved in decision-making bodies; their awareness of representation channels is not fully complete.
- There is a risk of declining student interest in agriculture-related disciplines.
- Students are insufficiently engaged in designing or updating the program's content.
- Course syllabi do not fully comply with Council of Ministers Decision No. 41, dated January 24, 2018, "On the elements of study programs offered by higher-education institutions."
- The literature is not updated or reviewed at least every three to four years.

**Recommendations:**

1. In the Internal Evaluation Report (RVB), information on each criterion is often overly lengthy and not always directly linked to the stated requirements. It is suggested to avoid such instances in future reports.
2. Introduce additional cross-evaluation methods—for example, collaboration with institutions connected to this program (e.g., potential employers) who may request departmental studies or research, thereby enriching quality assessment.
3. Implement financial incentives for faculty members who achieve notable success in teaching and research.
4. Establish a comprehensive tracking system for graduates and create a database of their employment destinations.
5. Revise and expand the student questionnaire to include more questions specifically about the program's content.
6. Student representatives on committees should hold regular meetings with their peers and play a more active role in advocating for student interests.

7. Create an internal auditing unit to monitor and audit non-financial aspects, improving the functionality of various management systems.
8. Standardize the human resources evaluation process by adopting a point-based scoring format to enhance transparency and objectivity. For example, assigning only five points to the oral interview—an important criterion for academic positions—seems insufficient; this weighting should be reconsidered.
9. Prepare a handbook that defines clear criteria and standards for preparing and defending master's theses.
10. Enforce stricter monitoring of syllabus updates through more rigorous checks.
11. Update the literature and review it every three to four years.
12. Ensure all syllabi conform to Council of Ministers Decision No. 41, dated January 24, 2018, "On the elements of study programs offered by higher-education institutions."
13. Analyze the effectiveness of efforts to enrich both physical and online resources in response to demand.
14. Involve external experts in the internal evaluation of study programs to provide an independent perspective.
15. Accompany performance-evaluation reports with action plans outlining measures for improvement.

**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit:**

| FUSHAT E VLERËSIMIT | SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Nuk përmbushen | Përmbushen pjesërisht | Përmbushen kryesisht | Përmbushen plotësisht |
| I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË | | | | X |
| III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT | | | | X |
| IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE | | | | X |
| VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| VLERËSIMI TËRËSOR | | | | X |